

Të dhënat kryesore financiare

Banka Raiffeisen në Kosovë sh.a.			
Vlerat monetare janë në milionë euro	2021	2020	Ndryshimi
Pasqyra e të ardhurave	1/1-31/12	1/1-31/12	
Të ardhurat neto nga interes	46.2	45.0	2.7%
Të ardhurat neto nga komisione	12.2	8.0	53.3%
Fitimet ose humbjet nga asetet dhe detyrimet financiare	0.1	0.1	-10.7%
Të ardhura të tjera operative	4.7	3.2	47.6%
Shpenzimet e përgjithshme administrative	(32.4)	(30.6)	5.9%
Fitimi para tatimi	29.4	18.5	59.4%
Fitimi pas tatimi	26	16.7	58.1%
Fitimet për aksion	N/A	N/A	N/A
Bilanci i gjendjes			
Kredi dhe paradhënie për banka	19.4	28.6	-32.1%
Kredi dhe paradhënie për klientë	778.2	709.5	9.7%
Letra me vlerë të investimeve	174.0	176.8	-1.5%
Depozita dhe huamarrje nga banka	6.3	26.9	-76.4%
Depozita nga klientë	1,022.8	915.6	11.7%
Ekuiteti (përfshirë interesat jokontrolluese dhe fitimit)	137.5	144.1	-4.6%
Totali i bilancit	1,195.9	1,116.0	7.2%
Informatat vendore rregullative			
Pasuritë me risk të ponderuar B2, përfshirë rrezikun e treg. dhe riskun oper.	879.9	835.1	5.4%
Gjithsej fondet vetanake	134.5	145.9	-7.8%
Gjithsej kërkesa për fonde vetanake	105.6	100.2	5.4%
Raporti i mbulimit tepricë	27.4%	45.6%	-18.2 PP
Raporti i kapitalit kryesor (klasi i parë)	14.0%	15.7%	-1.7 PP
Gjithsej raporti i fondeve vetanake	15.3%	17.5%	-2.2 PP
Performanca			
Kthimi në ekuitet (KE) para tatimi	24.2%	14.5%	9.8 PP
Kthimi në ekuitet (KE) pas tatimit	21.7%	13.1%	8.6 PP
Raporti kosto/të ardhura	46.9%	54.1%	-7.2 PP
Kthimi në pasuri (KP) para tatimi	2.5%	1.8%	0.7 PP
KJP	3.1%	3.2%	-0.1 PP
Raporti i mbulueshmërisë së KJP	76.4%	72.9%	3.5 PP
Raporti neto i provizionimi	0.4%	1.4%	-1 PP
Raporti rrezik / fitim	6.5%	21.0%	-14.5 PP
Burimet			
Numri i punëtorëve	859	856	0.4%
Pikat e biznesit	39	41	-4.9%

Content

Raporti i Bordit Mbikëqyrës	4
Raporti i Bordit Menaxhues	5
Bordi Menaxhues i Kosovës	6
Struktura organizative e Bankës Raiffeisen në Kosovë	7
Vizioni dhe misioni	8
Vështrim i shkurtër mbi Raiffeisen Bank International	9
Zhvillimet në ekonominë e Kosovës	10
Sektori bankar në Kosovë	12
Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen në Kosovë	14
Menaxhimi i thesarit, asetëve dhe detyrimeve	18
Segmentet e biznesit	22
Produktet dhe shërbimet bankare	24
Kanalet e shpërndarjes	26
Menaxhimi i rrezikut	28
Njerëzit, kultura, dhe të mësuarit	32
Qëndrueshmëria dhe përgjegjësia korporative	34

Pasqyrat financiare	38
Adresat dhe kontaktet	118

Raporti i Bordit Mbikëqyrës

Zonja dhe zotërinj,

Pavarësisht ndikimit të pandemisë COVID-19 në vitin 2021, Kosova shënoi rritje reale të BPV-së prej 10.5 per cent, rritja më e lartë ekonomike në vitet e fundit. Ky zhvillim pozitiv u reflektua edhe në performancën financiare të Bankës Raiffeisen në Kosovë, e cila vazhdoi rritjen e saj të qëndrueshme të konsiderueshme duke ruajtur pozicionin e saj të lideres në treg në të gjithë treguesit kryesorë të performancës, si pjesëmarrja në treg në kredi dhe depozita, fitimi neto, rrjeti i degëve dhe numri i klientëve.

Gjatë vitit financiar 2021, anëtarët e Bordit Mbikëqyrës zhvilluan katër mbledhje të rregullta. Shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës ishte rreth 100 për qind.

Bordi Mbikëqyrës ka monitoruar rregullisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse performancën e biznesit dhe zhvillimet e rrezikut në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Janë mbajtur rregullisht diskutime me Bordin Menaxhues për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetin, si dhe për drejtimin e biznesit të bankës dhe strategjitë e rrezikut. Bordi Mbikëqyrës gjithashtu u mor gjerësisht me zhvillimet e mëtejshme në kuadër të qeverisjes korporative dhe monitoroi zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë aktiviteteve të tij monitoruese dhe këshilluese, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të drejtpërdrejta me anëtarët përgjegjës të Bordit Menaxhues, auditorin dhe udhëheqësit e funksioneve të kontrollit të brendshëm. Bordi gjithashtu shkëmbeu vazhdimisht informacione dhe pikëpamje me përfaqësuesit e autoriteteve mbikëqyrëse për çështje aktuale.



Për më tepër, Bordi Menaxhues i ka ofruar Bordit Mbikëqyrës raporte të rregullta dhe të detajuara për çështjet relevante në lidhje me performancën në fushat përkatëse të biznesit. Në periudhën ndërmjet takimeve, Bordi Mbikëqyrës mbajti kontakte të ngushta me Kryesuesin dhe anëtarët e Bordit Menaxhues. Bordi Menaxhues ishte në dispozicion kur kërkohej për diskutime dypalëshe ose shumëpalëshe me anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, aty ku ishte e mundur me përfshirjen e ekspertëve për çështjet që trajtoheshin.

Puna e ndërmarrë së bashku me Bordin Menaxhues bazohej në një marrëdhënie të besimit reciprok dhe u krye në një frymë të bashkëpunimit efikas dhe konstruktiv. Diskutimet ishin të hapura dhe kritike dhe Bordi Mbikëqyrës miratoi vendime pas shqyrtimit të plotë të të gjitha aspekteve. Nëse kërkohej informacion shtesë për t'i shqyrtuar çështjet individuale në mënyrë më të detajuar, atëherë ky informacion u jepej anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës pa vonesë dhe sipas kërkesave të tyre.

Gjithashtu duhet theksuar se për shkak të pensionimit të Robert Wright, Drejtori Ekzekutiv i Bankës Raiffeisen në Kosovë, Anita Kovacic e mori këtë post nga data 1 nëntor 2021. Znj. Kovacic u përzgjedh në kuadër të një procesi të hapur dhe transparent rekrutimi brenda Grupit Bankar Raiffeisen.

Pas një viti tjetër sfidues për shkak të pandemisë COVID-19, do të doja të shfrytëzoj rastin të falënderoj singërisht Bordin Menaxhues dhe të gjithë punonjësit e Bankës Raiffeisen në Kosovë për përpjekjet e tyre të palëkundura, si dhe klientët tanë për besimin e tyre të vazhdueshëm.

Në emër të Bordit Mbikëqyrës

Peter Lennkh,
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës

Raporti i Bordit Menaxhues

Viti 2021 ishte vit i rimëkëmbjes së shpejtë për ekonominë e Kosovës dhe rrjedhimisht një vit mjaft i suksesshëm për sektorin bankar të Kosovës. Ekonomia e Kosovës arriti të shënojë një rritje reale të BPV-së prej 10.5%, duke i thyer edhe parashikimet më optimiste. Niveli i lartë i aktiviteteve ekonomike u reflektua në lehtësimin gradual të masave pandemike, politikat mbështetëse fiskale dhe monetare nga qeveria, si dhe fluksin hyrës rekord të remitancave nga diaspora në vlerë prej 1.14 miliardë €. Nisur nga këto zhvillime të favorshme, Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu i ka tejkaluar pritjet e saj dhe kjo është reflektuar në performancën tonë financiare si dhe në kënaqshmërinë e klientëve tanë.

Një nga prioritetet tona kryesore ishte të punonim ngushtë me klientët tanë dhe t'i identifikonim zgjidhjet më të përshtatshme të financimit, për t'iu mundësuar atyre të rimëkëmben nga ndikimet negative të shkaktuara nga pandemia. Duke vepruar sipas kësaj qasjeje, Banka Raiffeisen në Kosovë rriti kreditë dhe paradhënit për klientët për 69 milionë € në 778.2 milionë € (2020: 709.5 milionë €), duke qenë kështu një lojtar aktiv në sektorin bankar të Kosovës në financimin e rimëkëmbjes së shpejtë ekonomike. Depozitat e klientëve tanë shënuan një rritje të konsiderueshme duke arritur në 1,023 milionë € (2020: 916 milionë €). Vitin 2021 e përmbyllëm me gjithsej asete në vlerë prej 1,196 milionë € dhe fitim neto rekord prej 26.3 milionë €. Me të gjitha këto arritje pozitive financiare ne ruajtëm pozitën udhëheqëse në treg në Kosovë.



Përqendrimi te klienti është udhëzuesi për të gjitha aktivitetet dhe inovacionin tonë. Në vitin 2021, ne u shërbyem rreth 280,000 klientëve me 859 punonjës. Kemi zhvilluar dhe përmirësuar platformat e qëndrueshme të shërbimit digjital, si E-banking, Mobile banking dhe chatbot, të përdorura nga klientët kryesisht për t'i kryer transakcionet e zakonshme bankare. Gjithashtu, ne prezantuam ofertën digjitale në lidhje me produktet, si hapja e llogarive dhe aplikimi për produkte kredie online. Ne vazhduam me transformimin e degëve tona rajonale duke synuar përmirësimin e shërbimeve të ofruara për klientët tanë që i preferojnë shërbimet bankare në degë. Përveç zonave të vetëshërbimit dhe ATM-ve Glory për depozitat e mëdha të korporatave, punonjësit tanë në degë u trajnuan për të demonstruar një qasje me detyra të shumëfishta për t'i ndihmuar dhe këshilluar klientët në përdorimin e produkteve dhe shërbimeve tona.

Në janar të vitit 2021, kompania jonë amë Raiffeisen Bank International (RBI) ka nënshkruar në emër të grupit RBI Parimet e OKB-së për Bankim të Përgjegjshëm. Këto parime i përcaktojnë dhe promovojnë standardet e Qeverisjes Sociale Mjedisore (ESG), duke synuar reduktimin e gjurmës së karbonit dhe përmirësimin e mirëqenies sociale. Strategjia për ESG e Bankës Raiffeisen në Kosovë parasheh një tranzicion afatgjatë, duke pranuar se tregut të Kosovës i nevojitet kohë për t'iu përfaqësuar qasjet e qëndrueshme të ESG të përcaktuara rishtazi. Megjithatë, si banka më e madhe në Kosovë, ne marrim përgjegjësinë për t'iu mbështetur institucionet vendore që së bashku të përfaqëojmë hapa konkretë në këtë drejtim. Jemi të përkushtuar t'iu ndajmë njohuritë teknike dhe ekspertizën e RBI-së të mësuar në tregjet e RBI-së me palët përkatëse të interesit dhe të angazhohemi aktivisht për t'iu aftësuar klientët tanë, në kalimin e flukseve të tyre të kapitalit dhe praktikave të biznesit sipas standardeve të ESG-së.

Si pjesë e strategjisë së qëndrueshmërisë të ESG të bankës, ne përpiqemi të mbetemi punëdhënësi i preferuar. Duke pasur parasysh mbizotërimin e situatës pandemike në vitin 2021, ne ishim të fokusuar në shëndetin dhe mirëqenien e punonjësve tanë duke krijuar kushte për të punuar nga shtëpia dhe duke promovuar vaksinimin kundër COVID-19. Për më tepër, objektivat tona kryesore ndaj punonjësve mbeten mjedisi fleksibël i punës, diversiteti dhe mundësia për zhvillim profesional. Jemi të përkushtuar të përmirësojmë vazhdimisht përvojën si të klientëve ashtu edhe të punonjësve tonë dhe në këtë drejtim mbledhim rregullisht komente kthyesë përmes kanaleve të ndryshme me qëllim përmirësimin e mëtejshëm.

Në përmbyllje, në emër të Bordit Menaxhues, dëshiroj t'iu falënderoj të gjithë punonjësit tanë për angazhimin dhe përkushtimin e tyre, gjë e cila i ka mundësuar Bankës Raiffeisen në Kosovë të mbyllë vitin financiar 2021 me rezultatet më të mira ndonjëherë.

Në emër të Bordit Menaxhues,

Anita Kovacic
Kryesuese e Bordit Menaxhues

Banka Raiffeisen në Kosovë

Bordi Menaxhues



Anita Kovacic

Kryesuese e Bordit
Menaxhues
Drejtoreshë Ekzekutive



Shukri Mustafa

Anëtar i Bordit
Menaxhues
Operacionet dhe TI



Iliriana Toçi

Anëtare e Bordit
Menaxhues
Shërbimet Bankare Retail




Johannes Riepl

Anëtar i Bordit
Menaxhues
Shërbimet Bankare për
Korporata

Banka Raiffeisen në Kosovë

Struktura Organizative

Më 31 dhjetor 2021



* Auditori i Brendshëm raporton drejtpërdrejt te Komiteti i Auditorëve i Bordit Mbikëqyrës

** Departamenti i Përputhshmërisë raporton drejtpërdrejt te Bordi Mbikëqyrës dhe BM

Banka Raiffeisen në Kosovë

Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Jemi grupi më i rekomanduar për shërbime financiare deri në vitin 2025.

Misioni

Ne transformojmë inovacionin e vazhdueshëm në përvojë të shkëlqyer të klientit.

Vështrim i shkurtër mbi Raiffeisen Bank International

Raiffeisen Bank International (RBI) e konsideron Austrinë, ku edhe është banka korporative dhe investuese lidere, si dhe Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL), si tregun e saj amë. 13 tregje në këtë rajon mbulohen nga bankat filiale. Për më tepër, Grupi përfshin edhe ofrues të tjerë të shumtë të shërbimeve financiare të cilët janë aktivë në fusha, si për shembull, lizingu, menaxhimi i pasurive ose bashkimet & blerjet (M&A).

Në total, rreth 46,000 punonjës të RBI-së u shërbejnë 19 milionë klientëve në më shumë se 1,800 njësi të biznesit, shumica dërmuese e të cilave janë në EQL. Në fund të vitit 2021, gjithsej pasuritë e RBI ishin afërsisht 192 miliardë €.

Aksionet e RBI AG janë listuar në Bursën e Vjenës që nga viti 2005. Bankat rajonale të Raiffeisen mbajnë rreth 58.8 për qind të aksioneve të RBI-së, ku pjesa e mbetur prej rreth 41.2 për qind është në shitje të lirë (ang. free float).

Zhvillimet në ekonominë e Kosovës

Në vitin 2021, ekonomia e Kosovës përjetoj njëri nga ringjalljet më të fuqishme në 20 vitet e fundit, duke u rimëkëmbur plotësisht nga pandemia. BPV-ja reale shënoi një rritje dyshifrore në 10.5 për qind, duke e lëvizur ekonominë në një marsh më të lartë. Nxhtësit kryesorë të rritjes në vitin 2021 ishin shpenzimet e ekonomive familjare dhe formimi i kapitalit bruto, të cilat u rritën me 7.6 për qind përkatësisht 10.2 për qind në terma vjetorë. Gjithashtu, një kontribut pozitiv ka ardhur edhe nga konsumi publik me 9.1 për qind rritje në terma vjetorë. Eksportet neto vazhdojnë të japin një kontribut negativ në ekonomi, por më pak krahasuar me një vit më parë, më së shumti për shkak të efektit bazë në llogarinë e shërbimeve, e cila u rigjallërua me heqjen e kufizimeve të udhëtimit. Të gjitha aktivitetet ekonomike shënuan norma pozitive, ku shifrat më të forta i shënuan tregtia (+ 21.4 për qind), prodhimtaria (+ 7.9 për qind), aktivitetet profesionale (+ 7.1 për qind) dhe ndërtimtaria (+ 6.6 për qind). Rimëkëmbja e fuqishme e kërkesës së brendshme, e ndihmuar edhe nga shpenzimet e diasporës, ishin shkaktarët e rritjes së ndjeshme në vitin 2021.

Norma vjetore e inflacionit e mbylli vitin në nivele të larta prej 6.7 për qind nga viti në vit, duke shënuar një rënie të lehtë nga 6.9 për qind në terma vjetorë në muajin nëntor, që ishte niveli më i lartë i regjistruar në 10 vitet e fundit. Komponenti ushqimor kontribuoi më së shumti (3.0 p.p. në IÇK), pasuar nga transporti me një kontribut prej 2.1 p.p. për shkak të rritjes së ndjeshme të çmimeve të karburanteve (karburantit përbën 81 për qind të komponentit të transportit). Norma mesatare e inflacionit në vitin 2021 ishte 3.4 për qind, dukshëm më e lartë se 0.2 për qind sa ishte në vitin 2020, duke reflektuar rikuperimin e çmimeve globale të energjisë, çmimeve të ushqimeve dhe ringjalljen e fuqishme të ekonomisë në vitin 2021 falë kërkesës së ndrydhur e cila shpërtheu. Normat e larta të inflacionit pritet të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 2022, kryesisht nga çmimet e importit dhe prodhimit. Duke qenë një vend importues neto i ushqimeve, rritja e mëtejshme e çmimeve të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare për shkak të pasojave të luftës në Ukrainë do të ndikojë në inflacionin në Kosovë, ku artikujt ushqimorë janë komponenti kryesor i shportës së konsumit (40 për qind e totalit). Duke zgjedhur në mënyrë të njëanshme euron si valutë, Kosova ka hapësirë të kufizuar për t'iu përgjigjur presioneve të ngritura të çmimeve nga pikëpamja monetare. Megjithatë, sektori publik mund të ndërhyjë me masa mbështetëse si ulja e TVSH-së ose si në rastin e energjisë duke vendosur një kufi mbi çmimet e naftës, duke zbutur kështu lehtësisht ndikimin e përgjithshëm të inflacionit total. Nga të dhënat më të fundit zyrtare në dispozicion, punësimi u rikthye shpejt në nivelet e tij të para pandemisë. Në tremujorin e parë të vitit 2021, shkalla e papunësisë ra në 25.8 për qind nga nivelet 27 për qind sa ishin në përmbyllje të vitit 2020, ndërsa pagat nominale u rimëkëmbën me 6 për qind në terma vjetorë deri në muajin tetor të vitit 2021 pas tkurrjes me 4 për qind në vitin 2020.

Pozicioni fiskal u forcua në vitin 2021 si rrjedhojë e një rimëkëmbje të fortë të të ardhurave fiskale dhe konsolidimit të shpenzimeve. Ringjallja e fortë e ekonomisë dhe efekti bazë janë arsyt kryesore për ecuri të qëndrueshme të të ardhurave totale, të cilat shënuan një rritje prej 26.8 për qind nga viti në vit, ndërkohë që shpenzimet u rritën me vetëm 2.5 për qind nga viti në vit. Si rezultat, buxheti rezultoi në një deficit prej vetëm 107 milionë € (ose 1.4 për qind të BPV-së) krahasuar me një deficit prej 513 milionë € (ose 7.7 për qind të BPV-së) në vitin pandemik 2020. Në vitin 2022, kriza energjetike dhe masat antiinflationiste do ta detyrojnë qeverinë t'iu reduktojë shpenzimet dhe investimet publike për të mbajtur pozicionin fiskal të balancuar. Në vitin 2021, raporti i borxhit publik vazhdoi trendin e tij rritës, duke arritur në 23.3 për qind të BPV-së kundrejt 22.4 për qind në vitin 2020, ku kjo e fundit shënoi një ngritje të fortë për shkak të nevojave imediate për t'iu kapërcyer pasojat e pandemisë.

Bilanci i llogarisë rrjedhëse u përkeqësua më tej në vitin 2021, duke rezultuar në një deficit prej 691 milionë € në fund të muajit dhjetor të vitit 2021, ose 46.4 për qind më shumë krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar. Përkeqësimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse shpjegohet me përkeqësimin e deficitit tregtar i cili u rrit me 38.6 për qind nga viti në vit në vitin 2021. Nga ana tjetër, llogaria e shërbimeve përfundoi në trefishua (2.8 herë më e lartë) kundrejt vitit 2020 duke reflektuar lehtësimin e kufizimeve të udhëtimit dhe përmirësimin e situatës pandemike në rajon për shkak të vaksinimit. Pavarësisht nga kjo rritje, nuk arriti të kompensojë ndikimin e deficitit tregtar, i cili është një nga dobësitë kryesore strukturore të ekonomisë.

Remitancat, një burim i fortë financimi i konsumit familjar dhe investimeve private, arritën nivelin më të lartë historik prej 1.14 miliardë € në vitin 2021, duke shënuar një përsheptim prej 16.7 për qind nga viti në vit. Ndikimi negativ në remitancat u ndje vetëm në fillim të kufizimit të ashpër të lëvizjes si rezultat i pandemisë, veçanërisht në muajt mars dhe prill 2020. Edhe IHD-të arritën në 421 milionë € në fund të vitit 2021, ose 21.8 për qind më të larta se një vit më parë, kryesisht për shkak se investitorët ishin më ngurrues për shkak të pandemisë. 91.4 për qind e vëllimit të ri të IHD-ve në vitin 2021 u përqendruan në pasuri të paluajtshme, duke sugjeruar se ende mungojnë investimet shumë të nevojshme "greenfield" (investime të huaja ku kompania amë hap një filiale duke ndërtuar objekte të reja nga fillimi) dhe "brownfield" (investime të huaja ku kompania amë blen ose merr me qira objektet ekzistuese) që mund të mbështesin ekonominë dhe tregun e punës.

Kur është fjala te viti 2022, zhvillimet e fundit të luftës në Ukrainë të shoqëruara me normat e inflacionit që i afrohen nivelit dyshifror do të kontribuojnë në ngadalësimin e ekonomisë. Ndikimi sigurisht që do të ndihet edhe përmes kanaleve indirekte, si fluksi i reduktuar i remitancave nga diaspora që së bashku me normat e larta të inflacionit do të dekurajojnë konsumin privat.



Sektori bankar në Kosovë

Shënim: Të dhënat janë të bazuara në publikimet zyrtare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës


Në vitin 2021 në Kosovë operonin njëmbëdhjetë banka komerciale, që përfaqësonin 678 përqind të gjithëj aseteve në sektorin financiar. Këto banka komerciale kanë struktura të ndryshme aksionare. Nëntë prej tyre janë banka me pronësi të huaj dhe dy në pronësi vendore.

Sektori bankar në Kosovë ka 3,391 punëtorë, i cili ofron një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve financiare për individët dhe bizneset përmes 211 degëve dhe nëndegëve. Disa nga produktet dhe shërbimet e zakonshme që ofron sektori bankar përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesat vendore dhe ndërkombëtare, kartelat bankare, garancitë bankare, letër kreditë, E-banking. Duhet theksuar se aktiviteti i sektorit bankar dominohet nga kreditë dhe maturimi i kredisë mund të jetë deri në 20 vjet, në varësi të llojit të kredisë. Përveç degëve, klientët mund të përdorin edhe shërbime të tjera alternative dhe digjitale të mundësuar nga gjithëj 513 ATM, 13,175 POS dhe 411,347 llogari e-banking.

Totali i aseteve të sektorit bankar arriti në 6 miliardë € më 31 dhjetor 2021 (2020: 5.4 miliardë €). Rritja e totalit të aseteve në vitin 2021 ishte 11 për qind dhe ishte pak më e ulët krahasuar me rritjen nga viti i kaluar prej 12.6 për qind. Rritja e totalit të aseteve të bankave është nxitur kryesisht nga rritja e kredive dhe paradhënive për klientët, të cilat vazhduan të ishin kategoria kryesore e aseteve.

Vlen të theksohet se rritja e totalit të kredive dhe paradhënive është dyfishuar në vitin 2021, krahasuar me një vit më parë. Totali i kredive dhe paradhënive arriti vlerën prej 3.7 miliardë € (2020: 3.2 miliardë €), që është një rritje vjetore prej 15.5 për qind krahasuar me rritjen e vitit 2020 prej 7.1 për qind. Kjo rritje u mundësua kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesës për kredi të reja pasi ndikimi i COVID-19 u ul ndjeshëm pas një fushate të gjerë vaksinimi në gjysmën e dytë të vitit dhe kushteve të përgjithshme të favorshme të kreditimit të ofruara nga bankat.

Kreditë dhe paradhëniet për familjet arritën në 1.4 miliardë € ndërsa kreditë dhe paradhëniet për korporatat jofinanciare arritën në 2.3 miliardë € në fund të muajit dhjetor të vitit 2021. Rritja vjetore e kredive dhe paradhënive për ekonomitë familjare ishte 18.6 për qind, ndërsa për korporatat jofinanciare ishte 13.6 për qind. Përqendrimi i sektorit ekonomik të kredive dhe paradhënive për bizneset vazhdoi të dominohet nga sektori i tregtisë me një pjesë të përgjithshme prej 46 për qind, i ndjekur nga sektori i shërbimeve me 19 për qind dhe industria me 17 për qind. (Burimi: BQK, Buletini Mujo Statistikor, 21 dhjetor, nr. 244).



Sektori bankar ka bashkëpunuar edhe me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) për të nënshkruar marrëveshjet e garancisë për dritaret e garancisë në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) në fillim të vitit. Këto dritare garancie janë linja të reja garancie që synojnë të mbështesin ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) përmes garancive të kredisë. Kjo pako e rimëkëmbjes ekonomike parashikon rritjen e mbulimit me garanci kreditore deri në 80 për qind të vlerës së kredisë dhe gjithashtu do të ofrojë mundësinë e përfshirjes së fermerëve me Numër Identifikues të Fermerit (NIF). Për më tepër, dritaret e garancisë brenda PRE janë fokusuar në mbështetjen e kreditimit për sektorët e prodhimit, agrobiznesit, shërbimeve, tregtisë, me fokus të veçantë të gratë në biznes dhe bizneset e reja. PRE do të ketë vlerë të shtuar si për përfituesit


përfundimtarë (NMVM-të), të cilat janë financuar me kushte më të mira kreditimi në kohën e duhur, ashtu dhe për sektorin bankar i cili do të jetë në gjendje të ndajë një pjesë të madhe të rizikut të kredisë me FKGK.

Investimet e sektorit bankar në letra me vlerë, duke përfshirë obligacionet dhe bonot e thesarit ishin 684.4 milionë € më 31 dhjetor 2021 (2020: 584.3 milionë €), një rritje prej 17.1 për qind. Kjo pasqyroi rritjen e pozitës së përgjithshme të likuiditetit të bankave të Kosovës, e cila u ndikua nga rritja e depozitave të klientëve gjatë vitit.

Depozitat e klientëve kanë vazhduar të jenë kontribuuesi kryesor në financimin e aktiviteteve bankare. Më 31 dhjetor 2021, depozitat e klientëve përbënin mbi 82 për qind të totalit të detyrimeve të sektorit bankar. Mbështetja e lartë në financimin nga depozitat vendore, veçanërisht nga individët privatë, e bën atë mënyrën më të besueshme për financim në krahasim me opsionet e tjera dhe gjithashtu është shumë imune ndaj luhatjeve ndërkombëtare në tregjet financiare.

Totali i depozitave në sektorin bankar arriti në 4.9 miliardë €, me një rritje vjetore prej 541 milionë € ose 12.4 për qind (2020: 11.5 për qind). Struktura e depozitave në banka nuk ka ndryshuar gjatë viteve të fundit dhe ka më shumë depozita në llogaritë rrjedhëse dhe më pak në plasmanet e afatizuara dhe llogaritë e kursimeve, si pasojë e ambientit me norma të ulëta. Më 31 dhjetor 2020, depozitat e paafatizuara përbënin 68 për qind të totalit të depozitave, ndërsa pjesa tjetër ishin depozita të afatizuara dhe depozita kursimesh. Shumica e depozitave të klientëve janë depozita në Euro ku mbi 96 për qind të depozitave të sektorit bankar janë në Euro, valuta zyrtare e Kosovës. Norma mesatare e depozitave të afatizuara u ul me 0.17 pikë përqindjeje në vitin 2021 në 1.33 për qind krahasuar me 1.5 për qind në muajin dhjetor të vitit 2020. Norma e interesit për llogaritë e kursimeve mbeti e zvogëluar në 0.11 për qind nga 0.4 për qind në vitin 2020. Llogaritë rrjedhëse vazhduan të paguajnë zero interes.

Trendi i uljes së normave të interesit për kreditë ka vazhduar për kohë të gjatë duke e pasur parasysh faktin se, në periudhën e pas luftës, normat e interesit ishin më të larta se ato në rajon. Më 31 dhjetor 2021, norma mesatare efektive e interesit për kreditë u ul më tej në 5.8 për qind nga 6 për qind në periudhën e njëjtë në vitin 2020. Kjo ulje e normave të interesit për kredi mbuloi si bizneset ashtu edhe ekonomitë familjare (individët). Norma mesatare e interesit për kreditë e biznesit më 31 dhjetor 2021 ishte 5.72 për qind, ulje kjo nga 5.9 për qind sa ishte më 31 dhjetor 2020. Ndërsa norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare në muajin dhjetor të vitit 2021 ishte 5.95 për qind krahasuar me 6.2 për qind më 31 dhjetor 2020. (Burimi: Buletini Mujor Statistikor, 21 dhjetor, nr. 244).






Pas recesionit ekonomik në vitin 2020 të shkaktuar nga situata e pandemisë globale, sektori bankar në Kosovë ka arritur performancë të mirë të përgjithshme në treguesit kryesorë financiarë në vitin 2021, pas përmirësimit të situatës së përgjithshme ekonomike në vend. Të ardhurat e sektorit bankar u rritën në vitin 2021 në 322 milionë € nga 279 milionë € në vitin 2020. Pjesa më e madhe e të ardhurave krijohet nga të ardhurat nga interesi, të cilat u rritën nga 212 milionë € në 226.9 milionë € në vitin 2021. Shpenzimet totale u rritën në 204.6 milionë € nga 199.4 milionë € në vitin 2020, ndërsa shpenzimet e interesit në 24.4 milion € nga 20.9 milion € në vitin 2020. Nisur nga ky sfond, edhe fitimi neto i sektorit bankar ka shënuar rritje në 117.5 milionë € nga 79.9 milionë € në vitin 2020.

Në vitin 2021, kthimi në asetet mesatare i sektorit bankar u përmirësua me 0.7 pikë përqindje, duke arritur në 2.3 për qind (2020: 1.6 për qind). Kthimi në ekuitet mesatar u rrit në 19.5 për qind, nga 14 për qind në vitin 2020. Raporti i kredive ndaj depozitave të bankave ishte 76.5 për qind më 31 dhjetor 2020, nga 74.5 për qind më 31 dhjetor 2020. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (kapitali rregullator / pasuri të ponderuara me rrezik) ishte 15.3 për qind, nga 16.5 për qind më 31 dhjetor 2020. Ndërsa raporti i kredive joperformuese u përmirësua me 0.4 pikë përqindjeje nga 2.7 për qind në vitin 2020 në 2.3 për qind në fund të vitit 2021. Raporti i mbulimit të KJP u rrit në 151 për qind nga 141 për qind në vitin 2020.



Performanca dhe financat e Bankës Raiffeisen Kosovë

Shënim: Analizat e tregut janë bazuar në rezultatet preliminare të botuara nga bankat komerciale, të përgatitura sipas rregullave të Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës.

Gjithsej asetet e Bankës Raiffeisen në Kosovë sh.a. më 31 dhjetor 2021 ishin 1,195.9 milionë €. Kjo është një rritje prej 7.2 për qind krahasuar me një vit më parë (2020: 1,116 milionë €). Përqindja e pjesëmarrjes në treg të gjithsej asetëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte 20.1 për qind (2020: 21 për qind).



Struktura e asetëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të dominohet nga kreditë dhe paradhëniet për klientët. Më 31 dhjetor 2021, 65 për qind e gjithsej asetëve ishin të përqendruara në kredi dhe paradhënie për klientët pas provizionimit për humbjet nga kreditë. Kjo u pasua nga 15 për qind në letrat me vlerë të investimeve. Investimet në letra me vlerë përfshijnë investimet në obligacionet e qeverisë dhe korporatave të vendeve të BE-së dhe SHBA-së, si dhe bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Kosovës.







Investimet në letra me vlerë më 31 dhjetor 2021 ishin 174 milionë € (2020: 177 milionë €). Investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës ishin 48.7 milionë € (2020: 25 milionë €) dhe investimet në obligacione të qeverisë dhe të korporatave të vendeve të tjera të OECD ishin 125.3 milionë €. (2020: 152 milion €). Gjithsej kreditë dhe paradhëniet të Bankës Raiffeisen në Kosovë më 31 dhjetor 2021 ishin 778.2 milionë € (2020: 709.5 milionë €). Pjesëmarrja në treg në kredi dhe paradhënie më 31 dhjetor 2020 ishte 20.8 për qind (2019: 22.0 për qind).

Banka mori një sërë masash për të adresuar situatën e pandemisë COVID-19, duke ofruar kështu mundësinë për të përfutuar nga moratoriumi për ripagimin e kredisë. Procesi i ristrukturimit ishte i harmonizuar plotësisht me udhëzimet e Bankës Qendrore të Kosovës për një modifikim të tillë, ku i fundit është udhëzuesi për ristrukturimin e kredive për shkak të COVID-19, i publikuar në muajin shkurt të vitit 2021. Gjatë kulmit të krizës në vitin 2020, banka modifikoi deri në 60 për qind të portofolit të saj të kredive të papaguara. Kjo do të thotë se pagesat fillimisht u shtynë për një periudhë 3 mujore, por si pasojë e krizës moratoriumi u zgjat deri në 9 muaj gjithsej pa rezultuar në përkeqësim të historisë kreditore të klientit.

Banka Raiffeisen në Kosovë i ka llogaritur rezervat/lejimet për humbjet kreditore bazuar në politikat e rrezikut kreditor. Këto rezerva për humbje kreditore arrijnë në 26.5 milionë € (2020: 24 milionë €). Këto rezerva llogariten bazuar në modelin e humbjeve të pritshme kreditore sipas SNRF 9 dhe pasqyrojnë vlerësimin e Bankës Raiffeisen në Kosovë të rrezikut në portofolin kreditor më 31 dhjetor 2021. Rezervat totale për humbjet kreditore për kreditë joperformuese në vitin 2021 ishin 104 për qind (2020: 106 për qind).

Totali i depozitave të klientëve të Bankës Raiffeisen në Kosovë arriti në 1,023 milionë € më 31 dhjetor 2021 nga 916 milionë € më 31 dhjetor 2020. Kjo shënon një rritje prej 11.7 për qind. Gjenerimi i brendshëm i financave gjithashtu kontribuoi drejt një stabiliteti më të madh në sektorin bankar dhe uli ndikimin e çdo paqëndrueshmërie nga tregjet ndërkombëtare.





Kontribuuesi më i madh në depozitat e klientëve ishin llogaritë rrjedhëse me një pjesëmarrje prej 87 për qind. Llogaritë e kursimit kanë një pjesëmarrje prej 13 për qind të totalit të depozitave të klientëve të bankave. Depozitat e afatizuara nga klientët dhe llogaritë e tjera janë bars me më pak se 1 për qind të bazës totale të depozitave. Rritja në bilancet e llogarive rrjedhëse mund të shpjegohet gjithashtu me rënien e normave të interesit në treg për llogaritë e kursimeve dhe depozitat e afatizuara në vitet e fundit. Struktura e detyrimeve të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishte e dominuar nga depozitat e klientëve, dhe e njëjta gjë ndodhi edhe me tregun e Kosovës.

Në vitin 2021, kapitali aksionar i Bankës Raiffeisen në Kosovë mbeti i pandryshuar në 63 milionë €. Ekuiteti total më 31 dhjetor 2021 ishte 137.5 milion € (2020: 144 milion €), duke përfshirë gjithashtu 74.5 milion € në formën e fitimeve të pashpërndara. Banka Raiffeisen në Kosovë ka shpërndarë një dividendë në vlerë prej 32.4 milionë € gjatë vitit pas miratimit nga BQK-ja. Banka nuk ka paguar asnjë dividendë në vitin paraprak si rezultat i kufizimeve dhe limitimeve për shkak të COVID-19 nga BQK-ja.


Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë e kapitalizuar mirë, gjë që u pasqyrua në raportet rregullatore të vitit 2021 të kapitalit të Klasit 1 ndaj asetëve totale me rrezik të ponderuar prej 12.49 për qind (kërkesa ligjore mbi 9 për qind) dhe një raport të kapitalit total (përfshirë Klasin 2) ndaj asetëve me rrezik të ponderuar prej 13.8 për qind (kërkesa ligjore 12 për qind). Në llogaritjen e kapitalit të Klasit 2, Banka Raiffeisen në Kosovë ka përfshirë shumën prej 3.8 milionë € të borxhit të varur me një maturim fillestar prej dhjetë vjetësh, në përputhje me kërkesat rregullatore. Kërkesat e mësipërme të kapitalit u llogaritën në përputhje me rregulloren e BQK-së mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rregulloret dhe rregullat tjera rregullative të zbatueshme.

Të ardhurat neto pas tatimit në vitin 2021 ishin 26.3 milionë € (2020: 16.7 milionë €). Ky rezultat është llogaritur bazuar në Pasqyrat Financiare sipas SNRF-ve të përfshira në këtë raport. Pasqyrat sipas SNRF-ve i dërgohen Bankës Qendrore në baza të rregullta mujore dhe gjithashtu publikohen në baza tremujore në faqen e internetit të Bankës Raiffeisen në Kosovë si dhe në portalet lokale të lajmeve elektronike.

Të ardhurat e Bankës Raiffesen në Kosovë ishin të dominuara fuqimisht nga të ardhurat e gjeneruara nga kreditë dhe paradhëniet për klientët lokalë. Të ardhurat nga interesi për kreditë dhe paradhëniet vazhdojnë të jenë burimi kryesor i të ardhurave me gjithë rënien e normave për kredi në treg si dhe kthimeve shumë të ulëta e nganjëherë negative në bonot e lëshuara nga qeveritë e OECD-së ose plasmaneve të tregut të parave.


Zhvillimi dhe struktura e të ardhurave bruto

Në milionë euro



Zhvillimi i shpenzimeve të përgjithshme administrative

Në milionë euro



Në vitin 2021, të ardhurat neto nga interesi u rritën në krahasim me një vit më parë me 2.7 për qind, duke treguar shenja të rimëkëmbjes ekonomike.

Të ardhurat nga tarifrat dhe komisionet u rritën ndjeshëm në vitin 2021. Rritja e të ardhurave neto nga tarifrat dhe komisionet ishte 50 për qind nga një vit më parë. Kjo u nxit nga hapja e ekonomisë si rezultat i masave më të relaksuara kundër COVID-19. Rritja është kryesisht në biznesin e pagesave bankare, i cili ka pasur rritje të aktivitetit në periudhën aktuale raportuese si rezultat i numrit të madh të transaksioneve nga diaspora gjatë gjithë vitit dhe më shumë gjatë verës. Ndërsa të ardhurat e tjera u rritën si rezultat i rritjes së aktivitetit nga Qendra e Kompetencës së bankës. Këto shërbime jobankare përfshijnë të ardhura që lidhen me një numër të kufizuar shërbimesh të TI-së të ofruara për Zyrën Qendrore të RBI në Vjenë dhe kompani të tjera të konsoliduara të RBI.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative më 31 dhjetor 2021 ishin 32.5 milion € (2020: 30.8 milion €). Raporti i kostove ndaj të ardhurave ishte 47 për qind (2020: 54 për qind). Kostot më të larta raportohen në kostot operative të bankës. Kjo ndikohet kryesisht nga kostot e stafit, të cilat përfshijnë kostot, të tilla si pagat, trajnimi dhe zhvillime të tjera profesionale të punonjësve. Këto kosto vazhduan të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve operative. Këtë vit, banka njohu gjithashtu një humbje të modifikimit të kredive prej 114 mijë € (2020: 173 mijë €), e cila u llogarit si rezultat i shtyrjeve të pagesave në moratoriumet e kredive të vendosura për shkak të pandemisë COVID-19.

Theuari, menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve

Viti 2021 do të mbahet mend si vit i vazhdimit të pandemisë dhe procesit të vaksinimit, hapjes së lehtë të ekonomisë dhe rritjes së çmimeve të mallrave dhe pritjeve për rritje të inflacionit. Kosovarët ruajtën besimin e tyre në sistemin bankar për kursimet e tyre dhe morën kredi për bizneset dhe familjet e tyre, duke rezultuar në rritjen më të lartë të kredive dhe depozitave.

Tërheqja e një pjese të pensione në fund të vitit 2020, në shumën prej afër 200 milionë për të gjithë sektorin bankar, ka kontribuar në rritjen e përgjithshme të likuiditetit në sektorin bankar gjatë vitit 2021, krahas rritjes shumë të qëndrueshme të depozitave në Kosovë ndër vite.

Banka Raiffeisen në Kosovë përdor modelimin sasior për të matur pandryshueshmërinë e depozitave të klientëve për asetet dhe detyrimet e saj jomaturuese, për qëllime të rrezikut të normës së interesit, por edhe për qëllime të rrezikut të likuiditetit, si për klientët individualë (retail) ashtu edhe për klientët korporata (joretail). Efekti i përbashkuar i një pozicioni likuiditeti të lartë dhe një pozicioni të lartë pandryshueshmërie të depozitave prodhon një pozicion të qëndrueshëm likuiditeti.

Në fund të vitit 2021, banka kishte një Raport të Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) mbi 158 për qind, dhe Raport të Mbulueshmërisë së Likuiditetit (LCR) prej 545 për qind. Të dy raportet tregojnë rritje në krahasim me fundin e vitit 2020. Likuiditeti i bankës përbëhet nga mbajtja e investimeve në para nëpër degë, Bonot Qeveritare, Bonot e FI dhe investimet në Tregun e Parasë.

Rreziku i normës së interesit në librin bankar dhe strategjia

Banka Raiffeisen në Kosovë në disa pjesë ka rritur kohëzgjatjen e normës së saj të interesit për bonot dhe strategjia e saj parashikon transformim pozitiv të maturitetit të bankës në një mjedis me kthime më të ulëta. Kjo qasje ishte jashtëzakonisht e dobishme në situatën e paqëndrueshme të pandemisë. Për më tepër, një përqindje më e lartë e kredive të klientëve me normë të ndryshueshme, krahasuar me vitet më parë, u mundëson klientëve të përfitojnë nga kthime më të ulëta, ndërsa banka mban marzhën e saj fikse. Pozicionimi i duhur dhe i kujdesshëm i bilancit të normës së interesit është shumë i rëndësishëm për menaxhmentin dhe aksionerët e bankës.

Në një kontekst më të gjerë: tabela më poshtë tregon ekspozimet e fitimit dhe humbjes sipas valutës për ndryshim prej 1 pike bazë në kurbë. Banka mban ekspozime afatgjata fikse dhe afatgjata variabile, siç përshkruhet në tabelën më poshtë. Banka aktualisht nuk është e angazhuar në ALM aktive por ofron dhe mirëmban produkte me normë të ndryshueshme për të përmirësuar ndryshueshmërinë e aseteve të bankës.

Reziqet e normave të interesit në menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve

Vlera e Pikës Bazë BPV

Valuta	Ekspozimet e valutës së vetme	< 6 muaj	<5V	5-7V	Mbi 7 vite	Above 7 yrs
Totali	23,723					
CHF	(2)	(10)	8	-	-	-
EUR	20,296	(230)	(6,654)	84,017	(30,845)	(25,992)
GBP	2	(4)	2	-	-	-
USD	3,423	85	(535)	3,874	-	-

Në vazhden e pritjeve për inflacionin, pritet që normat të arrijnë fundin. Vlera e pikës bazë (BPV) të normave të interesit në vitin 2021 tregoi një rritje të pozicionit të BPV në fund të vitit prej rreth 8 mijë BPV në pothuajse 24 mijë euro për BPV.

Letrat me vlerë të qeverisë / korporatave FI


Banka rriti zotërimet e saj të investimeve financiare në vitin 2021, duke e mbyllur vitin me një volum prej 174 milionë €. Rritja e volumit është e ngjashme me rritjen e përjetuar në vitin 2019. Bankat duhet ta mbajnë shumicën e aseteve në Asete Likuide të Cilësisë së Lartë, në mënyrë që ta përmbushin likuiditetin e tyre të detyrueshëm (të kërkuar ligjërisht). Një pjesë shumë e vogël e portofolit i është alokuar pozicioneve të FI, dhe portofoli i përgjithshëm dominohet nga letrat me vlerë të qeverisë. Tabela e mëposhtme paraqet alokimin aktual të saj në fund të vitit 2021.

Sistemi i përdorur i **Vlerësimit të Moody-t** si % e alokimit të bonove në tabelën më poshtë:

EUR	<0.5Y	<1Y	<2Y	<3Y	<=5Y	
Aaa	20.7%	13.3%				
A1			2.8%			
A2			1.7%			
None (*)	5.1%	10.3%	6.8%	9.5%	9.1%	0.6%
A3	16.44	-	-	-	-	
Non.R	4.03	-	5.53	2.17	2.43	
USD	<0.5y	<1y	<2y	<3y	<4y	<5y
Aaa	7.2%	6.7%	5.3%			
A2		0.3%	0.5%			

(*) Kjo kategori përfaqësohet kryesisht nga obligacionet e Kosovës.

Paralelisht, tregu total për bonot e thesarit të Kosovës vazhdoi ritmin e zhvillimit. Në rolin e saj si tregtues (dealer) kryesor, Banka Raiffeisen në Kosovë dhe klientët e saj vazhduan të përcaktojnë krijimin e tregut sekondar të borxhit të qeverisë të Kosovës, megjithëse me një ritëm më të ngadalë për shkak të atraktivitetit të tij në rënie, duke pasur parasysh kthimet më të ulëta të arritura në disa vitet e fundit. Raporti shuma e kërkuar/shuma e emetuar (Bid to Cover) në Ankandin e Kosovës ka abonim/regjistrim të mirë, duke treguar për një treg shumë likuid në ankandet parësore. Tregu sekondar është ende i pazhvilluar.



Shitjet në tregje

Banka Raiffeisen në Kosovë është lidere në shitjet valutore që nga viti 2002 në Kosovë. Megjithëse në një vend ku përdoret valuta Euro, Banka Raiffeisen në Kosovë mban pozicionin e saj si lidere e tregut në shitjet FX dhe shitjet e brokerimit në tregun sekondar për bonot e thesarit dhe shitjet e ekuitetit. Që nga viti 2019, banka ka vënë në dispozicion sistemin elektronik të tregimit për klientët e saj dhe llogarinë elektronike të shitjeve FX për pjesën më të madhe të biznesit të shitjeve FX në vitin 2021.

Për më tepër, numri i klientëve që tregtojnë në ekuitet dhe fonde u rrit në vitin 2021. Klientët shfrytëzuan mundësinë për të investuar në tregjet e maturuara të ekuitetit në vitin 2021 dhe Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdon të jetë ofruesi kryesor i një porte hyrëse (gateway) të tregut ndërkombëtar që nga viti 2012.

Produktet e shitjes të tregut të kapitalit

Aplikacioni Mobil FX Raiffeisen - Pas lansimit të suksesshëm të aplikacionit FX Raiffeisen për klientët e korporatave dhe FI në fund të vitit 2019, banka lansoi versionin e saj mobil të aplikacionit në vitin 2021. Ai u mundëson klientëve të tregtojnë në zona të ndryshme kohore në valuta FX.

Aplikacioni FX Raiffeisen në web dhe FX Raiffeisen mobil - Ky ishte një hap i rëndësishëm për të siguruar që Banka Raiffeisen në Kosovë të ruajë liderшипin e saj për sa i përket shitjeve valutore në industrinë bankare në Kosovë. Digjitalizimi i proceseve për tregtimin dhe shlyerjen e ndihmoi bankën t'i reduktojë ndërprerjet gjatë kohës së pandemisë dhe të ofrojë përvojë të shkëlqyer në fushën e shitjeve valutore dhe pagesave ndërkombëtare në importe dhe eksporte jo në valutë euro. Kosova ka pasur rritje të konsiderueshme të hyrjeve të remitencave në vitin 2021 dhe Banka Raiffeisen në Kosovë me teknologjinë e saj ka qenë mundësuesi më i rëndësishëm në treg për remitencat jo në euro, pasi ka mbledhur pjesën më të madhe të të hyrave FX në tregun bankar, duke arritur në 1.93 milionë € vetëm në FX për vitin 2021.

Krijimi i librit të obligacioneve retail të MFE – Pas vendimit të Ministrisë së Financave të Kosovës për emetimin e obligacioneve të para retail në muajin gusht të vitit 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë ka qenë banka kryesore në krijimin e librit për shkak të segmentit të saj të klientëve të pasur bankarë. Banka konfirmoi edhe njëherë rolin e saj në treg si lidere kryesore.

Bonot e thesarit / obligacionet e Kosovës – Banka Raiffeisen në Kosovë është gjithashtu lider në bonot e thesarit në alokimin e tregut sekondar, si për nga numri i tregtimeve ashtu edhe për nga vëllimet.

Fondet e menaxhimit të kapitalit dhe brokerimi në aksione të Raiffeisen – Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur të rrisë në mënyrë të konsiderueshme numrin e klientëve të saj në vitin 2021. Ajo u ofron atyre qasje në tregjet ndërkombëtare të aksioneve si NYSE, NASDAQ, XETRA/XFRA dhe shumë bursa të tjera me qasje në më shumë se 20 mijë aksione, fonde të tregtuara në bursë (ETFs).

Segmentet e biznesit

Korporata

Kombinimi i fuqisë financiare, bazës së lartë të kapitalit dhe njohurive dhe ekspertizës së thellë të pronarëve të produkteve dhe të marrëdhënieve korporative mundëson që biznesi i korporatave të Bankës Raiffeisen në Kosovë të ketë pozicion unik në krahasim me konkurrencën. Si rezultat, banka vazhdoi të ruajë pozicionin e saj si lidere e tregut në Kosovë duke mbështetur më tej rritjen e klientëve të saj marrëdhëniesorë dhe përvetësimin e klientëve të rinj në vitin 2021.

Një nga prioritetet kryesore të bankës ishte mbështetja e klientëve që të tejkalojnë situatën e vështirë dhe të paparashikueshme të krijuar nga COVID-19, duke siguruar pajtueshmëri me rregullativën dhe duke menaxhuar në mënyrë aktive parandalimin e delikuençave. Pavarësisht vështirësive të përgjithshme që rrjedhin nga situata pandemike, biznesi i korporatave vazhdoi të ketë performancë shumë të mirë gjatë vitit 2021 dhe rriti portofolin e kredisë me 6.2 për qind. Një portofol i kolateralizuar shumë mirë gjithashtu rezultoi në një kthim të qëndrueshëm në kapitalin e korigjuar për rrezikun (RoRAC) prej 149 për qind. Prioritet i lartë iu dha gjithashtu sigurimit të përputhshmërisë së plotë me kërkesat e rritura rregullatore, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar, po ashtu edhe me kërkesat e grupit.

Në fillim të vitit 2021, Raiffeisen Bank International (RBI) është bërë palë nënshkruese zyrtare e Parimeve të OKB-së për Shërbime të Përgjegjshme Bankare. Duke qenë bankë e rritjet të RBI, Banka Raiffeisen në Kosovë i ka përcaktuar qëllimet dhe ambicien për të qenë bankë lidere në Kosovë për biznes të qëndrueshëm / ESG. Gjatë vitit 2021, fokusi ka qenë në krijimin e strategjisë për financimin e ESG, së bashku me trajnimin dhe ngritjen e vetëdijesimit si në nivel të brendshëm ashtu edhe në nivel të jashtëm. Qëllimi në kuadër të kësaj strategjie është orientimi i rrjedhës së financimit drejt klientëve të cilët janë të gatshëm ta zhvendosin modelin e tyre të biznesit në një ekonomi të gjelbër dhe të ndikojë në institucionet qeveritare që ta konsiderojnë Bankën Raiffeisen në Kosovë si partner për zbatimin e Agjendës së Gjelbër.

Për të mbështetur këtë qëllim, segmenti i korporatave filloi të rrisë fokusin në këtë temë me klientët, duke i bërë të gjitha përpjekjet për të nënvizuar interesin në rritje për financimin e tranzicionit drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe mbështetjen e rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo u reflektua edhe në rezultate konkrete në vitin 2021, duke shtuar një portofol të gjelbër dhe social prej 10.7 milionë € në kreditimin e Bankës për klimën dhe eficientësinë e burimeve. Në vitin 2022 janë planifikuar aktivitete më intensive për promovimin e agjendës mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG).

Ndërmarrjet e vogla

Viti 2021 vazhdoi të jetë një vit sfidues për ndërmarrjet e vogla në përgjithësi në Kosovë duke pasur parasysh ndikimin e COVID-19. Kështu, fokusi i bankës ishte në identifikimin e mundësive se si të ofronte mbështetje për klientët NV për të kapërcyer këtë situatë të paparashikuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Segmenti i Ndërmarrjeve të Vogla (NV) vazhdoi të kultivojë marrëdhëniet me klientët përmes menaxherëve me përvojë të marrëdhënieve të vendosur në katër rajone të Kosovës. Si rezultat, banka arriti të mbajë një portofol relativisht të qëndrueshëm të kredive të NV-ve me një cilësi shumë të mirë, si dhe duke rritur numrin total të klientëve NV gjatë vitit nën shqyrtim.

Në nivel të brendshëm janë marrë disa iniciativa në efikasitetin e projektit gjatë vitit 2021, pasi që një model i ri shërbimi ka qenë në dispozicion për ekipin e shitjeve të NV nga muaji janar i vitit 2021. Shumica e këtyre nismave u përqendruan në thjeshtimin e përvojës së klientit, duke e bërë atë më të kursyer ("lean") ose të përshtatshme për madhësinë dhe kompleksitetin e aplikacioneve. Përveç rritjes së thjeshtësisë, fusha kryesore e fokusit ishte digjitalizimi i procesit për klientët NV për të aplikuar për kredi, duke u mundësuar Menaxherëve të Marrëdhënieve të NV të kenë një pamje 360 shkallë në dosjen e klientit dhe kohë shumë më të shpejtë të miratimeve, të cilat pritet të çojnë në një rritje të konsiderueshme të efikasitetit dhe përmirësim të përvojës së klientit.

Ndërmarrjet mikro

Ndërmarrjet mikro ishin më të goditurat nga COVID-19 dhe kjo bëri që Banka Raiffeisen në Kosovë të dalë me veprime dhe përshtatje të ndryshme. Kjo qasje e re e bankës si dhe prezantimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, u mundësoi klientëve të rikuperojnë ndjeshëm aktivitetet e tyre të biznesit. Si rezultat, Banka Raiffeisen në Kosovë ka arritur rezultatet

më të mira ndonjëherë në segmentin mikro, duke rritur kreditë, depozitat, si dhe fitimin që lidhet me këtë kategori të klientëve të mikrobiznesit.

Segmenti mikro brenda bankës kombinon qasjen tradicionale me avancimet moderne teknologjike në ofrimin e një shërbimi unik dhe të përqendruar te klienti. Kështu, në nivel dege, banka operon në shtatë rajone dhe çdo menaxher rajonal është i pajisur me mjetet dhe teknologjinë e nevojshme për të operuar edhe në distancë. Koncepti i distancës është përmirësuar më tej me shërbimet këshillimore përmes "RaiConnect" ku klientët mund të marrin një pasqyrë të avancuar dhe analiza mbi nevojat e tyre financiare dhe menaxhimin. Nëpërmjet kësaj qasjeje, segmenti përpiqet të theksojë fokusin në marrëdhëniet me klientët duke zgjeruar shtrirjen e klientëve dhe duke u ofruar atyre të gjitha shërbimet financiare dhe këshilluese që u nevojiten. Gjatë vitit 2021, segmenti mikro ka ofruar shërbime për 16208 mikro biznese. Këta klientë, përveç shërbimeve tradicionale bankare, mund të mbështeteshin edhe në zonat e vetëshërbimit të inkorporuara në rrjetin e degëve si dhe në qendrën e kontaktit e cila është në dispozicion 24/7.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në segmentin mikro ishte bashkëpunimi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bashkimin Evropian në Kosovë në lansimin e "Programit për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë". Nëpërmjet një kontrate prej pesë milionë euro, programi synon rritjen e kapaciteteve dhe proceseve të mikrobizneseve dhe mbështetjen e tyre në arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian (BE) veçanërisht në fushën e cilësisë së produkteve, shëndetit, sigurisë në punë dhe faktorëve mjedisorë. Përmes këtij programi, përveç financimit, klientët mikro mund të përfitojnë edhe asistencë teknike të ofruar në zbatimin e projektit, si dhe një grant prej 15 për qind të shumës totale të kredisë pas përfundimit të projektit. Përmes modernizimit të aktiviteteve, klientët mikro do të jenë në gjendje të gjenerojnë më shumë mundësi biznesi në rajon dhe në tregun evropian.

Klientët individë, premium dhe degët

Duke qenë fizikisht e pranishme në të gjitha rajonet e Kosovës me 39 degë dhe nëndegë, Raiffeisen Bank në Kosovë përfaqëson rrjetin më të madh të degëve në treg. Një nga iniciativat kryesore, 'Programi i Transformimit të Degëve' vazhdoi të zbatohet në vitin 2021. Qëllimi i programit ishte optimizimi i rrjetit të degëve përmes konsolidimit të ambienteve në degë më efikase dhe kosto-efektive, për të eksploruar mundësitë për përvojë më të mirë të klientit dhe rritje të të ardhurave duke rritur kapacitetet e shitjeve me një qasje të stafit me detyra të shumëfishta. Dega e rishpikur ofron një sërë veçorish të reja si zona e re e vetëshërbimit në të cilën klienti mund të përdorë shërbimet bankare online 24/7, një hapësirë komode por diskrete për t'u takuar dhe për të diskutuar çështjet financiare, me një nuancë moderne dhe me kënd digjital, si dhe produkte të reja si "Glory ATM", i cili përdoret për depozita të mëdha nga klientët e biznesit.

Gjatë vitit 2021 u rinovuan tre degë kryesore dhe katër nëndegë, të cilat përfshinin përmirësimin ose shtimin e zonave të vetëshërbimit. Kjo përfundimisht rezultoi në rritjen e numrit të përgjithshëm të zonave të vetëshërbimit në 39 të tilla. Për të përmirësuar më tej përvojën e klientit dhe për të përmbushur nevojat e tyre në përputhje me rrethanat, banka ka rritur numrin e punonjësve të shitjeve në degë me gjashtë për qind. Për më tepër, banka ka shtuar shërbime të përshtatshme në para të gatshme për klientët në të gjitha degët e Bankës Raiffeisen në Kosovë.

Duhet theksuar se 'Programi i Transformimit të Degëve' është plotësuar me promovimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të edukimit të klientëve, të cilat në mënyrë të pashmangshme rezultuan në rritje të preksme të përdorimit të kanaleve digjitale. Krahas fushatave të ndryshme ndërgjegjësuese digjitale, një tjetër faktor që ndikoi shumë në ndërgjegjësimin e klientëve për përfitimet e përdorimit të kanaleve digjitale ishte edhe rritja e numrit të punonjësve të shitjeve në degë. Punonjësit e degëve kanë punuar nga afër me klientët duke u ofruar atyre mbështetje konkrete dhe duke e bërë shumë më të lehtë rrugëtimin e tyre drejt përdorimit të bankimit digjital.

Krahas transformimit të degëve, banka arriti të dizajnojë dhe zhvillojë platformën/aplikacionin e saj të komunikimit që përdoret për komunikim të drejtpërdrejtë në distancë ndërmjet Zyrarëve të Marrëdhënies dhe klientëve. Ky shërbim i ri quhet "RaiConnect" dhe qëllimi i tij është t'u japë klientëve mundësinë të kenë komunikim të drejtpërdrejtë në distancë me bankën dhe të shkëmbejnë skedarë, të ndajnë skedarët në mënyrë të sigurt, të bashkëshfletojnë etj. Në një farë mënyre, "RaiConnect" do t'u mundësojë klientëve të marrin shërbimet e degëve nga shiëpia apo zyra e tyre. Aktualisht, banka ka gjashtë zyrarë të marrëdhënies në distancë dhe në bazë të përdorimit, do të zgjerojë numrin e tyre në përputhje me rrethanat.

Një tjetër kanal që kontribuon në shitjen e produkteve dhe shërbimeve bankare është Rrjeti i Agjentëve të Shitjeve. Ky ekip i mundëson Bankës qasje të menjëhershme në tregun e synuar me qëllim që të jenë pranë klientëve potencialë. Në të njëjtën kohë, klienti do të përfitojë nga prezantimi dhe shitja e drejtpërdrejtë personale e produkteve ose shërbimeve zakonisht në shtëpitë e tyre ose në vendet e tyre të punës. Ekipi prej 25 agjentëve të shitjeve është i pranishëm në të gjitha degët.

Nisur nga të gjitha këto zhvillime në vitin 2021, segmenti i individëve privatë dhe i bankimit të klientëve të begatë (afluent) arriti të regjistrojë një rritje të ndjeshme në portofolin e tij të kredisë, të rrisë limitin e kredisë personale në 30,000 € përkatësisht 35,000 € për klientët në masë dhe të begatë, si dhe vazhdoi të ruajë pozicionin e liderit në treg për sa i përket NPS, duke konfirmuar kënaqshmërinë e klientëve me produktet dhe shërbimet e bankës.

Produktet dhe shërbimet bankare

Produktet dhe shërbimet e korporatave dhe NV-ve

Në vitin 2021, digjitalizimi dhe inovacioni shërbyen si udhërrëfyes në përditësimin dhe lansimin e produkteve dhe shërbimeve të reja në segmentin e korporatave dhe NV-ve të Bankës Raiffeisen në Kosovë. Më poshtë do të jepet një përshkrim i shkurtër i disa prej zhvillimeve kryesore që ndodhën.

E-Finance (Shërbimi unik i huadhënies online për klientët e korporatave) - Në bashkëpunim me Raiffeisen Bank International (RBI), Banka Raiffeisen në Kosovë futi në përdorim platformën e re të huadhënies online për klientët e saj të korporatave, e cila është teknologji unike dhe moderne. Nëpërmjet platformës digjitale MyRaiffeisen të RBI-së, klientët e korporatave në e-Finance tani mund të aplikojnë lehtësisht për kredi me afat për investime ose një linjë kredie për kapital qarkullues shumëqëllimësh në mënyrë digjitale. Në një proces transparent, klientët mund të transmetojnë në mënyrë të sigurt dokumentet e nevojshme në mënyrë digjitale, të negociojnë me Bankën Raiffeisen gjatë gjithë procesit deri në nënshkrimin e kontratave dhe përdorimin e limiteve. Konsumatorët gjithashtu mund të komunikojnë me Menaxherët e tyre të dedikuar të Marrëdhënies drejtpërdrejt përmes eFINANCE. Numri fillestar i klientëve të integruar (onboarded) dhe aplikimet e bëra në mënyrë digjitale nëpërmjet e-Finance janë shumë premtuese dhe banka pret që në vitin 2022, numri i tyre të rritet ndjeshëm.

Future CMI@web - U ofron klientëve të bankës mundësinë që të iniciojnë një pagesë përmes një shenje të vetme në platformë me RBI-në dhe të gjitha bankat e rrjetit si dhe të procesojnë këto pagesa brenda pak sekondash. Future CMI@web është platforma e parë bankare online e këtij lloji.

Procesi i depozitave/arkëtimit është digjitalizuar - Në vitin 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë prezantoi makinerinë e re të depozitimit të parave të gatshme "Glory machine" të përshtatshme për depozita të vëllimeve të larta për të përmbushur nevojat e klientëve të NV-ve dhe Korporatave. "Glory machine" merr vëllime 10 herë më të larta dhe siguron një kohë më të shpejtë të procesimit të transaksioneve kundrejt bankomatëve. Gjithashtu ofron një dhomë të veçantë për depozitimin e parave nga klientët. Në përgjithësi, kjo zgjidhje unike i mundëson klientit të marrë shërbim të shpejtë, të sigurt dhe 24/7.

eKYC (Know Your Customer/Njih klientin tënd) në platformën Raiffeisen Plus - Zgjidhja e-KYC (Njih klientin tënd) për klientët e korporatave dhe ndërmarrjeve të vogla u integrua në Raiffeisen Plus. Avantazhi i zgjidhjes e-KYC për klientët e korporatave dhe NV-ve është 'Fuqizimi i klientit' duke i ofruar klientit mundësinë për t'u regjistruar online dhe për të përditësuar informacionet e KYC me një proces të përshtatshëm dhe të thjeshtë. Pas përmirësimeve të vazhdueshme të bëra në platformat e reja i/m Banking, 94 për qind e transaksioneve të klientëve të Korporatave dhe NV-ve u kryen përmes bankimit në internet dhe atij mobil.

Factoringu (i rekursit dhe i kundërt), një produkt dhe shërbim unik në treg - Banka Raiffeisen në Kosovë ishte banka e parë që prezantoi produktet e Faktoringut në vend pothuajse një dekadë më parë në vitin 2012, dhe mbetet e vetmja bankë që ofron Faktoring të Rekursit dhe të Kundërt (Konfirmimi). Pavarësisht sfidues në vitin 2021, Faktoringu arriti 39 milionë € qarkullim. Faktoringu me 'karakterin e tij të pasiguruar' (logaritë e arkëtueshme si kolateral) ka avantazh pozitiv për NVM-të që dëshirojnë të rriten. Norma e penetrimit e faktoringut e BPV-së është ende larg nivelit të vendeve të tjera evropiane, por trendi pozitiv është në rritje nga viti në vit. Qëllimi është t'i ofrohet hapësirë dhe më shumë siguri një biznesi dhe të intensivkohet partneriteti, duke vazhduar me ndryshimin e perceptimeve dhe të kuptuarit për natyrën dhe karakteristikat e produktit, gjë që do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të Faktoringut dhe tregut të përgjithshëm bankar në Kosovë.

Produktet dhe shërbimet bankare retail

Për produktet dhe shërbimet bankare retail, zgjidhjet digjitale, inovacioni dhe transformimi mbetën prioritet edhe në vitin 2021. Kjo qasje i mundëson bankës të ofrojë lehtësi për klientët si dhe përvojë superiore të klientit. Përveç disa zgjidhjeve digjitale retail që u prezantuan në vitin 2020, disa nga pikat kryesore në vitin 2021 ishin këto në vijim..

Raiffeisen Plus dhe Mobile E-Banking – Kjo platformë e bën të lehtë përvojën bankare të klientit duke pasur kontroll të plotë mbi financat përmes pajisjes së tyre mobile 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë. Duhet përmendur se platforma është e thjeshtë, ka ndërfaqe miqësore për përdoruesit dhe ofron shërbime në kohë reale. Gjatë vitit 2021, më shumë se 55 për qind e klientëve retail janë regjistruar për të përdorur aplikacionin mobil të bankës. Prej më shumë se dy vitesh, qasja 'Fuqizimi i klientit' mundëson regjistrimin online në platformë si dhe përdorimin e të dhënave biometrike (pa kredenciale). Në vitin 2021, u shtuan veçori të reja për t'u ofruar klientëve një përvojë edhe më të mirë të aplikacionit.

Karakteristikat e reja përfshijnë: njoftimet shtytëse (push), llojin e ri të pagesave dhe përmirësimet e UX/UI dhe integrimin e miniaplikacioneve të mençura (smart widgets). Aplikacioni i Bankës Raiffeisen ka vazhduar të jetë aplikacioni i parë bankar në treg në rezultatet NPS dhe ka marrë vlerësimin më të mirë të aplikacionit me mesatare 4.7, duke qenë gjithashtu aplikacioni financiar më i shkarkuar në Kosovë.

Procesi i hapjes së llogarisë online – Në vitin 2021, rrugëtimi ekzistues i klientit për të nisur procesin e hapjes së llogarisë online u ridizajnuar duke siguruar një proces shumë më të mirë dhe më të shpejtë. Komentet vlerësuese nga klientët ishin kontributi kryesor për të pasur një rrugëtim krejtësisht të ri të përdoruesit, përvojë të përmirësuar të klientëve dhe procese burokratike të lëna pas. Platforma ka integruar edhe proceset e detyrueshme të KYC dhe AML, duke u mundësuar kështu klientëve të kryejnë pothuajse të gjithë procesin e hapjes së llogarisë online.

Përditësimi i shërbimit e-commerce - Gjatë vitit 2021, Banka Raiffeisen lansoi llojin e ri për pagesa në shërbimin e-commerce. Banka implementoi mundësinë e pagesës me këste me kartelë të kreditit për blerjet online me tregtarët që kanë e-commerce. Qëllimi kryesor i kësaj mënyre fleksibile të pagesës ishte rritja e kënaqshmërisë së klientit gjatë përdorimit të kartelave të kreditit.

Kartela e kreditit "Visa Premium" - Kjo nismë është vazhdimësi e sjelljes së një kartele të re dhe veçorive të reja të produktit në treg duke u ofruar klientëve përvojë unike e cila shquhet kryesisht për një listë të përfitimeve dhe privilegjeve që i ofrohen klientit duke paguar me kartelë të kreditit. Kartela e kreditit "Visa Premium" është e para e këtij lloji në tregun bankar të Kosovës dhe është e dedikuar për klientët premium. Përfitimet e kartelës përfshijnë, por nuk kufizohen në, dy hyrje pa pagesë në sallone të biznesit (business lounges) në aeroporte gjatë një viti, një numër zbritjesh kur blini në Agoda, Avis dhe tregtarë të tjerë, si dhe ofrim të informacione ndërkombëtare mbi ndihmën mjekësore dhe udhëzime udhëtimi. Klientët që posedojnë kartelë të kreditit "Visa Platinum" mund të përfitojnë edhe blerje me këste pa interes, si një nga karakteristikat më të kërkuara nga klientët në treg.

RaiPay – Në vitin 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë ka vazhduar të jetë banka e vetme që ka ofruar portofolin digjital me emër brendi RaiPay me dy brende të kartelave Visa & Master Card. Karakteristika të reja iu shtuan RaiPay, që është funksional për pajisjet që përdorin sistemin operativ Android: përmirësimi i RaiPay UI (pamja/user interface) dhe UX (përdorimi/user experience); autentikimi me gjurmë të gishtërinjve; mundësi për të parë gjendjen në dispozicion të të gjitha kartave të regjistruara; mundësi për të parë historinë e plotë të transaksioneve (transaksionet me NFC dhe me kartela); mundësi për të parë limitet e shpenzimeve të kartelës dhe shumën e transaksionit; detajet e kartës (4 shifrat e fundit të tokenit) dhe opsionet për të ndryshuar gjuhën e aplikacionit. Në vitin 2021, RaiPay regjistroi 100 për qind rritje në numrin e përdoruesve aktivë, 18 për qind rritje në numrin e transaksioneve dhe 27 për qind rritje në vëllim.

Chatbot - Chatbot si një nga shërbimet më tërheqëse gjatë vitit 2021 është në dispozicion të klientëve tash e dy vite, si në Viber ashtu edhe në Facebook Messenger. Klientët mund të marrin informacione 24/7 për produktet dhe shërbimet bankare në mënyrë të lehtë përmes faqes së internetit të bankës si kanal shtesë.

Përvoja e klientit

Në vitin 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë ka zbatuar me sukses procesin sistematik të mbledhjes së komenteve kthyese që na mundëson të kapim perceptimet dhe komentet kthyese të klientëve pas çdo ndërveprimi me kanalet e bankës dhe në të gjitha pikat e kontaktit. Përveç këtyre përpjekjeve, mendësia e punës agjile na mundësoni t'i përkthenim gjetjet nga këto sondazhe në përmirësime të vazhdueshme. Pikat e identifikuar të shqetësimeve të klientëve u përdorën për të përmirësuar produktin dhe shërbimet, për të përshtatur ndryshimet bazuar në komentet e klientit dhe për të transformuar rrugëtimet kryesore duke vënë klientin në qendër të këtij transformimi.

Për më tepër, gjatë vitit 2021, Banka Raiffeisen zbatoi dy procese organizative të përhershme me fokus në reagimet vijuese ndaj të anketuarve për t'i sjellë vlerë angazhimit dhe përkushtimit të klientëve dhe në të njëjtën kohë për të krijuar veprime përmirësimi bazuar në komentet kthyese dhe pikat e shqetësimeve të klientëve. Gjithashtu, banka për herë të parë lansoi një program të dedikuar mësimor me temën e përvojës së klientit. Programi mësimor filloi me lansimin e një programi mësimor special të dizajnuar dhe konsiderohet si kontribues i rëndësishëm afatgjatë për të mbajtur një organizatë që jo vetëm thekson shërbimin ndaj klientit, por kultivon një këndvështrim të orientuar drejt klientit për çdo ndryshim dhe vendim të mundshëm.

I gjithë ky spektër i aktiviteteve madhore të ndërmarra historikisht në qeverisjen e Përvojës së Klientit, dhe më e rëndësishmja aktivitetet gjatë vitit 2021 në Raiffeisen Bank, kanë ndërthurur një bazë të fortë për ofrimin e përvojave të shkëlqyera, të thjeshta dhe pa stres që ndikuan drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës së përgjithshme të klientit, që është vizioni dhe misioni kryesor i Bankës Raiffeisen.

Menaxhimi i rrezikut

Menaxhimi aktiv i rrezikut është kompetencë thelbësore e Bankës Raiffeisen në Kosovë. Banka njih rëndësinë e një kulture të fortë, e cila i referohet qëndrimeve, vlerave dhe standardeve të përbashkëta që formësojnë sjelljet që lidhen me ndërgjegjësimin për rrezikun, marrjen e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut. Për të identifikuar, matur dhe menaxhuar në mënyrë aktive dhe efektive rreziqet, banka vazhdon të zhvillojë dhe avancojë sistemin e saj gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut është pjesë integrale e menaxhimit të përgjithshëm të bankës. Përveç kërkesave të autoritetit ligjor dhe rregullator, banka gjithashtu merr parasysh dhe menaxhon natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj të biznesit dhe rreziqet që rezultojnë.

Banka ka një sistem të parimeve dhe procedurave të rrezikut për matjen dhe monitorimin e rrezikut, i cili ka për qëllim administrimin e rreziqeve materiale. Rreziqet kreditore, të tregut, likuiditetit dhe ato operacionale maten, kufizohen, zbuten, agregohen dhe krahasohen me kapitalin në dispozicion të mbulimit të rrezikut.

Gjatë vitit 2021, banka ka menaxhuar në mënyrë aktive rreziqet që rezultuan nga shpërthimi i COVID-19 dhe ndikimet e tij te klientët dhe operacionet gjatë vitit 2021. Banka Raiffeisen në Kosovë ka qenë proaktive në miratimin e masave parandaluese dhe të përshtatshme. Gjatë periudhës pas pandemisë COVID-19, Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut ka vlerësuar vazhdimisht temat aktuale të menaxhimit të rrezikut material dhe ka vlerësuar vazhdimisht ndikimin në pozicionet financiare, të rrezikut, kapitalit dhe likuiditetit të bankës. Anëtarët e komitetit janë mbajtur të informuar për performancën dhe financat e bankës përmes raporteve të rregullta.

Rreziku kreditor


Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare nëse një klient ose palë tjetër nuk përbushë një detyrim sipas një kontrate. Rreziku kreditor lind kryesisht nga huadhënia direkte ose financimi tregtar. Përqendrimi i rrezikut kreditor menaxhohet nëpërmjet kufizimeve specifike (p.sh. pragjet e përqendrimit) për dimensione të zgjedhura të rrezikut kreditor, si rreziku i një emri të vetëm për të kufizuar ekspozimin maksimal për çdo palë individuale/GCC, ose/dhe rrezikun e industrisë.

Menaxhimi i portofolit të kredive

Departamenti i Menaxhimit të Portofolit të Kredive monitoron nga afër zhvillimet ekonomike në treg dhe në të gjithë sektorët dhe ndërmerr analiza të skenarëve. Kjo na mundëson të ndërmarrim veprime të portofolit aty ku është e nevojshme, duke përfshirë monitorimin e përmirësuar, ndryshimin e apetitit të rrezikut të bankës dhe/ose rregullimin e limiteve dhe ekspozimeve, për të ribalancuar ekspozimet dhe për të menaxhuar apetitin e rrezikut aty ku është e nevojshme. Bazuar në këtë, banka ndërmerr rishikime të rregullta të portofoleve kryesore për të siguruar që rreziqet individuale të klientëve ose portofolit janë kuptuar dhe aftësia e bankës për të menaxhuar nivelin e produkteve/instrumenteve të ofruara gjatë çdo rënieje është e përshtatshme.

Grafiku i mëposhtëm tregon ekspozimin kreditor të bankës në fund të periudhës raportuese dhe dy periudhave të mëparshme. Ekspozimi i përgjithshëm i rrezikut kreditor ishte 1,205 milionë € më 31 dhjetor 2021, i cili krahasuar me fundin e vitit 2020 u rrit me 0 për qind, përkatësisht u rrit me 18 për qind krahasuar me fundin e vitit 2019.

Ky portofol është i diversifikuar midis segmenteve të biznesit dhe të klientëve individualë dhe përfshin ekspozime në bilanc dhe jashtë bilancit, para aplikimit të provizionit të zhvlerësimit dhe faktorëve të konvertimit të kredisë dhe në këtë mënyrë përfaqëson ekspozimin e përgjithshëm të kredisë.



Banka Raiffeisen në Kosovë qëndron në një pozitë shumë të mirë duke ruajtur ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë brenda parametrave të pranueshëm. Ky menaxhim efektiv i rrezikut të kredisë është një përbërës kritik i një qasjeje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e rrezikut dhe thelbësor për suksesin dhe stabilitetin afatgjatë të bankës.

Menaxhimi i kredive jo-performuese

Në përputhje me kërkesat e BE-së dhe autoriteteve lokale, Banka Raiffeisen në Kosovë ka zbatuar plotësisht kërkesat rregullatore dhe ka zhvilluar procedura dhe procese të brendshme për menaxhimin e kredive jo-performuese. Kreditë jo-performuese në fund të vitit 2021 ishin në nivelin 3.1 përqind, e cila ka mbetur e njëjtë me vitin e kaluar. Nisur nga rrethanat e situatës pas pandemisë, kjo konsiderohet një performancë e qëndrueshme dhe e mirë. Për më tepër, raporti i mbulimit të NPL është 76.36 përqind që është më i lartë se raporti i mbulimit të një viti më parë (72.89 përqind).

Rreziku i likuiditetit

Mjaftueshmëria e likuiditetit sigurohet si nga perspektiva ekonomike ashtu edhe nga ajo rregullatore. Për t'iu qasur perspektivës ekonomike, banka ka krijuar një kornizë qeverisëse që përfshin limite të brendshme dhe masa drejtuese.

Komponenti rregullator adresohet duke respektuar kërkesat e raportimit sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (Raporti i Likuiditetit Rregullator). Përveç kërkesave rregullatore lokale, banka është në përputhje me kërkesat e raportimit të Bazel III (Raporti i Mbulimit të Likuiditetit dhe Raporti i Financimit të Qëndrueshëm Neto).

Analizat dhe raportet e likuiditetit rregullator dhe të brendshëm monitorohen bazuar në supozime të veçanta të modelimit. Ndërsa raportet rregullatore llogariten sipas specifikimeve të dhëna nga autoritetet, raportet e brendshme modelohen me supozime nga vëzhgimet empirike.

Gurëthemet e kornizës ekonomike të rrezikut të likuiditetit janë skenari i Vijimësisë (GC) dhe "Time-to-Wall (TTW)". Analiza e Vijimësisë tregon pozicionin strukturor të likuiditetit. Ajo mbulon të gjithë nxitësit kryesorë të rrezikut, të cilët mund të ndikojnë dëmshëm në grupin në skenarin e biznesit të zakonshëm. Nga ana tjetër, analiza "Time-to-Wall" tregon horizontin e mbijetesës për skenarë të pafavorshëm të përcaktuar dhe modele stresi (tregu, reputacioni dhe kriza të kombinuar) dhe përcakton nivelin minimal të rezervës së likuiditetit (dhe/ose kapacitetin e kundër-balancimit) të Bankës.

Skenarët e likuiditetit modelohen duke përdorur një qasje në nivel të mbarë Grupit, duke njohur specifikimet lokale kur ato justifikohen nga faktorë ndikues të tillë si ambienti i tregut ose karakteristikat e biznesit.

Monitorimi i limiteve dhe respektimi i kërkesave të raportimit kryhet në mënyrë efektive dhe kanalet përkatëse të përshkallëzimit përdoren dhe funksionojnë ashtu siç janë dizajnuar.

Pozicioni i likuiditetit të bankës vazhdoi të mbetet i qëndrueshëm dhe zbuloi një rezervë të fuqishme të likuiditeti gjatë vitit 2021.

Raporti i Likuiditetit Rregullator sipas definicionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës:

	2021	2020	2019	Kërkesa minimale
Të gjitha monedhat	32.12%	34.71%	35.36%	25.00%
Monedha euro	30.04%	28.48%	27.76%	20.00%

Pozicioni i likuiditetit monitorohet në nivel bankar dhe kufizohet me anë të një sistemi gjithëpërfshirës të limiteve. Limitet përcaktohen sipas një perspektive “biznes i zakonshëm” dhe një perspektive stresi. Në përputhje me apetitin e përcaktuar të rrezikut, Banka Raiffeisen në Kosovë demonstroi një horizont mbijetese prej disa muajsh (TTW) në një skenar të rëndë, të kombinuar të stresit (stresi reputacional dhe i tregut). Kjo mund të sigurohet ose nga një profil strukturor pozitiv i likuiditetit ose nga një rezervë mjaftueshëm e lartë e likuiditetit. Në një mjedis normal të vijimësisë, transformimi i maturitetit duhet të mbulohet plotësisht nga rezerva e disponueshme e likuiditetit në periudhën afatmesme. Kjo do të thotë që pozicioni kumulativ i likuiditetit për një periudhë deri në një vit duhet të jetë pozitiv. Në planin afatgjatë (një vit ose më shumë), transformimi i maturitetit lejohet deri në një nivel të caktuar. Limitet e brendshme të modelit plotësohen me limitet e pajtueshmërisë me raportet rregullatore të likuiditetit, siç janë raporti i mbulimit të likuiditetit (LCR) dhe raporti i mirëmbajtjes së likuiditetit (LMR). Të gjithë treguesit e likuiditetit kanë qenë brenda kufijve gjatë gjithë vitit.

Rreziku i tregut

Banka e përcakton rrezikun e tregut si rrezikun e humbjeve të mundshme që vijnë nga ndryshimet në çmimet e tregut të pozicioneve të tregimit dhe investimeve. Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në faktorët e tregut, si kursi i këmbimit valutor, normat e interesit, diferencat e kredisë, çmimet e kapitalit dhe çmimet e mallrave, do të ulin të ardhurat e bankës ose vlerën e portofolit të bankave.

Vlerat e mëposhme maten dhe kufizohen çdo ditë në sistemin e menaxhimit të rrezikut të tregut:

- **Vlera në rrezik (niveli i besimit 99 përqind, horizonti i rrezikut një ditë)**
Vlera në rrezik (VaR) është instrumenti kryesor drejtues në tregjet likuide dhe situatat normale të tregut. VaR matet bazuar në një qasje simulimi hibrid, ku llogariten 5000 skenarë. Qasja kombinon avantazhet e një simulimi historik dhe një simulimi Monte-Carlo dhe nxjerr parametrat e tregut nga të dhënat historike të 250 ditëve. Supozimet e shpërndarjes përfshijnë tipare moderne si çgrupimi (de-clustering) i paqëndrueshmërisë dhe ndryshimi i rastësishëm i kohës. Kjo ndihmon në riprodhimin e shpërndarjeve me probabilitet të lartë të rezultateve ekstreme (fat-tailed) dhe asimetrike në mënyrë të saktë. Rezultatet e vlerës në rrezik nuk përdoren vetëm për kufizimin e rrezikut, por edhe në alokimin e kapitalit ekonomik.
 - **Ndjeshmëritë (ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit)**
Limitet e ndjeshmërisë duhet të sigurojnë që përqendrimet të shmangen në situata normale të tregut dhe të jenë instrumenti kryesor drejtues në situata ekstreme të tregut dhe në tregje jo likuide ose në tregje që janë strukturalisht të vështira për t’u matur.
 - **Ndalimi i humbjes**
Ky limit përforcon disiplinën e tregtuesve në mënyrë të tillë që ata nuk lejojnë që humbjet të akumulohen në pozitat e tyre vetanake të pronarit, por t’i kufizojnë ato në mënyrë rigorozë.
- Një koncept gjithëpërfshirës i testimit të stresit komplimenton këtë sistem limitesh me shumë nivele. Simulon ndryshimet e mundshme të vlerës aktuale të skenarëve të përcaktuar për gjithsej portofolin.

Masat e mëposhme janë duke u ndërmarrë nga menaxhimi i rrezikut të tregut për t’iu kundërvënë krizës pas pandemisë COVID-19. Trendet e tregut dhe ndryshimet e pozicionit në portofolet individuale të Bankës Raiffeisen në Kosovë u monitoruan më intensivisht. Për më tepër, trendet në tregjet lokale përditësohen çdo ditë dhe menaxhimi i reziqeve kontrollohet në mënyrë aktive për të qenë në gjendje për të reaguar shpejt ndaj ndryshimeve. Qëllimi është përshtatja e limiteve të apetitit të rrezikut, mbyllja e pozicioneve aty ku është e nevojshme, krijimi i rezervave të likuiditetit aty ku kushtet e tregut janë më të favorshme dhe përshtatja e modeleve me masat lokale (moratoriumet) kur është e nevojshme.

Rreziku operacional

Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjeve që rezultojnë nga procese të brendshme, njerëz ose sisteme të papërshtatshme ose të dështuara ose nga ngjarje të jashtme, përfshirë kontraktimin, rrezikun e reputacionit dhe atë ligjor. Në këtë kategori rreziku menaxhohet shtytësisht e brendshëm të rrezikut siç janë aktivitetet e paautorizuara, mashtrimet ose vjedhjet, humbjet që lidhen me sjelljen, gabimet e modelimit, gabimet e ekzekutimit dhe procesit, ose ndërprerja e biznesit dhe dështimet e sistemit. Faktorët e jashtëm siç janë dëmtimi i pasurive fizike ose mashtrimi menaxhohet dhe kontrollohen gjithashtu.

Kjo kategori e rrezikut analizohet dhe menaxhohet bazuar në të dhënat vetanake të humbjeve historike dhe rezultatet e vetëvlerësimeve. Një tjetër mjet i menaxhimit është sistemi i stimujve të zbatuar në alokimin e brendshëm të kapitalit. Ky sistem shpërblen cilësinë e lartë të të dhënave dhe menaxhimin aktiv të rrezikut.

Është zbatuar koncepti i tre linjave të mbrojtjes ku Menaxherët e Linjave të Biznesit caktohen dhe trajnohen si Menaxherë të Rrezikut Operacional për secilën zonë të biznesit. Menaxherët e Rrezikut Operacional i ofrojnë Kontrollit qendror të Rrezikut Operacional raporte mbi vlerësimet e rrezikut, ngjarjet e humbjeve, treguesit, skenarët dhe masat. Ata mbështeten në punën e tyre nga Specialistët e Dedikuar të Rrezikut Operacional (DORS).

Njësia e kontrollit të rrezikut është përgjegjëse për raportimin, zbatimin e kornizës, zhvillimin e masave të kontrollit dhe monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat. Brenda kornizës së ciklit vjetor të menaxhimit të rrezikut, ata gjithashtu koordinojnë pjesëmarrjen e departamenteve të linjës së dytë përkatëse të mbrojtjes dhe të gjithë partnerëve të linjës së parë të mbrojtjes (Menaxherët e Rrezikut Operacional).

- *Identifikimi i rrezikut*

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që mund të rrezikojnë ekzistencën e bankës (por ndodhja e të cilave ka shumë pak gjasa) dhe zonat ku humbjet kanë më shumë të ngjarë të shfaqen më shpesh (por kanë vetëm ndikim të kufizuar) janë aspekte të rëndësishme të menaxhimit të rrezikut operacional. Vlerësimi i rrezikut operacional ekzekutohet në mënyrë të strukturuar sipas kategorive të rrezikut siç janë proceset e biznesit dhe llojet e ngjarjeve. Për më tepër, vlerësimi i rrezikut vlen për produktet e reja, projektet e reja, rregulloret e reja në zhvillim, si dhe pikat e hapura të auditimit.

- *Monitorimi*

Për të monitoruar rreziqet operationale përdoren tregues të paralajmërimit të hershëm, që lejojnë identifikimin e shpejtë dhe minimizimin e humbjeve. Në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme, të dhënat e humbjeve mbledhen në një bazë të dhënash qendrore të quajtur ORCA (Aplikacioni i kontrollit të rrezikut operacional) në një mënyrë të strukturuar sipas llojit të ngjarjes dhe linjës së biznesit. Rezultatet e analizave si dhe ngjarjet që rezultojnë nga rreziqet operationale raportohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në Komitetin e Menaxhimit të Riskut Operacional në baza të rregullta.

Mbledhja e humbjeve në ORCA që vijnë nga rreziqet operationale është parakusht për zbatimin e një modeli statistikor të shpërndarjes së humbjeve dhe kërkesë minimale për zbatimin e qasjes së standardizuar rregullatore. Për më tepër, të dhënat e humbjeve përdoren për të krijuar dhe validuar skenarët e rrezikut operacional dhe për shkëmbim me grupet ndërkombëtare të dhënave për të zhvilluar më tej mjete të përparuara të menaxhimit të rrezikut operacional, si dhe për të ndjekur më tej efikasitetin e masave dhe të kontrollit.

- *Kuantifikimi dhe zbutja*

Banka Raiffeisen në Kosovë ka zbatuar Qasjen e Menaxhimit të Avancuar (AMA), por banka aktualisht raporton llogaritjen e kërkesave rregullatore të kapitalit për rreziqet operationale sipas Bazel III duke përdorur qasjen e standardizuar. Reduktimi i rrezikut operacional inicohet nga menaxherët e biznesit, të cilët vendosin për veprime parandaluese si zbutja e rrezikut ose transferimi i rrezikut. Progresi dhe suksesi i këtyre veprimeve monitorohet nga Departamenti i Kontrollit të Rrezikut. Këta të parët gjithashtu përcaktojnë plane kontingjente dhe emërojnë personat ose departamentet përgjegjëse për iniciimin e veprimeve të përcaktuara nëse humbjet ndodhin në të vërtetë. Për më tepër, një njësi e dedikuar organizative ofron mbështetje për njësitë e biznesit për uljen e rreziqeve operationale. Një rol të rëndësishëm i përket menaxhimit të mashtrimit i cili zvogëlon humbjet e mundshme të lidhura me mashtrimin përmes monitorimit proaktiv dhe veprimeve parandaluese. Banka gjithashtu ekzekuton një program të gjerë trajnimit për stafin dhe ka plane të ndryshme emergjence dhe sisteme rezervë.

Ndryshimet në mjedisin rregullator

Sektori bankar i Kosovës konsiderohet shumë dinamik me ndryshimet në legjislacion në përputhje me direktivat e BE-së. Si pjesë e Grupit Raiffeisen Bank International (RBI), banka i nënshtrohet ndryshimeve në mjedisin rregullator në BE. Kjo na mundëson që banka të adaptohet paraprakisht me ndryshimet në rregulloret lokale, të cilat synojnë të harmonizohen me rregulloret e BE-së.

Banka ndoqi nga afër zhvillimet rregullatore aktuale dhe ato të ardhshme në vitin 2021. Gjatë vitit, Banka Qendrore kërkoi shqyrtimin dhe komentet për Projekt-rregulloren për raportin e mbulimit me likuiditet dhe Projekt-rregulloren për raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave. Kërkesa përfshinte shabllonet e raportimit të cilat u shqyrtuan dhe plotësuan nga banka.


Njerëzit, kultura dhe të mësuarit

Në vitin 2021, 859 punonjës të Bankës Raiffeisen në Kosovë u kanë shërbyer rreth 280,000 klientëve. Duke qenë se viti 2021 vazhdoi të përcillej me telashet e pandemisë, fokusi kryesor i bankës ishte të mundësonte shëndetin dhe mirëqenien e kolegëve dhe klientëve. Në këtë drejtim, sigurimi i mjedisit fleksibël të punës dhe promovimi i vaksinimit ishin temat kryesore në agjendën e punonjësve të bankës.

Për shkak të luhatjeve të tregut, veçanërisht në industrinë e TI-së, banka prezantoi masa që do të mundësonin kushte më të përshtatshme pune të roleve të tilla dhe do të parandalonin humbjen e talentëve. Për më tepër, prioritet kryesor strategjik për punonjësit mbetet avancimi i teknologjive, si në aspektin e operacioneve të lehta të lidhura me punonjësit, ashtu edhe në drejtim të mjeteve të avancuara të të mësuarit dhe menaxhimit të performancës.

Mosha mesatare e punonjësve në vitin 2021 vazhdoi të ishte 37 vjeç, ndërkohë që 52 për qind e totalit të punonjësve ishin gra dhe 48 për qind ishin burra.

Matja jonë e vazhdueshme e zërit të punonjësve ka nxjerrë në pah shifra të qëndrueshme në vitin 2021 për dy parametrat kryesorë të angazhimit dhe aktivizimit/fuqizimit të punonjësve, me një rritje prej një për qind në indeksin e aktivizimit/fuqizimit.




Zhvillimi profesional

Banka është e përkushtuar për të ngritur dhe zhvilluar njerëzit, njohuritë dhe aftësitë e tyre duke ofruar një larmi mundësish të të mësuarit dhe zhvillimit.

Këto iniciativa rezultuan në përmirësime të njohurive në fushën e produkteve dhe shërbimeve bankare, temave të menaxhimit, metodave të reja të punës dhe teknologjisë. Në këtë mënyrë, banka fitoi avantazh konkurrues në treg duke ofruar një shërbim më profesional dhe efikas për klientët e saj me një qasje të re adaptive. Fokus specifik iu dha vazhdimisht konceptit të vetë-zhvillimit dhe iniciativës vetjake për të mësuarit vetanë online në vitin 2021. Sistemi i përditësuar rishtas i Menaxhimit të të mësuarit online ofron shërbime me cilësi të lartë dhe përvojë moderne të të mësuarit për nxënësit duke përdorur teknologjinë më të fundit.

E-Learning (të mësuarit elektronik) është tashmë një platformë mësimore e pranuar shumë mirë dhe u bë një nga metodat më të rëndësishme, tërheqëse, fleksibile dhe efikase të të mësuarit nga shumica e punonjësve. Në vitin 2021, kishte një nivel mbresëlënës të interesit dhe mbështetjes nga punonjësit e bankës për të ndjekur dhe dizajnuar kurse të krijuara nga brenda. Situata pandemike rriti edhe më shumë përdorimin e të mësuarit online, dhe në këtë mënyrë, e-Learning u bë burimi dhe metodologjia kryesore e të mësuarit në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Fokus shtesë iu dha gjithashtu kurseve online të ofruara nga jashtë për të rritur efikasitetin dhe larminë në të mësuar. Përveç e-Learning, gjatë vitit 2021 u rikthyen gradualisht trajnimet në klasë dhe banka organizoi sesione të ndryshme të trajnimeve me praninë fizike të të trajnuarve.

Përveç aktiviteteve të përmendura tashmë, banka vazhdoi të mbështesë punonjësit për nevojat e tyre specifike profesionale dhe ofroi kurse të licencuara për një sërë temash, nga aftësitë teknike deri te aftësitë e buta. Të mësuarit gjatë gjithë jetës mbetet një nga mesazhet kryesore në bankë. Viti 2021 vazhdoi të ishte një vit i pazakontë,



përveç aftësive teknike dhe atyre të buta, kishte një përqendrim më të lartë në këshillat për punën në distancë, parandalimin e pandemisë, transformimin digjital, shëndetin, sigurinë, menaxhimin e shëndetit mendor, trajtimin e stresit dhe ankthit, të cilat ishin disa nga temat më të rëndësishme të ofruara kryesisht në internet me qëllim të arritjes së një ekuilibri të pranueshëm midis punës dhe jetës dhe zhvillimin e frymës ekipore midis punonjësve.

Një nga vlerat korporative të bankës është "të mësuarit" i cili shërben edhe si katalizator i Organizatës së të Mësuarit. Një nga aktivitetet mundësuese të Organizatës së të Mësuarit është "Festivali i të Mësuarit" që synon të ofrojë mundësi unike të të mësuarit, të nxisë kureshtjen e të mësuarit dhe të promovojë kulturën e të mësuarit. Në vitin 2021, tema e Festivalit së të Mësuarit ishte "Ndryshimi/Kalimi në Adaptive" ku u organizuan prezantime dhe trajnime të ndryshme mbi temat e teknologjisë, inovacionit, ndërmarrësisë, punës në distancë, shëndetit dhe mirëqenies. Prezantimet u organizuan virtualisht me folës të jashtëm dhe të brendshëm nga Kosova dhe Evropa ku të gjithë punonjësit e bankës patën mundësinë të merrnin pjesë. U morën komente kthyesë të shkëlqyera dhe pjesëmarrja mesatare për seancë ishte 90 punonjës."

Menaxhimi i talentit

Gjatë vitit 2021 vazhdoi fokusi në rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive të menaxherëve të njerëzve ndaj kapaciteteve njerëzore. Banka vazhdoi të drejtojë iniciativat e zhvillimit të programeve të rotacionit dhe ndërfunkionale dhe detyrave të përshtatura mësimore. Këto programe të brendshme dhe ndërkombëtare synojnë të thellojnë ekspertizën e punonjësve dhe menaxherëve më të talentuar të bankës nëpërmjet një kombinimi inovativ të metodave praktike, alternative dhe akademike të të mësuarit.

Mjedis i sigurt i punës

Gjatë vitit 2021, banka vazhdoi aktivitetet e saj për shëndetin dhe mirëqenien me fokus të veçantë në situatën e pandemisë. Një udhëzues për punën në distancë gjatë situatës së pandemisë u krijua dhe u publikua për të ndihmuar dhe udhëzuar kolegët në punën nga shtëpia gjatë kësaj periudhe.

Aktivitete të tjera synonin të rrisin ndërgjegjësimin e punonjësve për mbrojtjen kundër COVID-19 dhe stimulimin e vaksinimit duke promovuar rëndësinë e vaksinimit përmes aktiviteteve të ndryshme.

Menaxhimi i qëndrueshmërisë dhe përgjegjësia korporative

Qëndrueshmëria dhe mënyra e të kuptuarit të saj nga banka

Qëndrueshmëria ka qenë gjithmonë një parim themelor për Bankën Raiffeisen në Kosovë dhe si e tillë ka qenë një matëse e suksesit korporativ.

- Banka e kupton qëndrueshmërinë si aktivitetet e përgjegjshme korporative për një rezultat afatgjatë, ekonomikisht pozitiv, në konsiderimin e aspekteve kryesore shoqërore dhe mjedisore.
- Banka kombinon suksesin financiar me përgjegjësinë sociale duke ankoruar qëndrueshmërinë si një komponent fiks të biznesit të saj dhe duke praktikuar qëndrueshmërinë si një përgjegjësi integrale lidhësi dhe menaxhimi, përveç marrjes në konsideratë të aspekteve kryesore të qëndrueshmërisë në aktivitetet e saj të biznesit.
- Prandaj, banka angazhohet të harmonizojë strukturat dhe proceset e saj të menaxhimit me këtë qëndrim. Në tre fushat e përgjegjësive të qëndrueshmërisë strategjike, pra "Bankier i Përgjegjshëm", "Partneri i Drejtë" dhe "Qytetar i Angazhuar", të cilat janë të lidhura ngushtë me aktivitetet e saj të biznesit, banka përpiqet të zbatojë në mënyrë profesionale dhe efektive vlerat dhe kompetencat e saj për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm si në kompani ashtu edhe në shoqëri.

Qëllimi i qëndrueshmërisë së bankës është të përqendrohet në ato fusha me një ndikim të rëndësishëm potencial. Kjo kërkon që banka të përmirësojë vazhdimisht ndikimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve të saj të biznesit dhe të zhvillojë mënyra për të matur dhe verifikuar këtë ndikim. Duke vepruar kështu, banka shpreson të rrisë vlerën afatgjatë të bankës, duke kontribuar gjithashtu në mënyrë aktive në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Raiffeisen Bank International (RBI) është një nga kompanitë nënshkruese të Kompaktit Global të OKB-së (UNGC), dhe si filial i RBI-së, Banka Raiffeisen në Kosovë për këtë arsye është e përkushtuar që vazhdimisht të jetë në përputhje me dhjetë parimet e UNGC-së për biznes të përgjegjshëm. UNGC është iniciativa më e madhe në botë për CSR dhe zhvillim të qëndrueshëm. Parimet e tij përfshijnë fushat kryesore të të drejtave të njeriut, standardet e punës, mbrojtjen e mjedisit dhe luftimin e korrupsionit.

Dhjetë parimet e Kompaktit Global të OKB-së

Të drejtat e njeriut

Parimi 1: Ne e mbështesim dhe respektojmë mbrojtjen e të drejtave ndërkombëtare të njeriut brenda sferës tonë të ndikimit.

Parimi 2: Ne sigurohemi që nuk jemi bashkëpunëtorë në abuzimin me të drejtat e njeriut.

Labour

Parimi 3: Ne e mbështesim lirinë e asociimit dhe njohjen e efikase të së drejtës për negociata lidhur me Marrëveshjen Kolektive.

Parimi 4: Ne e mbështesim eliminimin e të gjitha formave të punës së detyruar ose të dhunshme.

Parimi 5: Ne e mbështesim heqjen e punës së fëmijëve.

Parimi 6: Ne e mbështesim eliminimin e diskriminimit në punësim dhe profesion.

Environment

Parimi 7: Ne e mbështesim qasjen parandaluese ndaj sfidave mjedisore.

Parimi 8: Ne ndërmarrim iniciativa për promovimin e përgjegjësishë më të madhe mjedisore.

Parimi 9: Ne e inkurajojmë zhvillimin dhe përhapjen e teknologjive miqësore ndaj mjedisit.

Anti-Corruption

Parimi 10: Ne punojmë kundër korrupsionit në të gjitha format e tij, përfshirë zhvatjen dhe rryshfetin.

Si anëtare e kahmotshme e Iniciativës Financiare UNEP, RBI gjithashtu nënshkroi "Parimet për Bankimin e Përgjegjshëm" në fillim të vitit 2021, duke u zotuar kështu të zbatojë gjashtë parimet në të gjithë Grupin e saj si dhe në Bankën Raiffeisen në Kosovë. Këto parime ofrojnë kornizën për një bankë të qëndrueshme dhe ndihmojnë industrinë të tregojë se si mund të japë një kontribut pozitiv në shoqëri. Ato ankorojnë qëndrueshmërinë në nivel strategjik, portofoli dhe transaksionesh dhe në të gjitha fushat e biznesit.

Parimet për shërbime të përgjegjshme bankare të Iniciativës Financiare të UNEP

Harmonizimi

Parimi 1: Ne do ta harmonizojmë strategjinë tonë biznesore për të qenë në përputhje dhe për të kontribuar në nevojat individuale dhe qëllimet e shoqërisë, siç shprehen në Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, Marrëveshjen e Parisit për Klimën dhe kornizat relevante kombëtare dhe rajonale.

Ndikimi dhe vendosja e caqeve

Parimi 2: Ne vazhdimisht do t'i rrisim ndikimet tona pozitive përdërisa i zvogëlojmë ndikimet negative dhe i menaxhojmë rreziqet ndaj personave dhe mjedisit që rezultojnë nga aktivitetet, produktet dhe shërbimet tona. Për këtë qëllim, ne do të vendosim dhe publikojmë caqe se ku do të mund t'i kemi ndikimet më të mëdha.

Klientët dhe konsumatorët

Parimi 3: Ne do të punojmë me përgjegjësi me konsumatorët tanë për t'i inkurajuar praktikën e qëndrueshme dhe për t'i mundësuar aktivitetet ekonomike që krijojnë prosperitet të përbashkët për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

Akterët

Parimi 4: Ne do të konsultohemi, angazhohemi dhe krijojmë partneritete në mënyrë proaktive dhe me përgjegjësi me akterët përkatës për t'i arritur objektivat e shoqërisë.

Qeverisja dhe kultura


Parimi 5: Ne do t'i zbatojmë zotimet tona për këto parime nëpërmjet qeverisjes efikase dhe kulturës së shërbimeve bankare me përgjegjësi.

Transparenca dhe llogaridhënia

Parimi 6: Ne do ta shqyrtojmë në baza periodike zbatimin tonë individual dhe kolektiv të këtyre parimeve dhe do të jemi transparent dhe llogaridhënës për ndikimet tona pozitive dhe negative dhe kontributin tonë për objektivat e shoqërisë.

Strategjia e qëndrueshmërisë

Strategjia e Qëndrueshmërisë e Bankës Raiffeisen në Kosovë përbëhet nga nëntë fusha kryesore të veprimit brenda të cilave banka përqendron menaxhimin e saj të qëndrueshmërisë. Për të adresuar në mënyrë sistematike këto fusha thelbësore, të cilat janë gjithashtu të rëndësishme për palët e saj të interesit, banka vazhdimisht përpiket të përmirësojë strategjinë e saj të qëndrueshmërisë. Në identifikimin e fushave kryesore të veprimit, banka mbështetet në perspektivën e RBI-së si dhe në perspektivat e palëve të saj të interesit që përfshijnë punonjësit e saj, klientët, aksionarët dhe furnizuesit, si dhe organizatat joqeveritare dhe një sërë grupesh të tjera të interesit. Banka kryen një analizë shumë-fazëshe të materialitetit, mbi një bazë të rregullt, për t'i prioritetizuar këto fusha të veprimtarisë. Për këtë arsye, si dhe për të bërë ndonjë rregullim në strategjinë e saj të qëndrueshmërisë, banka e sheh si shumë të vlefshëm mbajtjen e dialogut me palët e saj të interesit.



Bankier i përgjegjshëm

Banka Raiffeisen në Kosovë në vitin 2021 kishte shumë aktivitete që kanë efektin e të qenit një bankier i përgjegjshëm në Kosovë. Për sa i përket qeverisjes dhe pajtueshmërisë, banka i zbaton këto vlera në të gjitha aktivitetet e saj. Baza për këtë është Kodi i Sjelljes i bankës, i cili zbatohet në të gjithë Grupin, për të gjithë anëtarët e stafit dhe partnerët e saj të biznesit.

Politika e huadhënies dhe politika e vendimeve të huadhënies

Modeli i biznesit i bankës është i orientuar rreth objektivit strategjik të nivelit të lartë të krijimit të vlerës afatgjatë. Integrimi dhe adaptimi i kornizës së ESG në kriteret e huadhënies bankare mundëson identifikimin dhe mbështetjen e projekteve që kanë ndikim pozitiv në standardet mjedisore, sociale apo ato të qeverisjes. Një komponent i rëndësishëm i këtij modeli është huadhënia e përgjegjshme. Mbetet një huadhënës i drejtë dhe i besueshëm për bizneset me perspektivë, edhe në kohë të vështira si për shembull kohët e COVID-19. Në përputhje me këtë, banka përpiket të veprojnë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e Kosovës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me çështje mjedisore dhe sociale dhe është e angazhuar për të përmirësuar kapacitetin e menaxhimit të rrezikut mjedisor dhe social për të zvogëluar rreziqet e kredisë dhe përgjegjësisë.

Kënaqshmëria e klientëve

Kënaqshmëria e klientëve është prioriteti kryesor i bankës. Prandaj, kjo matet rregullisht si në biznesin retail ashtu edhe në atë të korporatave, në mënyrë që të mundësohet veprimi i duhur kur është e nevojshme.

Praktikat e përgjegjshme të shitjeve dhe marketingut

Çështjet financiare janë çështje besimi. Prandaj, Banka Raiffeisen në Kosovë përpiqet për etiketim të qartë dhe transparent të produkteve dhe shërbimeve për të gjithë klientët dhe palët e interesuara. Gjatë reklamimit dhe marketingut të produkteve të saj, banka u përmbahet parimeve strikte që synojnë të mbrojnë klientët e saj. Reklamimi i rremë ose mashtrues është diçka që banka mendon se është e papranueshme.

Partner i ndershëm*Korrupsioni dhe pastrimi i parave*

Banka ndërmerr të gjitha veprimet që të shmangët çdo formë e korrupsionit, pastrimit të parave, mashtrimit ose tregtimit "insajder". Një parakusht në biznesin dhe praktikat e saj operationale është sjellja e drejtë, etike dhe në përputhje me ligjin e të gjithë anëtarëve të stafit. Mekanizmat për respektimin e tij janë përmes Kodit të Sjelljes (CoC) dhe rregulloreve të qarta dhe të hollësishtme që përfshihen në Manualin e Pajtueshmërisë.

Diversiteti

Të qenit punëdhënës i preferuar në Kosovë mbetet objektivi kryesor i bankës. Diversiteti është një nga kontribuesit kryesorë për të qenë punëdhënës i preferuar. Për Bankën kjo do të thotë vlerë e shtuar. Shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga diversiteti ofron përfitime të qëndrueshme për bankën dhe punonjësit, si dhe për ekonominë dhe shoqërinë. Në Bankën Raiffeisen në Kosovë gratë ishin të përfaqësuar me 36 për qind në pozitat drejtuese, ndërsa në bankë, 56 për qind e totalit punonjësve ishin gra.

Zhvillimi profesional

Banka është e përkushtuar të ngritë dhe zhvillojë njerëzit, njohuritë dhe aftësitë e tyre duke ofruar një larmi mundësish të të mësuarit dhe zhvillimit. Një fokus specifik iu dha konceptit të vetëzhvillimit dhe iniciativës vetjake për mësim vetanak online në vitin 2021. Sistemi i përditësuar rishitas i Menaxhimit të të mësuarit online ofron shërbime me cilësi të lartë dhe përvojë moderne të të mësuarit për personat që përdorin teknologjinë më të fundit.

Ekologjia e brendshme

Menaxhimi i rreziqeve klimatike – jo vetëm në ekologjinë e brendshme – është një detyrë gjithnjë e më e rëndësishme për ekonominë. Jo pa arsye Forumi Ekonomik Botëror klasifikoi ndryshimet klimatike si njërin ndër pesë rreziqet më të mëdha në Raportin Global të Rreziqeve 2021. Prandaj, në Bankën Raiffeisen në Kosovë, mbrojtja efektive e klimës është bërë një faktor konkurrues dhe një aktivitet i rëndësishëm për bankën. Banka e sheh mbrojtjen e mjedisit dhe klimës si pjesë të përgjegjësisë së saj ndaj shoqërisë dhe e sheh veten si një partner të drejtë të mjedisit. Në vitin 2021, banka arriti ulje prej 36 për qind të emetimeve të karbonit nga viti 2020 në fushëveprimin 1, ndërsa fokusi do të jetë reduktimi i fushëveprimit 2 gjithashtu dhe matja në mënyrë proaktive e emetimeve të fushëveprimit 3.

Qytetar i angazhuar

Banka e konsideron veten një qytetar të angazhuar korporativ, i cili në mënyrë aktive përkrah zhvillimin e qëndrueshëm në shoqëri. Angazhimi si qytetar korporativ shkon përtej biznesit kryesor dhe synon zhvillimin e popullatës së re të Kosovës në kulturë, sport, teknologji dhe arsim. Përveç kësaj, banka gjithashtu kontribuoi në projektet e mirëqenies sociale, me një fokus të veçantë të fëmijët dhe nënat në Kosovë.

Projekte dhe nisma të mbështetura

Gjatë vitit 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi të sponsorizojë projekte të ndryshme në pesë fushat kryesore: mirëqenia sociale, kultura, arsimit, shëndetësia dhe sporti. Sa i përket mirëqenies sociale, banka vazhdoi të mbështesë organizatat si UNICEF-i në ofrimin e qasjes për fëmijët e vegjël me nevoja të veçanta në komunën e Gjilanit me qasje në shkollë kur atyre u kërkohet të kenë klasa online (duke ofruar tableta). Si dhe mbështeti UNICEF-in në programet e Vizitave në Shtëpi për t'u mundësuar infermierëve dhe mjekëve që të mbulojnë pjesën më të madhe të popullsisë me vaksinat e fëmijëve.

Kultura mbetet një nga fushat kryesore ku banka vazhdoi të angazhohej. Projekti kryesor kulturor që banka po e mbështet për më shumë se dhjetë vjet me radhë është festivali i njohur: Prishtina Film Festival. Ndërsa një nga ngjarjet më të rëndësishme të PriFest është seria e eventeve "Koproduksioni Rajonal PriFORUM", e cila sjell kineastë nga vende të ndryshme të Evropës dhe botës në Kosovë. Punëtori të ndara dhe kurse master për artistë të rinj ishin gjithashtu pjesë e festivalit.

Për më tepër, banka vazhdoi të promovojë artin me Galerinë Raiffeisen. Ideja ishte që t'u jepte artistëve të rinj, të ardhshëm mundësinë për të prezantuar punimet e tyre para publikut. Për këtë qëllim, banka ka marrë me qira një hapësirë në Albi Mall, qendra më e madhe tregtare e Kosovës, dhe kjo hapësirë u shndërrua në një hapësirë inovative ku ekspozohen punime të reja nga artistë të rinj çdo muaj. Kjo i ndihmon komunitetit të ketë një vend ku ata mund të kenë një ekspozitë pa asnjë kosto.

Për sa i përket arsimit dhe inovacionit në vitin 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë mbështeti projektin "Atomi" që fokusohet në identifikimin dhe mbështetjen e njerëzve me inteligjencë të jashtëzakonshme, njerëzve me dhunti dhe të talentuar në Kosovë. Më saktësisht, qëllimi i "Atomit" është identifikimi i hershëm i nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, nxënësve me dhunti dhe të talentuar (këtu e tutje: atomist) në mënyrë që t'u ofrohen mundësi, kushte, kujdes dhe shkollimin e veçantë (pasurim) për këta studentë bazuar në potencialet e tyre intelektuale, dhuntinë, talentin, personalitetin, ambiciet, interesat, motivimin dhe kushtet dhe rrethanat e tyre socio-ekonomike. Të gjitha këto shërbime dhe aktivitete ofrohen në mënyrë që t'u mundësojnë këtyre nxënësve të zhvillojnë dhe realizojnë potencialin e tyre të plotë intelektual dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë së pari në zhvillimin e tyre personal dhe njëkohësisht në interesin shoqëror dhe kombëtar.

Krahas "Atomit", Banka Raiffeisen mbështet edhe "Kosova Makers League" të organizuar nga "Bone Vet", që është gara e parë e robotikës për shkollat fillore dhe të mesme. Ky konkurs është i hapur për të gjitha shkollat e Kosovës. Qëllimi i kësaj platforme është të rrisë entuziazmin e studentëve për shkencën, teknologjinë, inxhinierinë dhe matematikën, duke krijuar mjedis pozitiv të të mësuarit.

Gjatë vitit 2021, Banka Raiffeisen në Kosovë gjithashtu mbështeti "Green Fest" në Mitrovicë me qëllimin e përgjithshëm për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe ndërmarrësinë e gjelbër, përmes programit arsimor dhe aktivizmit kulturor.

Pasqyrat financiare

Pasqyrat e veçanta financiare të përgatitura në përputhje me standardet ndërkombëtare të Raportimit financiar për vitin e përmbyllur më 31 dhjetor 2021 me raportin e auditorit të pavarur të bashkangjitur.

Raporti i auditorit të pavarur	41
Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar	42
Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse	43
Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapitalin neto	44
Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë	45
Shënimet për pasqyrat e veçanta financiare	46-118

Deklarata mbi përgjegjësinë e menaxhmentit

To the Shareholders and the Supervisory Board of Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Ne kemi përgatitur pasqyrat financiare si më datën 31 dhjetor 2021 dhe për vitin e mbyllur në atë datë, të cilat paraqesin në mënyrë të saktë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Raiffeisen Bank Kosovo Sh.a. (në tekstin e mëtejshëm "Banka") si më 31 dhjetor 2021 si dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur. Menaxhmenti është përgjegjës për të siguruar se Banka i mbanë llogaritë në pajtueshmëri me rregulloret bankare të Kosovës dhe të cilat mund të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme për të shpalosur me saktësi të arsyeshme pozitën financiare të Bankës dhe rezultatet e veprimtarisë së saj dhe rrjedhën e parasë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar që përfshijnë edhe Standardet dhe Interpretimet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat janë nxjerrë nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (IASB) dhe Komiteti Ndërkombëtar për Interpretime të Raportimit Financiar (IFRIC) i IASB-së, të cilat janë relevante për veprimtarinë e saj dhe të cilat ishin në fuqi për periudhën të cilën e mbulojnë të dhënat. Menaxhmenti ka edhe përgjegjësi të përgjithshme për t'i ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në dispozicionin e vet për të ruajtur asetet e Bankës dhe për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimet dhe parregullsitë tjera.

Menaxhmenti konsideron se, gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, Banka i ka shfrytëzuar politikat adekuatë kontabël, të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe janë mbështetur nga gjykime dhe vlerësime të arsyeshme dhe të matura, dhe se gjatë kësaj janë respektuar Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rrjedhimisht, pasqyrat financiare konsiderohen të miratuara nga Bordi Menaxhues.

Prishtinë, Kosovë
23 mars 2022


Bordi Menaxhues i Bankës Raiffeisen në Kosovë



Anita Kovacic
Kryesuese e Bordit Menaxhues
Drejtoreshë Ekzekutive



Shukri Mustafa
Anëtar i Bordit Menaxhues
Operacionet dhe TI



Iliriana Toçi
Anëtare e Bordit Menaxhues
Shërbimet Bankare Retail



Johannes Riepl
Anëtar i Bordit Menaxhues
Shërbimet Bankare për
Korporata

Raporti i Auditorit të Pavarur

Për aksionarin dhe Bordin e Drejtorëve të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Raiffeisen Bank Kosova J.S.C ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, dhe pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e veçantë të rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, dhe shënimet për pasqyrat financiare të veçanta, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2021, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhat e saj të parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Veçanta të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra financiare të veçanta më 12 prill 2021.

Informacion tjetër

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionin tjetër. Informacioni tjetër përfshin informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor të Bankës në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 04/L093. Raporti Vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare të veçanta nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë konkluzioni sigurie për to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të veçanta, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër kur ai të bëhet i disponueshëm dhe, duke e bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër ka mospërputhje materiale me pasqyrat financiare të veçanta ose njohuritë tona të marra në auditim, ose ndryshe duket të ketë anomali materiale. Kur lexojmë Raportin Vjetor të Bankës, nëse konkludojmë se në të ka një anomali materiale, neve na kërkohet t'ua komunikojmë këtë çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisjen për Pasqyrat Financiare të veçanta

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me SNRF-të, dhe për një kontroll të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta që janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për të vazhduar si vijimësi, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që lidhen me vijimësinë dhe duke përdorur bazën e vijimësisë të kontabilitetit, përveç rasteve kur menaxhmenti ka ndërmend të likuidojë Bankën ose të të pushojë operacionet, ose nuk ka alternativë realiste përveç sa më sipër. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare të veçanta

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare të veçanta në tërësi janë pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport auditori që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të zbulojë gjithmonë një anomali materiale kur ekziston. Anomali mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare të veçanta. Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale të pasqyrave financiare të veçanta, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se ai që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, interpretime të deformuara ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Kuptojmë kontrollin e brendshëm që lidhet me auditimin në mënyrë që të hartohen procedura auditimi që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga menaxhmenti të bazës së vijimësisë të kontabilitetit dhe, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar si vijimësi. Nëse arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri materiale, neve na kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit tonë ndaj dhënies së informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të veçanta ose, nëse këto informacione janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditorit tonë. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të bëjnë që Banka të pushojë së funksionuari si vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare të veçanta, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare të veçanta përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen në lidhje, ndër të tjera, me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Deloitte Kosova Sh.p.k.

Rr. Ukshin Hoti

Pristina, Republika e Kosovës

Nr. unik i identifikimit: 810468373

23 mars 2022

Partneri i angazhuar:

Arta Limani

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar

shumat në 000 Euro	Shënime	31 dhjetor 31, 2021	31 dhjetor 31, 2020
Pasuritë			
Paraaja dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme	8	175,289	156,178
Detyrime nga bankat	9	19,391	28,575
Letrat me vlerë të investimit	10	174,034	176,759
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	11	778,249	709,515
Pasuritë e tjera	12	7,274	3,428
Pasuri e shtyrë tatimore	23	141	118
Investimet në filiale	13	2,234	2,234
Prona, impiantet dhe pajisjet	14	33,765	34,361
Pasuritë e paprekshme	14	5,552	4,816
Gjithsej pasuritë		1,195,929	1,115,984
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave	15	6,335	26,882
Depozitat nga klientët	16	1,022,775	915,626
Detyrimet financiare të matura me vlerën e drejtë	17	458	600
Detyrimet e tjera	18	8,651	8,211
Provizionet	18	883	1,234
Detyrimi i tatimit të shtyrë	26	-	-
Kreditë e varura	19	19,298	19,298
Gjithsej detyrimet		1,058,400	971,851
Kapitali i aksionarëve			
Kapitali aksionar		63,000	63,000
Rezerva e vlerës së drejtë		27	550
Rezervat e tjera		1,955	1,955
Fitimet e mbajtura		72,547	78,628
Gjithsej kapitali i aksionarëve	20	137,529	144,133
Gjithsej detyrimet dhe kapitali i aksionarëve		1,195,929	1,115,984

Pasqyrat Financiare janë aprovuar që të lëshohen në emër të menaxhmentit të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C dhe janë nënshkruar në emër të tyre më 23 mars 2022.



Fatos Shllaku
Udhëheqës i Financave



Anita Kovacic
Drejtoreshë Ekzekutive
Anëtare e Bordit Menaxhues

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 118.

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(shumat në € '000)	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 31, 2020	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 31, 2019
Të ardhurat nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	21	48,740	47,381
Shpenzimet nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv	21	(2,547)	(2,395)
Të ardhurat neto nga interesi		46,193	44,986
Të ardhurat nga dividendi	22	1,811	-
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	23	21,807	15,686
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	23	(9,605)	(7,726)
Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet		14,013	7,960
Shpenzimet e rënies në vlerë për pasuritë financiare	6	(4,895)	(8,085)
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë		1,875	1,127
Fitimet ose humbjet nga pasuritë dhe detyrimet financiare	24	50	56
Fitimet/humbjet nga modifikimi i kredisë	29	(114)	(173)
Të ardhurat e tjera operative	25	4,738	3,209
Të ardhurat neto operative		61,860	49,080
Shpenzimet e personelit	26	(15,017)	(13,687)
Zhvlrësimi i pronave dhe pajisjeve dhe ROU	27	(3,619)	(3,874)
Amortizimi i pasurive të paprekshme	27	(1,867)	(1,884)
Shpenzimet e tjera operative	28	(11,913)	(11,162)
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat		29,444	18,474
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	30	(3,125)	(1,822)
Fitimi për vitin		26,319	16,652
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që do të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		(523)	70
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		25,796	16,722

Pasqyra e veçantë e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 118.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në ekuitet

(shumat në '000 Euro)	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Kapitali total i aksionarit
Gjendja më 1 janar 2020	63,000	61,976	1,955	480	127,411
Fitimi i vitit	-	16,652	-	-	16,652
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	70	70
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	63,000	78,628	1,955	550	144,133
Gjendja më 31 dhjetor 2020	63,000	78,628	1,955	550	144,133
Fitimi i vitit	-	26,319	-	-	26,319
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(523)	(523)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	63,000	104,947	1,955	27	169,929
Kontributet dhe shpërndarjet	-	-	-	-	-
Dividendët ndaj pronarëve të kapitalit	-	(32,400)	-	-	(32,400)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	63,000	72,547	1,955	27	137,529

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapitalin neto lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 118.

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë

(shumat në € '000)	Shënimet	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 31, 2021	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 31, 2020
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative			
Interesi i pranuar në kredi		48,548	44,879
Interesi i paguar në plasmane		(166)	(26)
Interesi i pranuar në investimet në letra me vlerë		2,032	934
Dividendët e pranuar		1,811	-
Interesi i paguar në depozita dhe kredi të varura		(2,345)	(2,366)
Tarifat dhe komisionet e pranuar		23,743	17,153
Tarifat dhe komisionet e paguara		(9,605)	(7,726)
Të ardhura të tjera nga aktivitetet jobankare		4,428	2,803
Shpenzimet e personelit të paguara		(16,081)	(13,053)
Shpenzimet të tjera operative të paguara		(11,576)	(9,970)
Tatimi në të ardhura i paguar		(3,125)	(1,400)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrime operative		37,665	31,228
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
Rezerva e detyrueshme e likuiditetit		(12,178)	(4,505)
Detyrimet nga bankat		65	48
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		(73,967)	(48,636)
Pasuritë e tjera		(3,847)	(1,717)
Detyrimet ndaj klientëve		107,148	58,606
Depozitat nga bankat		(20,171)	18,570
Detyrimet e tjera		(670)	208
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		34,045	53,802
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	14	(4,928)	(5,308)
Të ardhurat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		38	73
Investimi në letra me vlerë		2,410	(26,987)
Paraja neto (e përdorur në)/nga aktivitetet investuese		(2,480)	(32,222)
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese			
Të ardhurat nga huamarrjet	7	(375)	709
Kthimi i detyrimeve me qira	7	(1,104)	(1,154)
Dividendët e paguar	7	(32,400)	-
Rrjedha neto e parasë (të përdorur në) aktivitetet financuese		(33,879)	(445)
Efekti i ndryshimit të normës së këmbimit valutor		(2)	2
Zvogëlimi neto i parasë dhe ekuivalenteve të saj		(2,316)	21,137
Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit	8	96,669	75,532
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor 2021	8	94,353	96,669

Pasqyra e veçantë e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të veçanta të paraqitura në faqet 46 deri 118.

Shënime për pasqyrat financiare e veçantë për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2020

1 Njësia raportuese

Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është aksionari që ka në pronësi 100 për qind të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. Raiffeisen SEE Region Holding GmbH është 100 për qind në pronësi indirekte të Raiffeisen Bank International AG, banka amë.

Banka operon sipas licencës bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - ("BQK") më 8 nëntor 2001. Aktivitetet kryesore afariste të Bankës janë aktivitetet bankare komerciale dhe retail brenda Kosovës.

Më 31 dhjetor 2021, Banka ka 7 degë dhe 32 nëndegë brenda Kosovës (31 dhjetor 2020: 7 degë dhe 34 nëndegë). Zyra e regjistruar e Bankës është e vendosur në adresën në vijim: Rruga Robert Doll 99, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2 Baza e përgatitjes

2.1 Baza kontabël

Pasqyrat financiare të veçanta janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur supozimin e vijimësisë së biznesit.

Më shumë informacione në lidhje me rrethanat e shkaktuara nga pandemia globale e COVID-19 që ndikuan në operacionet dhe aktivitetet e Bankës në vitin 2021 shpalosen në Shënimin 2.2. Këto rrethana nuk ndikuan në përshtatshmërinë e supozimit të vijimësisë së biznesit të Bankës.

2.2 Ngjarje të rëndësishme në periudhën raportuese

Ndikimi nga pandemia e COVID-19

Mbyllja ekonomike e shkaktuar nga pandemia e COVID-19 në mars 2020, ka pasur pasoja të pashembullta ekonomike në vitin 2020. Si rezultat, Banka Qendrore e Kosovës ka marrë disa masa për të sjellë lehtësira ekonomike për bizneset më të goditura nga situata pandemike. Prezantoi 3 udhëzime për ristrukturimin e kredive. Udhëzimet janë të aplikueshme nga të gjitha institucionet kreditore të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Qëllimi kryesor i udhëzuesit ishte futja e një moratoriumi të përkohshëm të pagesave për kreditë, të cilat nuk duhet të rezultojnë në vlerësimin kreditor të klientit. Situata e pandemisë vazhdoi deri në vitin 2021 dhe krahas udhëzimeve për moratoriumet e pagesave të kredive në vitin 2020, Banka Qendrore e Kosovës më 02 shkurt 2021 prezantoi një tjetër udhëzim për ristrukturimin e kredive për shkak të krizës pandemike COVID-19.

Udhëzimi kërkon që një moratorium pagese për çdo shumë të kryejësë dhe interesit të papaguar, të zbatohet për të gjithë debitorët e bankave të ndikuar negativisht nga situata e vazhdueshme pandemike.

Udhëzimi i fundit ishte i zbatueshëm për dy kategori debitorësh:

- Debitorët që nuk kishin aplikuar për një moratorium pagese në të kaluarën mund të përfitonin prej tij tani me një periudhë maksimale moratoriumi prej 9 muajsh,
- Debitorët që kishin aplikuar në të kaluarën për moratorium mund të riaplikonin. Por periudha totale e moratoriumit nuk mund të ishte më e gjatë se 9 muaj.

Periudha e aplikimit ishte e hapur për të gjithë debitorët e bankave nga data e publikimit të udhëzuesit deri më 31 mars 2021. Kreditë e ristrukturuara si rezultat i këtij udhëzimi nuk duhet të rezultojnë domosdoshmërisht në përqesim të klasifikimit të kredisë si rezultat i moratoriumeve të dhëna. Si rezultat i valës së tretë të ristrukturimeve në shkurt 2021, gjithsej 3.7 milionë euro kredi u ristrukturuan.

Një ndryshim në planet e pagesave mund të çojë në një humbje neto në vlerën aktuale të një kontrate kredie individuale, e cila përgjithësisht njihet në rezultatit tjetër të Bankës si një rregullim i njëhershëm i vlerës kontabël bruto që rezulton nga një modifikim i parëndësishëm i kontratës. Kjo ulje e NPV e kredive të modifikuara si pasojë e COVID-19 është kryesisht si rezultat i moratoriumeve të pagesave deri në 9 muaj.

Moratoriumi nënkupton që çdo pagesë e detyruar është shtyrë, duke rezultuar në NPV më të ulët se kredia përpara zbatimit të këtij moratoriumi nga banka.

Në vitin 2021, 114 mijë € janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave si humbje për periudhën dhe balancat rënëse të të arkëtueshmeve në këtë drejtim (2020: 173 mijë €).

Programet e drejtpërdrejta të qeverisë për të luftuar rënien ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19, Kosova miratoi masa të ndryshme mbështetëse për ekonominë dhe mbrojtjen e vendeve të punës. Masat përfshijnë forma të ndryshme të mbështetjes direkte financiare për individët, familjet dhe bizneset për të siguruar që kompanitë të kenë likuiditet të mjaftueshëm gjatë pandemisë COVID-19.

2.3 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Banka

Ndikimi i aplikimit fillestar të reformës së normave referencë të interesit

Në vitin e kaluar, Banka miratoi ndryshimet e Fazës 1 Reforma e normave referencë të interesit - Ndryshimet në SNRF 9/ SNK 39 dhe SNRF 7. Këto ndryshime modifikojnë kërkesat specifike të kontabilitetit mbrojtës për të lejuar që kontabiliteti mbrojtës të vazhdojë për mbrojtjen e prekur gjatë periudhës së pasigurisë para se zërat e mbrojtur ose instrumentet mbrojtës të jenë ndryshuar si rezultat i reformës së normave referencë të interesit.

Në vitin aktual, Banka miratoi ndryshimet e Fazës 2 Reforma e normave referencë të interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16. Miratimi i këtyre ndryshimeve i mundëson Bankës të pasqyrojë efektet e kalimit nga normat e ofruara ndërbankare (IBOR) në normat alternative referencë të interesit (të referuara gjithashtu si 'norma pa rrezik' ose RFR) pa shkaktuar ndikime kontabël që nuk do të ofronin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare.

Të dyja ndryshimet, pra të Fazës 1 dhe Fazës 2 nuk patën ndikim për Bankën, sepse ajo nuk ka asnjë instrument të lidhur me normat referencë të interesit IBOR. Instrumentet në CHF dhe GBP janë me norma interesi fikse.

Ndikimi i aplikimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë të lidhura me COVID-19 përtej 30 qershorit 2021 -Ndryshimi i SNRF 16

Ky mjet praktik ishte i disponueshëm për koncesionet e qirasë, për të cilat çdo reduktim i pagesave të qirasë ndikoi në pagesat që duhej të paguheshin fillimisht më ose përpara 30 qershorit 2021. Në mars 2021, Bordi nxori Koncesionet e Qirasë të lidhura me Covid-19 përtej datës 30 qershor 2021 (Ndryshimi i SNRF 16) që zgjeron mjetin praktik për t'u aplikuar për reduktimin e pagesave të qirasë që duhet të paguheshin fillimisht më ose përpara datës 30 qershor 2022.

Mjeti praktik lejon një qiramarrës të zgjedhë të mos vlerësojë nëse një koncesion i qirasë i lidhur me COVID-19 është një modifikim i qirasë. Një qiramarrës që bën këtë zgjedhje do të llogarisë çdo ndryshim në pagesat e qirasë që rezultojnë nga koncesioni i qirasë i lidhur me COVID-19 duke zbatuar SNRF 16 sikur ndryshimi të mos ishte një modifikim i qirasë. SNRF 16:46B Mjeti praktik zbatohet vetëm për koncesionet e qirasë që ndodhin si pasojë e drejtpërdrejtë e COVID-19 dhe vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Ndryshimi në pagesat e qirasë rezultojnë në një shumë të rishikuar për qiranë që është në thelb e njëjtë ose më e vogël se shumta për qiranë menjëherë para ndryshimit,
- Çdo reduktim në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që duhet të paguheshin fillimisht më ose përpara 30 qershorit 2022 (një koncesion qiraje plotëson këtë kusht nëse rezultojnë në ulje të pagesave të qirasë më ose përpara 30 qershorit 2022 dhe rritje të pagesave të qirasë që shtrihen përtej 30 qershorit 2022),
- Nuk ka asnjë ndryshim thelbësor në termat dhe kushtet e tjera të ndikimit të qirasë në kontabilitetin për ndryshimet në pagesat e qirasë duke zbatuar përjashtimin.

Në vitin aktual financiar, Banka nuk ka aplikuar ndryshimin në SNRF 16 (siç është publikuar nga Bordi në maj 2021) pasi nuk ka pasur koncesione qiraje në fushëveprimin e mjetit.

2.4 Standardet e reja dhe të rishikuara të SNRF-së të nxjerra, por ende jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, Banka nuk ka zbatuar standardet e reja dhe të rishikuara në vijim të SNRF-së që janë publikuar, por që nuk janë ende në fuqi:

SNRF 17 (përfshirë ndryshimet e qershorit 2020 në SNRF 17) - Kontratat e sigurimit
 Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 - Shitja ose kontributi i pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit (pjesëmarrjes) të tij ose sipërmarrjes së përbashkët
 Ndryshimet në SNK 1 - Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo rrjedhëse
 Ndryshimet në SNRF 3 - Referenca ndaj Kornizës Konceptuale
 Ndryshimet në SNK 16 - Prona, impiantet dhe pajisjet - Të ardhurat para përdorimit të synuar
 Ndryshimet në SNK 37 - Kontratat e vështira - Kostoja e përmbushjes së një kontrate
 Përmirësimet Vjetore të ciklit të Standardeve të SNRF 2018-2020 - Ndryshime në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 16 Qiratë dhe SNK 41 Bujqësia
 Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e praktikës 2 e SNRF - Shpalosja e politikave kontabël

Ndryshimet në SNK 8 - Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël

Ndryshimet në SNK 12 - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm Menaxhmenti i Bankës nuk pret që adoptimi i standardeve të renditura më sipër do të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Grupit në periudhat e ardhshme.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimit

SNRF 17 vendos parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të kontratave të sigurimit dhe zëvendëson SNRF 4 Kontratat e Sigurimit. SNRF 17 përshkruan një model të përgjithshëm, i cili modifikohet për kontratat e sigurimit me veçori të pjesëmarrjes direkte, i përshkruar si qasja e tarifës së ndryshueshme. Modeli i përgjithshëm thjeshtohet nëse plotësohen disa kriterë duke matur detyrimin për mbulimin e mbetur duke përdorur metodën e alokimit të primit. Modeli i përgjithshëm përdor supozimet aktuale për të vlerësuar shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshme dhe mat në mënyrë eksplicite koston e kësaj pasigurie. Ai merr parasysh normat e interesit të tregut dhe ndikimin e opsioneve dhe garancive të mbajtësve të policave.

Në qershor 2020, Bordi nxori Ndryshimet në SNRF 17 për të adresuar shqetësimet dhe sfidat e zbatimit që u identifikuan pas publikimit të SNRF 17. Ndryshimet shtojnë datën e zbatimit fillestar të SNRF 17 (duke përfshirë ndryshimet) për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Në të njëjtën kohë, Bordi nxori Zgjatjen e Përjashtimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (Ndryshimet në SNRF 4) që zgjat datën fikse të skadimit të përjashtimit të përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 në SNRF 4 në periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. SNRF 17 duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive, përveç rasteve kur është e pamundur, në të cilin rast aplikohet qasja retrospektive e modifikuar ose qasja e vlerës së drejtë. Për qëllimin e kërkesave të tranzicionit, data e aplikimit fillestar është fillimi i periudhës së raportimit vjetor në të cilën njësi ekonomike zbaton për herë të parë Standardin dhe data e tranzicionit është fillimi i periudhës menjëherë para datës së aplikimit fillestar.

Ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Shitja ose Kontributi i Pasurive ndërmjet një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 trajtojnë situatat kur ka një shitje ose kontribut të pasurive ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit (pjesëmarrjes) së tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Në mënyrë të veçantë, ndryshimet deklarohen se fitimet ose humbjet që rezultojnë nga humbja e kontrollit të një filiali që nuk përmban një biznes në një transaksion me një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët që kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto (ekuitetit), njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të kompanisë mëmë vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Në mënyrë të ngjashme, fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga rritja e investimeve të mbajtura në çdo ish filial (që është bërë një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët që kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto) në vlerën e drejtë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të ish-kompanisë mëmë vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen e re ose sipërmarrjen e përbashkët. Data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve ende nuk është caktuar nga Bordi; megjithatë, lejohet zbatimi i mëhershëm i ndryshimeve. Drejtoret e Kompanisë parashikojnë që zbatimi i këtyre ndryshimeve mund të ketë një ndikim në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit në periudhat e ardhshme nëse ndodhin transaksione të tilla.

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare - Klasifikimi i Detyrimeve si rrjedhëse ose jo rrjedhëse

Ndryshimet në SNK 1 prekin vetëm paraqitjen e detyrimeve si rrjedhëse ose jo rrjedhëse në pasqyrën e pozicionit financiar dhe jo shumën ose kohën e njohjes së ndonjë pasurie, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi, ose informacionin e shpalosur për këta zëra. Ndryshimet sqarojnë se klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose jo rrjedhëse bazohet në të drejtat që janë ekzistuese në fund të periudhës raportuese, specifikojnë se klasifikimi nuk ndikohet nga pritshmëritë mbi atë nëse një njësi ekonomike do të ushtrojë të drejtën e saj për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi, shpjegojnë se të drejtat janë ekzistuese nëse marrëveshjet respektohen në fund të periudhës raportuese, si dhe prezantojnë një përkufizim të 'shlyerjes' për të bërë të qartë se shlyerja i referohet transferimit tek pala tjetër e mjeteve monetare, instrumenteve të kapitalit neto, pasurive të tjera ose shërbimeve. Ndryshimet zbatohen në mënyrë retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referenca ndaj Kornizës Konceptuale

Ndryshimet përditësojnë SNRF 3 në mënyrë që t'i referohet Kornizës Konceptuale 2018 në vend të Kornizës së 1989-ës. Ato gjithashtu i shtojnë SNRF 3 një kërkesë që, për detyrimet brenda fushëveprimit të SNK 37, një blerës zbaton SNK 37 për të përcaktuar nëse në datën e blerjes ekziston një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të së shkuarës. Për një taksë që do të ishte brenda fushëveprimit të KIRFN 21 Taksat, blerësi zbaton KIRFN 21 për të përcaktuar nëse ngjarja detyruese që shkakton një detyrim për të paguar taksën ka ndodhur deri në datën e blerjes. Në fund, ndryshimet shtojnë një deklaratë të qartë që një blerës nuk njih pasuritë e kushtëzuara (kontingjente) të blera në një kombinim biznesi. Ndryshimet janë efektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore që fillon më ose pas 1 janarit 2022. Zbatimi i parakohshëm lejohet nëse një njësi ekonomike zbaton gjithashtu të gjitha referencat e tjera të përditësuara (të publikuara së bashku me Kornizën Konceptuale të përditësuara) në të njëjtën kohë ose më herët.

Ndryshimet në SNK 16 Prona, impiantet dhe pajisjet - Të ardhurat para përdorimit të synuar

Ndryshimet ndalojnë zbritjen nga kostoja e një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve të çdo të ardhure nga shitja e artikujve të prodhuar përpara se ajo pasuri të jetë e disponueshme për përdorim, d.m.th. të ardhurat gjatë sjelljes së pasurisë në vendndodhjen dhe gjendjen e nevojshme që ajo të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti.

Rrjedhimisht, një njësi ekonomike njih këto të ardhura nga shitjet dhe kostot e lidhura me të në fitim ose humbje. Njësia ekonomike mat koston e këtyre zërave në përputhje me SNK 2 Inventarët. Ndryshimet sqarojnë gjithashtu kuptimin e 'testimit nëse një pasuri funksionon siç duhet'. SNK 16 tani e specifikon këtë si vlerësim nëse performanca teknike dhe fizike e pasurisë është e tillë që ajo mund të përdoret në prodhimin ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'u dhënë me qira të tjerëve ose për qëllime administrative. Nëse nuk paraqitet veçmas në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrat financiare do të japin informacion shpjegues për shumën e të ardhurave dhe kostove të përfshira në fitim ose humbje që lidhen me zërat e prodhuar që nuk janë një produkt i aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike, dhe cilët zëra të linjës në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përfshijnë të ardhurat dhe kostot e tilla. Ndryshimet zbatohen në mënyrë retrospektive, por vetëm për zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve që sillen në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme që ato të jenë në gjendje të funksionojnë në mënyrën e synuar nga menaxhmenti në ose pas fillimit të periudhës më të hershme të paraqitur në pasqyrat financiare në të cilën njësia ekonomike zbaton fillimisht ndryshimet. Njësia ekonomike do të njohë efektin kumulativ të zbatimit fillimisht të ndryshimeve si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të pashpërndara (ose komponent tjetër të kapitalit neto, sipas rasti) në fillim të asaj periudhe më të hershme të paraqitur. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente - Kontratat e vështira - Kostoja e përmbushjes së një kontrate

Ndryshimet specifikojnë se "kostoja e përmbushjes" së një kontrate përfshin "kostot që lidhen drejtpërdrejt me kontratën". Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë përbëhen nga kostot inkrementale të përmbushjes së asaj kontrate (shembuj do të ishin puna direkte ose materialet) dhe një alokim i kostove të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratave (një shembull do të ishte alokimi i shpenzimit të amortizimit për një zë të pronës, impianteve dhe pajisjeve të përdorur në përmbushjen e kontratës). Ndryshimet zbatohen për kontratat për të cilat njësia ekonomike nuk i ka përmbushur ende të gjitha detyrimet e saj në fillim të periudhës së raportimit vjetor në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë ndryshimet. Krahasimet nuk riparaqiten/rilëshohen. Në vend të kësaj, njësia ekonomike do të njohë efektin kumulativ të aplikimit fillimisht të ndryshimeve si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të pashpërndara ose komponent tjetër të kapitalit neto, sipas rasti, në datën e aplikimit fillestar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2018-2020 - Ndryshimet në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 16 Qiratë dhe SNK 41 Bujqësia

Përmirësimet vjetore përfshijnë ndryshime në katër standarde:

SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Ndryshimi ofron lehtësim shtesë për një filial që bëhet adoptues për herë të parë më vonë se kompania mëmë në lidhje me kontabilizimin për diferencat kumulative të konvertimit. Si rezultat i ndryshimit, një filial që përdor përjashtimin në SNRF 1: D16(a) tani mund të zgjedhë gjithashtu të masë diferencat kumulative të konvertimit për të gjitha operacionet e huaja me vlerën kontabël që do të përfshihej në pasqyrat financiare të konsoliduara të kompanisë mëmë, bazuar në datën e kalimit të kompanisë mëmë në Standardet e SNRF, nëse nuk janë bërë rregullime për procedurat e konsolidimit dhe për efektet e kombinimit të biznesit në të cilin kompania mëmë ka blerë filialin. Një zgjedhje e ngjashme është e disponueshme për një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që përdor përjashtimin në SNRF 1: D16(a). Amendamenti është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

SNRF 9 Instrumentet Financiare

Ndryshimi sqaron se në aplikimin e testit '10 për qind' për të vlerësuar nëse duhet të çregjistrohet një detyrim financiar, një njësi ekonomike përfshin vetëm tarifën e paguara ose të marra ndërmjet njësisë ekonomike (huamarrësit) dhe huadhënësit, duke përfshirë tarifën e paguara ose të marra nga qoftë njësia ekonomike ose huadhënësi në emër të tjetrit. Ndryshimi zbatohet në mënyrë prospektive për modifikimet dhe shkëmbimet që ndodhin në ose pas datës kur njësia ekonomike e zbaton për herë të parë ndryshimin. Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

SNRF 16 Qiratë

Ndryshimi heq ilustrimin e rimbursimit të përmirësimeve të pronës me qira. Meqenëse ndryshimi i SNRF 16 ka të bëjë vetëm me një shembull ilustrues, nuk është dhënë asnjë datë efektive.

SNK 41 Bujqësia

Ndryshimi heq kërkesën në SNK 41 që njësitë ekonomike të përjashtojnë flukset monetare për tatimin kur matin vlerën e drejtë. Kjo përfaqëson matjen e vlerës së drejtë në SNK 41 me kërkesat e SNRF 13 Matja e vlerës së drejtë për të përdorur flukset monetare të qëndrueshme nga brenda dhe normat e skontimit dhe u mundëson përgatitësve të përcaktojnë nëse do të përdorin flukset monetare dhe normat e skontimit para tatimit ose pas tatimit për matjen më të përshtatshme të vlerës së drejtë. Ndryshimi zbatohet në mënyrë prospektive, p.sh. për matjen e vlerës së drejtë në ose pas datës kur një njësi ekonomike e zbaton fillimisht ndryshimin. Ndryshimi është efektiv për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe SNRF Deklarata e Praktikës 2 Të bërit e gjykimeve të materialitetit - Shpalosja e politikave kontabël

Ndryshimet ndryshojnë kërkesat në SNK 1 në lidhje me shpalosjen e politikave kontabël. Ndryshimet zëvendësojnë të gjitha rastet e termit 'politika të rëndësishme kontabël' me 'informacion material për politikën kontabël'. Informacioni i politikës kontabël është material nëse, kur merret parasysh së bashku me informacione të tjera të përfshira në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojë në vendimet që përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare marrin për qëllime të përgjithshme në bazë të atyre pasqyrave financiare. Paragrafët mbështetës në SNK 1 janë ndryshuar gjithashtu për të sqaruar se informacioni i politikës kontabël që lidhet me transaksione jomateriale, ngjarje ose kushte të tjera është jomaterial dhe nuk ka nevojë të jepet informacion shpjegues. Informacioni i politikës kontabël mund të jetë material për shkak të natyrës së transaksioneve të lidhura, ngjarjeve ose kushteve të tjera, edhe nëse shumat janë jomateriale. Megjithatë, jo të gjitha informacionet e politikave kontabël që lidhen me transaksionet materiale, ngjarjet ose kushtet e tjera janë në vetvete materiale. Bordi ka zhvilluar gjithashtu udhëzime dhe shembuj për të shpjeguar dhe demonstruar aplikimin e 'procesit të materialitetit me katër hapa' të përshkruar në SNRF Deklaratën e Praktikës 2. Ndryshimet në SNK 1 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023, me aplikim të parakohshëm të lejuar dhe aplikohen në mënyrë prospektive. Ndryshimet në SNRF Deklaratën e Praktikës 2 nuk përmbajnë një datë efektive ose kërkesa tranzicioni.

Ndryshimet në SNK 8 Politikën Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet-Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël

Ndryshimet zëvendësojnë përkufizimin e një ndryshimi në vlerësimet kontabël me një përkufizim të vlerësimeve kontabël. Sipas përkufizimit të ri, vlerësimet kontabël janë "shumat monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë së matjes". Përkufizimi i një ndryshimi në vlerësimet kontabël u fshi. Megjithatë, Bordi ruajti konceptin e ndryshimeve në vlerësimet kontabël në Standard me sqarimet e mëposhtme:

- Një ndryshim në vlerësimin kontabël që rezulton nga informacione të reja ose zhvillime të reja nuk është korigjimi i një gabimi
- Efektet e një ndryshimi në një input ose një teknikë matjeje të përdorur për të zhvilluar një vlerësim kontabël janë ndryshime në vlerësimet kontabël nëse ato nuk rezultojnë nga korigjimi i gabimeve të periudhës së mëparshme. Bordi shtoi dy shembuj (Shembujt 4-5) në Udhëzuesin për zbatimin e SNK 8, i cili shoqëron Standardin. Bordi ka fshirë një shembull (Shembulli 3) pasi mund të shkaktojë konfuzion në dritën e ndryshimeve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 për ndryshimet në politikën kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

Ndryshimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat - Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm

Ndryshimet prezantojnë një përjashtim të mëtejshëm nga përjashtimi i njohjes fillestare. Sipas ndryshimeve, një njësi ekonomike nuk zbaton përjashtimin e njohjes fillestare për transaksionet që shkaktojnë diferenca të barabarta të përkohshme të tatueshme dhe të skontueshme. Në varësi të ligjit tatimor në fuqi, diferencat e barabarta të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme mund të lindin në njohjen fillestare të një pasurie dhe detyrimi në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ndikon as në fitimin kontabël dhe as të tatueshëm. Për shembull, kjo mund të lindë me njohjen e një detyrimi qiraje dhe pasurisë përkatëse të së drejtës së përdorimit duke zbatuar SNRF 16 në datën e fillimit të qirasë. Pas ndryshimeve në SNK 12, një njësi ekonomike i kërkohet të njohë asetin dhe detyrimin tatimor të shtyrë, ku njohja e çdo aseti tatimor të shtyrë i nënshtrohet kriterëve të rikuperueshmërisë në SNK 12. Bordi shton gjithashtu një shembull ilustrues në SNK 12 që shpjegon se si zbatohen ndryshimet.

Ndryshimet zbatohen për transaksionet që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese të paraqitur. Përveç kësaj, në fillim të periudhës më të hershme krahasuese një njësi ekonomike njeh:

- Një pasuri tatimore e shtyrë (në masën që është e mundur që fitimi i tatueshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoret diferenca e përkohshme e skontueshme) dhe një detyrim tatimor i shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme të skontueshme dhe të tatueshme që lidhen me: (1) pasuritë e të drejtës së përdorimit dhe detyrimet e qirasë dhe (2) Dekomisionimin, restaurimin dhe detyrime të ngjashme dhe shumat përkatëse të njohura si pjesë e kostos së pasurisë përkatëse;
- Efekti kumulativ i aplikimit fillimisht të ndryshimeve si një rregullim në bilancin fillestar të fitimeve të pashpërndara (ose komponent tjetër të kapitalit neto, sipas rasisit) në atë datë. Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023, me aplikim të parakohshëm të lejuar.

a. Monedha funksionale dhe prezantuese

Monedha funksionale e Bankës e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare është euro pasi është monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin operon Banka dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve themelore ("monedha funksionale"). Të gjitha shumat janë rumbullakuara në mijërat më të afërta, përveç rasteve kur tregohet ndryshe.

b. Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare të veçanta, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

3 Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të veçanta.

3.1 Degët dhe konsolidimi

Degët (filialet) janë subjekte të kontrolluara nga Banka. Kontrolli ekziston kur Banka është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me të investuarin (filialin) dhe ka aftësinë të ndikojë në këto kthime nëpërmjet fuqisë së saj mbi të investuarin. Këto pasqyra financiare përfaqësojnë vetëm rezultatin dhe pozicionin financiar të Bankës dhe nuk përfshijnë ato të filialeve të saj, siç detajohet në Shënimin 13.

Banka përgatit pasqyra financiare të veçanta dhe të konsoliduara në përputhje me SNRF. Pasqyrat financiare të konsoliduara përgatiten për qëllime rregullatore vendore dhe nuk publikohen pasi vetë Banka është një filial tërësisht në pronësi dhe kompania mëmë përfundimtare Raiffeisen Bank International përpilon pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik në <http://www.rbinternational.com>, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Interesat në filialet kontabilizohen me bazë të koston në pasqyrat financiare të veçanta.

3.2 Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet e këmbimit valutor regjistrohen sipas kursit në ditën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet monetare të shprehura në valutë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi me kursin e këmbimit në fund të vitit të pasurive dhe detyrimeve monetare të shprehura në valutë të huaj njihen në fitim ose humbje në Shënimin 23 Të ardhurat nga tarifrat dhe komisionet dhe Shënimin 24 Fitimet dhe humbjet, diferencat e këmbimit.

3.3 Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

3.3.1 Klasifikimi i pasurive financiare

Banka klasifikon të gjitha pasuritë e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për menaxhimin e pasurive dhe kushtet kontraktuale të pasurisë, të matura me:

- koston e amortizuar,
- vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI), dhe
- vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL).

3.3.2 Klasifikimi i detyrimeve financiare

Të gjitha detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me kosto të amortizuar, përveç zërave të mëposhtëm që maten me FVTPL:

- Detyrimet financiare që mbahen për tregtim – duke përfshirë derivativët,
- Detyrimet financiare që lindin kur një transferim i një pasurie financiare nuk kualifikohet për çregjistrim ose kur zbatohet metoda e përfshirjes së vazhdueshme,
- Garancitë financiare dhe zotimet kreditore nën normat e interesit të tregut,
- Shuma kontingjente e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi,
- Detyrimet financiare që janë përcaktuar si në FVTPL në njohjen fillestare.

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare me koston e amortizuar dhe me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

3.3.3 Modeli i biznesit

Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që pasqyron më së miri se si ajo menaxhon grupet e pasurive financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit të Bankës nuk vlerësohet mbi bazën e secilit instrument veç e veç, por në një nivel më të lartë të portofoliove të agreguara dhe bazohet në faktorë të vëzhgueshëm si:

- Si vlerësohen dhe raportohen performanca e modelit të biznesit dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi tek personeli drejtues kryesor i njësive ekonomike,

- Rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe pasuritë financiare të mbajtura brenda atij modeli të biznesit) dhe, në veçanti, mënyrën e menaxhimit të këtyre rreziqeve,
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të menaxhuara ose në flukset monetare kontraktuale të mbledhura);
- Frekuenca e pritur, vlera dhe koha e shitjeve janë gjithashtu aspekte të rëndësishme të vlerësimit të Bankës.

Megjithatë, vlerësimi i Bankës është se niveli më i lartë i mundshëm i agregimit është në nivel të departamentit të Bankës. Duhet të përdoren nënportofolio të mëtejshme në mënyrë që çdo portofol të ketë karakteristikat e njëjtat ose të ngjashme të mëposhtme:

- Fusha e biznesit,
- TKP-të e vlerësimit të performancës,
- Personali kryesor i menaxhimit (B-1),
- Rreziqet dhe proceset e menaxhimit të rrezikut,
- Infrastruktura e TI-së.

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë arsyeshëm të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët e 'rastit më të keq' ose të 'rastit të stresit'. Nëse flukset monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë që është e ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Bankës, Banka nuk e ndryshon klasifikimin e pasurive financiare të mbetura të mbajtura në atë model biznesi, por e inkorporon këtë informacion gjatë vlerësimit të pasurive financiare të sapokrijtura apo të sapo blera në vijim.

3.3.4 Karakteristika e flukseve monetare kontraktuale

Për pasuritë financiare me model biznesi për të mbledhur flukset monetare kontraktuale, banka vlerëson nëse kushtet kontraktuale të pasurisë financiare shkaktojnë në data specifike flukse monetare që janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit mbi shumën e papaguar të kryegjësë. Për këtë qëllim, interesi përkufizohet si kompensim për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë që lidhet me shumën e kryegjësë të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqe të tjera bazë të huadhënies (për shembull likuiditeti) dhe kostot (për shembull administrative), si dhe një marzh fitimi. Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit, banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse pasuria financiare përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale ashtu që të mos plotësojë këtë kusht. Banka merr parasysh:

- Parapagimet, kushtet e zgjatjes,
- Karakteristikat e leverazheve,
- Pretendimi kufizohet në pasuritë e specifikuar ose flukset monetare,
- Instrumentet e lidhura në mënyrë kontraktuale.

Ky vlerësim duhet të kryhet mbi bazën e secilit instrument veç e veç në datën e njohjes fillestare të pasurisë financiare.

3.3.5 Modifikimi i vlerës në kohë të parasë dhe testi i pikës referuese (Benchmark)

Vlera në kohë e parasë është elementi i interesit që ofron konsideratë vetëm për kalimin e kohës. Nuk merr parasysh risqet e tjera (kredi, likuiditet etj.) ose kostot (administrative, etj.) të lidhura me mbajtjen e një pasurie financiare.:

Në disa raste, elementi i vlerës në kohë të parasë mund të modifikohet (i papërsosur). Ky do të ishte rasti, për shembull, nëse norma e interesit e një pasurie financiare rivendoset periodikisht, por frekuenca e asaj rivendosjeje nuk përputhet me maturimin e normës së interesit. Në këtë rast, njësitë duhet të vlerësojnë modifikimin nëse flukset monetare kontraktuale përfaqësojnë ende vetëm pagesa të kryegjësë dhe interesit, d.m.th., termi i modifikimit nuk i ndryshon ndjeshëm flukset monetare nga një instrument referent 'i përsosur'. Ky vlerësim nuk është një zgjedhje e politikës kontabël dhe nuk mund të shmangët thjesht duke arritur në përfundimin se një instrument, në mungesë të një vlerësimi të tillë, do të matet me vlerën e drejtë.

Për tiparet kryesore të mëposhtme kontraktuale që mund të modifikojnë potencialisht vlerën në kohë të parasë, zbatohet një test "pikë reference" (benchmark):

- Frekuenca e normës së rivendosjes nuk përputhet me maturimin e interesit,
- Treguesi i ngecjes,
- Klauzola zbutëse,
- Grejs periudha,
- Referenca e rendimentit të tregut sekondar.

3.3.6 Njohja e pasurive dhe detyrimeve financiare

Banka fillimisht njeh kreditë, të arkëtueshmet dhe detyrimet e tjera financiare në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet të tjera financiare (përfshirë blerjet e rregullta dhe shitjet e pasurive financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Pasuria financiare ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për zërin që nuk është me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo emetimin e tij.

3.3.7 Çregjistrimi i pasurive dhe detyrimeve financiare

3.3.7.1 Çregjistrimi për shkak të modifikimit thelbësor të termave dhe kushteve

Banka çregjistron një pasuri financiare, të tillë si një kredi për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar deri në masën që, në thelb, bëhet një kredi e re, ku diferenca njihet si një fitim ose humbje nga çregjistrimi. Kreditë e njohura rishtazi klasifikohen si Faza 1 për qëllime të matjes së ECL-së, përveç rastiit kur kredia e re konsiderohet të jetë POCL.

Kur vlerëson nëse duhet të çregjistrojë apo jo një kredi për një klient, Banka merr parasysh faktorët e mëposhtëm cilësor:

- Ndryshimi në valutën e kredisë,
- Prezantimi i një tipari të kapitalit neto,
- Ndryshimi në palën tjetër,
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të plotësonte më kriterin SPPI.

dhe faktorët sasiorë:

- Zgjatja e afatit mesatar të mbetur baras ose më shumë se 50 për qind dhe baras ose më shumë se 2 vjet (kumulative),
- Ndryshimet e shumës së kostos së amortizuar (të zbritura me EIR origjinal) me baras ose më shumë se 10 për qind dhe/ose të baras ose më shumë se 100 mijë,
- Kreditë e Fazës 3 shpesh mund të ristrukturohen për të përputhur pagesat maksimale të pritshme që një klient që nuk ka përmbushur detyrimin e pagesës mund të përballojë. Nëse është kështu, atëherë një zgjatje përtej 2 vjetëgjatësisëh nuk rezulton automatikisht në çregjistrim dhe kërkon gjykim për të përcaktuar nëse zgjatja është ekonomikisht një instrument i ri.

3.3.7.2 Çregjistrimi përveç modifikimit thelbësor

Pasuritë financiare

Një pasuri financiare (ose, sipas rastiit, një pjesë e një pasurie financiare ose pjesë e një grupi pasurish financiarë të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë flukse monetare nga pasuria financiare kanë skaduar. Banka gjithashtu çregjistron pasurinë financiare nëse ajo ka transferuar pasurinë financiare dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Banka ka transferuar pasurinë financiare nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë flukse monetare nga pasuria financiare, ose
- Ajo ruan të drejtat për flukset monetare, por ka marrë përsipër një detyrim për t'i paguar plotësisht flukset monetare të marra pa vonesa materiale ndaj një pale të tretë sipas një marrëveshjeje kalimi (pass-through).

Marrëveshjet e kalimit janë transaksione në të cilat Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë

flukset monetare të një pasurie financiare ("pasuria origjinale"), por merr një detyrim kontraktual për t'i paguar ato flukse monetare një ose më shumë njësive ekonomike ("përfituesit eventual"), kur plotësohen të tre kushtet e mëposhtme:

- Banka nuk ka asnjë detyrim t'u paguajë shumat përfituesve eventualë, përveç nëse ka mbledhur shumata ekuivalente nga pasuria origjinale, duke përjashtuar paradhëniet afatshkurtra me të drejtën për rikuperim të plotë të shumës së huasë plus interesin e përlogaritur me normat e tregut.
- Banka nuk mund të shesë ose të lërë peng pasurinë origjinale përveçse si garanci për marrësit e mundshëm,
- Banka duhet të dorëzojë çdo fluks monetar që mbledh në emër të marrësve eventualë pa vonesa materiale.

Për më tepër, Banka nuk ka të drejtë të riinvestojë flukse të tilla monetare, me përjashtim të investimeve në para ose ekuivalente të parasë, duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës ndërmjet datës së arkëtimit dhe datës së dërgesës së kërkuar të marrësit eventual.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurisë, ose
- Banka as nuk ka transferuar dhe as mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pasurisë, por ka transferuar kontrollin e pasurisë.

Banka konsideron se kontrolli do të transferohet nëse dhe vetëm nëse marrësi ka aftësinë praktike t'ia shesë pasurinë në tërësi një pale të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Kur Banka as nuk i ka transferuar dhe as nuk i ka mbajtur në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet dhe ka mbajtur kontrollin e pasurisë, pasuria vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, në të cilin rast, Banka njih gjithashtu një detyrim të lidhur. Pasuria e transferuar dhe detyrimi i lidhur maten mbi një bazë që pasqyron të drejtat dhe detyrimet që Banka ka ruajtur.

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) për pasurinë e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Banka do të kërkohej të paguajë pas riblerjes. Në rastin e një opsioni të shkruar për shitje për një pasuri që matet me vlerën e drejtë, shtrirja e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e kufizuar në vlerën e drejtë të pasurisë së transferuar dhe çmimit të ushtrimit të opsionit, cilado që është më e ulët.

Detyrimet financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur obligimi sipas detyrimit shlyhet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet nga një tjetër nga i njëjti huadhënës me kushte thelbësisht të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues janë modifikuar thelbësisht, një shkëmbim ose modifikim i tillë trajtohet si çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njohje e një detyrimi të ri. Çregjistrimi kontabilizohet për rastet kur ndryshimet e shumës së kostos së amortizuar (të zbritura me EIR origjinale) janë të barabarta ose më shumë se 10 përqind dhe/ose të barabarta ose më shumë se 100 mijë euro. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe shumës së paguar njihet në fitim ose humbje.

3.3.8 Netimi (kompensimi)

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare kompensohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Banka ka të drejtën ligjore të kompensojë shumat dhe ajo synon ose t'ia shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm kur kjo lejohet sipas SNRF-ve.

3.3.9 Matja e kostos së amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus çdo reduktim për rënie në vlerë.

3.3.10 Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në kryegjënë ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm për të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mosperformancës së tij.

Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të përcaktojë se cili do të ishte çmimi i transaksionit (d.m.th. një çmim dalës) në datën e matjes në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që përdor maksimalisht të dhënat e tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur në të dhëna specifike për njësinë ekonomike. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë në një vlerësim realist të vlerës së drejtë nëse:

- a) reflekton në mënyrë të arsyeshme se si mund të pritet çmimi i tregut për vlerën e instrumentit, dhe
- b) inputet në teknikën e vlerësimit përfaqësojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmëritë e tregut dhe masat e faktorëve rrezik-kthim të qenësishëm në instrumentin financiar.

Prandaj, një teknikë vlerësimi:

- a) përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në përcaktimin e një çmimi, dhe
- b) është në përputhje me metodologjitë e pranuar ekonomike për çmimin e instrumenteve financiare.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë). Metodologji të tjera përfshijnë krahasimin e vlerës së drejtë të atij instrumenti duke krahasuar me transaksione të tjera të vëzhgueshme aktuale të tregut në të njëjtin instrument/të ngjashëm (d.m.th. pa modifikim ose ripaketim) ose bazuar në një teknikë vlerësimi, variablat e së cilës përfshijnë të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

Qasja e flukseve monetare të skontuara është një teknikë e përdorur për të lidhur shumat e ardhshme (flukset monetare) me të tashmen përmes një norme skontimi.

Konceptet e vlerës aktuale janë kritike për zhvillimin e teknikave për vlerësimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare, sepse çmimi i daljes nga tregu i një instrumenti financiar përfaqëson vlerësimin kolektiv të pjesëmarrësit në treg për vlerën aktuale të flukseve monetare të tij të pritshme. Prandaj, flukset monetare dhe norma e skontimit duhet të pasqyrojnë vetëm faktorë që janë specifikë për instrumentin financiar që matet dhe duhet të pasqyrojnë supozimet që pjesëmarrësit e tregut do të përdornin në vlerësimet e tyre të vlerës së drejtë. Gjithashtu, duke qenë se flukset monetare të përdorura janë vlerësime dhe jo shuma të njohura, një vlerësim i vlerës së drejtë, duke përdorur vlerën aktuale, bëhet në kushte pasigurie. Duke qenë se pjesëmarrësit e tregut në përgjithësi kërkojnë kompensim për mbajtjen e pasigurisë së natyrshme në flukset monetare (primi i rrezikut), efekti i ndryshueshmërisë (rrezikut) në flukset monetare duhet të pasqyrohet ose në flukset monetare ose në normën e skontimit.

Në aplikimin e analizës së flukseve monetare të skontuara ("DCF"), Banka duhet të përdorë norma skontimi të barabarta me normat mbizotëruese të kthimit për instrumentet financiare që kanë në thelb të njëjtat kushte dhe karakteristika, duke përfshirë cilësinë kreditore të instrumentit, afatin e mbetur gjatë të cilit norma e interesit kontraktuale është fikse, afati i mbetur i ripagesës së kryegjësë dhe monedha në të cilën do të kryhen pagesat. Flukset monetare të përdorura në modelin DCF duhet të "përshtaten" me normën e skontimit dhe gjithashtu duhet të marrin parasysh karakteristikat e përmendura më sipër (p.sh. afati i mbetur i normës së interesit kontraktuale dhe i kryegjësë).

Kur është e disponueshme, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet për pasurinë ose detyrimin kryhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimin në mënyrë të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikën e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve të pavëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën mund të kërkohej të paguhet shuma. Banka njëhans transferta ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

3.3.11 *Garancitë financiare, letër kreditë dhe zotimet e patërhequra të huasë*

Banka lëshon garanci financiare, letër kredi dhe zotime kredie. Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë, duke qenë primari i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës sipas çdo garancie matet me vlerën më të lartë të shumës së njohur fillimisht minus amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe sipas SNRF 9 – një provizionit ECL. Primari i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet mbi bazën lineare gjatë jetëgjatësisë së garancisë. Zotimet e patërhequra të huasë dhe letër kreditit janë zotime sipas të cilave, gjatë kohëzgjatjes së zotimit, Banka kërkohet t'i japë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Ngjashëm me kontratat e garancisë financiare, këto kontrata janë në fushëveprimin e kërkesave të ECL.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare, letër kredive dhe zotimeve të patërhequra të huasë, ku huaja e rënë dakord për t'u dhënë është me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve janë shpalosur në Shënimin 20 dhe ECL-të përkatëse janë shpalosur në Shënimin 6.

3.3.12 *Instrumentet financiare – Rënia në vlerë (SNRF 9)*

Matja e rënies në vlerë për humbjet e pritshme kreditore nga pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar dhe vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse është një fushë që kërkon përdorimin e modeleve komplekse dhe supozime të rëndësishme për kushtet e ardhshme ekonomike dhe sjelljet e pagesave.

Kërkohen gjykime të rëndësishme në zbatimin e kërkesave kontabël për matjen e humbjeve të pritshme kreditore, ndër të tjera:

- Përcaktimi i kriterëve për rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor,
- Zgjedhja e modeleve dhe supozimeve të përshtatshme për matjen e humbjeve të pritshme kreditore,
- Përcaktimi i numrit dhe peshimeve relative të skenarëve parashikues për çdo lloj produkti/tregu dhe humbjet e pritshme kreditore shoqëruese,
- Krijimi i grupeve të pasurive financiare të ngjashme për qëllime të matjes së humbjeve të pritshme kreditore.

Për bankën, rreziku kreditor vjen nga rreziku i pësimit të humbjes financiare nëse ndonjë nga konsumatorët, klientët ose palët e tregut të bankës nuk përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Rreziku kreditor lind kryesisht nga kreditë ndërbankare, komerciale dhe personale, si dhe nga zotimet e kredive që rrjedhin nga aktivitete të tilla huadhënëse, por mund të lindë edhe nga garancitë financiare të dhëna, të tilla si garancitë kreditore, letër kreditit dhe pranimet. Banka është gjithashtu e ekspozuar ndaj rreziqeve të tjera kreditore që rrjedhin nga investimet në letrat me vlerë të borxhit.

Vlerësimi i rrezikut kreditor për qëllime të menaxhimit të rrezikut është kompleks dhe kërkon përdorimin e modeleve, pasi rreziku ndryshon me ndryshimet në kushtet e tregut, flukset e pritura monetare dhe kalimin e kohës. Vlerësimi i rrezikut kreditor të një portofolio pasurish përfshin vlerësime të mëtejshme në lidhje me gjasat që të ndodhin mospërbushje të detyrimeve (mospagesa), raportet e lidhura të mospagesës (ang. default) dhe korrelacionet e mospagesës ndërmjet palëve. SNRF 9 përshkruan një model me tre faza për rënien në vlerë bazuar në ndryshimet në cilësinë kreditore nga pika e njohjes fillestare. Sipas këtij modeli, një instrument financiar që nuk është i kreditit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, klasifikohet në Fazën 1 dhe rreziku i tij kreditor monitorohet vazhdimisht. Sipas SNRF 9, kur maten humbjet e pritshme të kredisë, është e nevojshme të merren parasysh informacionet parashikuese. Pasuritë financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCI) janë ato pasuri financiare që janë të kreditit të zhvlerësuar në njohjen fillestare. Humbja e tyre e pritshme kreditore matet gjithmonë mbi bazën e jetëgjatësisë.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grupon kreditë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCI, siç përshkruhet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, banka njih një lejim në bazë të ECL 12-mujore. Kreditë e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë instrumente ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor që nga krijimi, banka regjistron një lejim për humbjet e pritshme kreditore gjatë jetëgjatësisë- LTECL. Kreditë e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë instrumente, ku risku kreditor është përmirësuar dhe kredia është riklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: Kreditë që konsiderohen të kreditit të zhvlerësuar (siç janë shënuar në Shënimin 4). Banka regjistron një lejim për LTECL-të.
- POCI: Asetet e blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCI) janë asetet financiare që kanë pësuar zhvlerësim kreditor në njohjen fillestare. Pasuritë e POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. ECL-të njihen ose njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritura kreditore. Për pasuritë financiare për të cilat Banka nuk ka shpresa të arsyeshme për mbulimin e të gjithë shumës së papaguar, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesshëm) i pasurisë financiare.

Rritja e ndjeshme e rrezikut kreditor

Banka konsideron se një instrument financiar ka përjetuar një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor kur një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose të rezervës (backstop) janë përbushur:

Kriteret sasiore

Banka përdor kriteret sasiore si treguesin kryesor të rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor për të gjitha portofolet materiale plus kriteret cilësore shtesë si 30 ditë vonesë ose masat e ristrukturimit/riprogramimit për një instrument të caktuar kreditor si mjet rezervë/mbështetës (backstop). Për ndarjen në faza në aspektin sasiore, banka krahason kurbën e PD të jetëgjatësisë në datën e raportimit me kurbën PD të parashikuar të jetëgjatësisë në datën e njohjes fillestare. Duke pasur parasysh natyrën e ndryshme të produkteve midis retail dhe jo-retail, metodat për vlerësimin e rritjeve potenciale të rëndësishme gjithashtu ndryshojnë pak. Për rrezikun jo-retail për t'i bërë dy kurbat të krahasueshme, PD-të shkallëzohen në PD vjetore. Një rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor konsiderohet të ketë ndodhur nëse rritja e PD ishte 250 për qind ose më shumë. Për maturimet më të gjata, pragu prej 250 për qind reduktohet për të llogaritur efektin e maturimit. Për ekspozimet retail nga ana tjetër, PD-të e mbetura kumulative krahasohen si diferenca logit midis "PD të jetëgjatësisë në datën e raportimit" dhe "PD të jetëgjatësisë në origjinim të kushtëzuara me mbijetesën deri në datën e raportimit". Një rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor konsiderohet se ka ndodhur kur kjo diferencë logit është mbi një prag të caktuar. Nivelet e pragut llogariten veçmas për çdo portofol, i cili mbulohet nga modele individuale të PD të jetëgjatësisë të bazuara në vlerësim/klasifikim. Bazuar në të dhënat historike, pragjet vlerësohen si kuantili i 50-të i shpërndarjes së diferencave logit të sipërpërmendur në portofolin në përkeqësim. Në këtë mënyrë, 50 për qind e përkeqësimit të PD-ve të jetëgjatësisë me shkallën më të lartë konsiderohet e rëndësishme. Kjo zakonisht përkthehet në një rritje të PD midis 150 dhe deri në 300 përqind, në varësi të sjelljes së mospagesës të portofoleve të ndryshme. Për sa i përket pragut në të cilin një instrument financiar duhet të transferohet në fazën 2, Banka ka vendosur për pragjet bazuar në praktikën aktuale të tregut.

Kriteret cilësore

Kriteret cilësore të bankës si tregues dytësor i rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor për të gjitha portofoliot materiale. Lëvizja në Fazën 2 bëhet kur plotësohen kriteret e mëposhtme. Për portofoliot e sovranëve, bankave, klientëve të korporatave dhe financimit të projekteve, nëse huamarësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Treguesit e tregut të jashtëm
- Ndryshimet në kushtet e kontratës
- Ndryshimet në qasjen e menaxhimit
- Gjykimi i ekspertit

Vlerësimi i një rritjeje të ndjeshme të rrezikut kreditor përfshin informacione parashikuese dhe kryhet në baza tremujore në nivel transaksionesh individuale për të gjitha portofoliot e klientëve sovranë, banka, të korporatave dhe financimit të projekteve të mbajtura nga banka.

Për portofoliot retail, nëse huamarrësi plotëson një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:

- Riprogramimi
- Mospagesa e ekspozimit tjetër të të njëjtit klient (segmenti PI)
- Qasja holistike - E aplikueshme për rastet kur informacioni i ri parashikues bëhet i disponueshëm për një segment ose pjesë të portofolit dhe ky informacion nuk është përfshirë ende në sistemin e klasifikimit/vlerësimit. Nëse identifikohen raste të tilla, menaxhmenti mat këtë portofol me humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë (si një vlerësim kolektiv).
- Vlerësimi i rritjes së ndjeshme të rrezikut kreditor përfshin informacionin parashikues dhe kryhet në baza mujore në nivel transaksioni individual për të gjitha portofoliet retail të mbajtura nga banka.

Mjeti mbështetës/rezerva (Backstop)

Rezerva (backstop) aplikohet dhe instrumenti financiar konsiderohet se ka pësuar një rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor nëse huamarrësi ka më shumë se 30 ditë vonesë në pagesat e tij kontraktuale. Në disa raste të kufizuara, supozimi se pasuritë financiare të cilat janë më shumë se 30 ditë në vonesë duhet të zhvendosen në Fazën 2, hidhet poshtë.

Përgjashtimi i rrezikut të ulët kreditor

Në raste të përzgjedhura, kryesisht për letrat me vlerë të borxhit të sovranëve, banka përdor përgjashtimin e rrezikut të ulët kreditor. Të gjitha letrat me vlerë të cilat paraqiten me rrezik të ulët kreditor kanë një vlerësim/rejting ekuivalent me shkallën investuese ose më mirë, p.sh. minimum BBB- nga S&P, Baa3 nga Moody's ose BBB- nga Fitch.

Banka nuk ka përdorur përgjashtimin e rrezikut të ulët kreditor për asnjë huadhënie.

Përkufizimi i mospagesës (default) dhe aseteve të kreditit të zhvlerësuar

Mospagesa përcaktohet në nenin 178 të CRR si ngjarja ku një debitor specifik i bankës:

1. nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e kredisë⁴ ndaj bankës nga burimet parësore, ose
2. debitori është në vonesë për më shumë se 90 ditë për çdo detyrim material kreditor ndaj bankës.

Treguesit për klasifikimin 'nuk ka gjasa të paguaj' përfshihen afërsisht në nenin 178 (3) të CRR.

Joretail

Banka ka përcaktuar 12 tregues të cilët përdoren aktualisht për të identifikuar kriterin "nuk ka gjasa të paguaj" dhe vonesat prej 90 ditë dhe që duhet të merren parasysh në DDB (fusha: klasifikimi i mospagesës). Kolona 'Klasifikimi' jep një referencë se cilës nga dy arsyet e renditura më sipër të mospagesës i referohet treguesi.

- Falimentimi
- Shlyerja/fshirja e drejtpërdrejtë
- Detyrimi kreditor/Pretendimi është shlyer kundrejt provizioneve
- Kredia/instrumenti kreditor është thirrur
- Ristrukturimi i vështirë
- Pagesa e interesit është anuluar
- Detyrimi kreditor/Pretendimi është shitur me humbje
- Pagesa e vonuar
- Licenca e tërhequr
- Moratoriumi i pagesave
- Humbja e pritshme ekonomike
- Mospagesë tërthore (cross default)

Llogaritja e pragut për vonesat materiale

Pragu i materialitetit të bankës për klientët joretail është i rregulluar në draft Standardet Teknike Rregullatore (RTS) mbi pragu e materialitetit për detyrimin kreditor në vonesë sipas nenit 178 të Rregullores (BE) nr. 575/2013, të miratuar nga Komisioni i BE-së si Rregullores e deleguar (BE) nr. 2018/171 – ka hyrë në fuqi më 26 shkurt 2018. Sipas rregullores së lartpërmendur, pragu përbëhet nga një komponent absolut dhe një relativ:

- a) komponenti absolut i pragut vendoset si shuma maksimale për shumën e mbledhur të të gjitha shumave të vonuara që një obligues i detyrohet bankës ('detyrim kredie i vonuar') dhe nuk duhet të kalojë 500 € ose ekuivalentin e asaj shume në valutën përkatëse kombëtare, dhe
- b) komponenti relativ i pragut vendoset si një raport, i shprehur në përqindje, i shumës së vonuar siç përmendet në pikën (a), kundrejt shumës totale të të gjitha ekspozimeve në bilanc ndaj obliguesit, duke përfshirë ekspozimet e kapitalit neto ('detyrimi kreditor në bilanc'); dhe është e barabartë me 1 për qind.

Retail

Banka përdor treguesit e mëposhtëm të mospagesës për retail: treguesin 90+DPD dhe 17 treguesi të "nuk ka gjasa të paguaj", duke përfshirë 4 situata të mospagesës tërthore.

90+ ditë vonese

Për qëllime të zbatimit të pikës (b) të nenit 178(1) të CRR-së, obliguesi konsiderohet se është mospagues në rast se është në vonesë për më shumë se 90 ditë rresht për çdo detyrim material kreditor.

Pragu i materialitetit të bankës përbëhet nga një komponent absolut dhe relativ:

- Komponenti i pragut absolut është i barabartë me 100 €,
- Komponenti i pragut relativ është i barabartë me 1 për qind të shumës totale të ekspozimit në bilanc.

Numëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë të gjitha shumat e vonuara që ekzistojnë për një kredi/një obligues (llogaritur në bazë të nivelit të përdorur të aplikimit të mospagesës). Emëruesi i llogaritjes së pragut relativ duhet të përfshijë ekspozimin në bilanc të obliguesit ndaj bankës, duke përfshirë të gjitha shumat e vonuara të konsideruara në numërues.

Treguesit e kriterit "nuk ka gjasa të paguaj"

- Statusi joakrual
- Rregullime specifike të rrezikut kreditor
- Shitja e borxhit
- Ristrukturim i vështirë
- Falimentimi
- Mashtrimi me kredi
- Vdekja e obliguesit
- Humbja e të ardhurave
- Borxhi i konsiderueshëm
- Shkelja e marrëveshjeve kontraktuale
- Thirrja e kontratës para maturimit
- Shitja e kolateralit
- POCI

Situatat e mospagesës tërthore

- Mospagesë tërthore e produktit
- Efekti tërheqës [rregull ku nëse një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve totale të një huamarrësi është në mospagesë, atëherë të gjitha ekspozimet e tjera ndaj atij huamarrësi gjithashtu duhet të jenë në mospagesë].
- Mospagesa e detyrimit të përbashkët
- Mospagesa e klientit të lidhur

Koncepti i llogaritjes i SNRF 9

SNRF 9 përdor një model të humbjeve të pritshme të kredive për të njohur rënien në vlerë. Modeli i humbjeve të pritshme të kredive zbatohet për instrumentet e borxhit me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, të arkëtueshmeve nga qiraja, pasurive kontraktuale dhezotimeve të kredisë dhe kontratave të garancive financiare që nuk maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Ekzistojnë tre qasje kryesore që mund të përdoren për të llogaritur humbjet e pritshme kreditore, këto janë:

- A. Qasje e përgjithshme
- B. Qasje e thjeshtuar
- C. Asetet e blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar

A. Qasje e përgjithshme

Në përdorimin e qasjes së përgjithshme, shumica e humbjeve të pritshme kreditore e njihur si lejim ose provizion për humbje varet nga vlerësimi i shkallës së përkeqësimit të kreditit që nga njohja fillestare.

Prandaj, ekzistojnë dy mundësi:

- Kur rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, banka do të masë lejimin e humbjes për atë instrument financiar në një shumë që është e barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore (SNRF 9.5.5.5). Këto pasuri janë në Fazën 1.
- Kur rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, banka do të masë lejimin e humbjes me një shumë që është e barabartë me humbjet e pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë (SNRF 9.5.5.4). Këto pasuri janë në Fazën 2.

Objekti i kërkesave për rënien në vlerë është njohja e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë për të gjitha instrumentet financiare për të cilat ka pasur rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare - qoftë e vlerësuar në baza individuale apo kolektive - duke marrë parasysh të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur, duke përfshirë informacionin parashikues (SNRF 9.5.5.4). Vlerësimi nëse duhet të njihen humbjet e pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë bazohet në rritjet e konsiderueshme të gjasave ose rrezikut që të ndoshë mospagesa që nga njohja fillestare, pavarësisht nëse një instrumenti financiar i është rivendosur çmimi për të reflektuar një rritje të rrezikut kreditor.

B. Qasje e thjeshtuar

Ekziston një qasje e thjeshtuar e cila ka disa thjeshtëzime operacionale dhe duhet të zbatohet ose është një zgjedhje e politikave për të arkëtueshmet tregtare, asetet kontraktuale dhe të arkëtueshmet e qirasë. Kjo përfshin kërkesën ose zgjedhjen e politikave për të aplikuar qasjen e thjeshtuar që nuk kërkon që njësitë ekonomike të gjurmojnë ndryshimet në rrezikun kreditor, sepse ato do të ishin të gjitha në Fazën 2 si një mundësi praktike për të llogaritur humbjet e pritshme kreditore në të arkëtueshmet tregtare duke përdorur një matricë provizioni.

Qasja e thjeshtuar nuk zbatohet nga banka.

C. Asetet financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar

Për pasuritë financiare të cilat janë të kreditit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, banka do të njohë vetëm ndryshimet kumulative në humbjet e pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë që nga njohja fillestare si një lejim për humbjet për pasuritë financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (SNRF 9.5.5.14). Një pasuri financiare është e kreditit të zhvlerësuar kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të asaj pasurie financiare.

Kriteret e ndarjes në faza

Në çdo datë raportimi, banka do të vlerësojë nëse rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm nga data e njohjes fillestare (SNRF 9.5.5.9). Analiza e rrezikut kreditor është një analizë shumëfaktorëshe dhe holistike. Kjo do të thotë se vlerësimi bëhet duke përdorur të dhëna cilësore dhe sasore dhe nëse një faktor specifik është i rëndësishëm dhe pesha e tij në krahasim me faktorët e tjerë, do të varet nga lloji i produktit, karakteristikat e instrumenteve financiare dhe huamarrësit si dhe nga rajoni gjeografik. Mund të ndodhë gjithashtu që disa faktorë ose tregues të mos jenë të disponueshëm në nivel individual dhe për këtë arsye duhet të vlerësohen në baza kolektive. Në një rast të tillë, faktorët ose treguesit duhet të vlerësohen për portofoliet e përshtatshme, grupet e portofoliet ose pjesët e një portofoli instrumentesh financiare. Vlerësimi sasior duhet të bëhet duke shqyrtuar rrezikun që të ndodhë ndryshim në rrezikun e mospagesës gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar. Kur përcakton nëse kërkohet njohja e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë, banka duhet të marrë në konsideratë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme (SNRF 9.5.5.9).

Kjo do të thotë që banka nuk ka nevojë të ndërmarrë një kërkim shterues për informacion gjatë përcaktimit nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Banka, si një mjet praktik dhe për aq kohë sa ekzistojnë kushte të caktuara, ndryshimi i rrezikut të mospagesës për disa instrumente financiare ose grupe instrumentesh financiare mund të vlerësohet bazuar në humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Kjo është e mundur për instrumentet financiare për të cilat modelet e mospagesës nuk janë të përqendruara në një pikë specifike gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar.

Megjithatë, për disa instrumente financiare, ose në disa rrethana, përdorimi i ndryshimeve në rrezikun e mospagesës që ndodhin gjatë 12 muajve të ardhshëm mund të mos jetë i përshtatshëm. Këto rrethana do të ishin:

- Instrumenti financiar ka detyrime të rëndësishme pagese vetëm përtej 12 muajve të ardhshëm,
- Ndryshimet në faktorët përkatës makroekonomikë ose të tjerë të lidhur me kredinë ndodhin që nuk reflektohen në mënyrë adekuate në rrezikun që mospagesa të ndodhë në 12 muajt e ardhshëm, ose
- Ndryshimet në faktorët e lidhur me kredinë kanë një ndikim vetëm në rrezikun kreditor të instrumentit financiar (ose kanë një efekt më të theksuar përtej 12 muajve (SNRF 9.B5.5.14).

Duhet të theksohet se, me disa përjashtime që lidhen me mjetet praktike të përkruara më poshtë, vlerësimi për të vendosur nëse rreziku kreditor për një instrument financiar është rritur ndjeshëm duhet të bëhet mbi baza relative dhe jo absolute.

Kjo do të thotë se duke pasur parasysh një ndryshim në terma absolutë për një instrument financiar, ka më shumë gjasa të vlerësohet se ka rrezik kreditor i cili është rritur ndjeshëm, nëse rreziku fillestar i kredisë është i ulët në krahasim me nëse ai është i lartë. Një mundësi e tillë praktike është zgjedhja e opsionit të përjashtimit të rrezikut të ulët kreditor, i cili thotë se një njësi ekonomike mund të supozojë se rreziku kreditor për një letër me vlerë (por jo për një hua sipas udhëzimit të GRAECL) nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse letra me vlerë është përcaktuar se ka rrezik të ulët kreditor në datën e raportimit. Për letrat me vlerë me rrezik të ulët kreditor, banka do të njihje një provizion bazuar në humbjet e pritshme kreditore 12- mujore. Letrat me vlerë nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët kreditor kur ato konsiderohen se kanë një rrezik të ulët humbjeje thjesht për shkak të vlerës së kolateralit. Nga një këndvështrim teorik, rreziku i ulët kreditor përkufizohet rasti kur një letër me vlerë ka rrezik të ulët mospagese, huamarrësi ka një kapacitet të fortë për të përmbushur detyrimet e tij të flukseve monetare kontraktuale dhe kushtet e pafavorshme të ardhshme nuk do të zvogëlojnë domosdoshmërisht aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të flukseve monetare kontraktuale. Nga pikëpamja praktike, në bankë, kjo do të thotë se letrat me vlerë që konsiderohen të shkallës investive nuk ka nevojë të vlerësohen për të parë nëse rreziku kreditor për një letër me vlerë është rritur ndjeshëm. Këtu shkalla investive përcaktohet nga agjencitë e jashtme të vlerësimit/rejtingut si një vlerësim midis AAA-BBB (Standard's & Poor's, Fitch) dhe Aaa-Baa (Moody's).

Shkaktarët e fazës 2

Supozimet në lidhje me shkaktarët që kualifikohen për trajtim të fazës 2

Gjatë përcaktimit se cili horizont kohor duhet të përdoret për vlerësimin e rrezikut kreditor të rritur ndjeshëm, SNRF 9 BC5.174 thekson që [...] mos pasqyrimi i strukturës së afatit mund të rezultojë gjithashtu në vlerësimin se rreziku i një mospagese ka ndryshuar thjesht për shkak të kalimit të kohës.

Kjo mund të ndodhë edhe nëse banka do të kishte pritur një ndryshim të tillë në njohjen fillestare. Sipas mendimit të BSNK-së, vlerësimi i kriteve nuk duhet të ndryshojë vetëm sepse data e maturimit është më afër. Për më tepër, ndërsa rreziku që një mospagesë të ndodhë gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar zakonisht zvogëlohet me kalimin e kohës, kjo nuk është gjithmonë kështu. Për instrumentet financiare, që kanë vetëm detyrime të rëndësishme pagese afër afatit të maturimit të instrumentit financiar, rreziku i ndodhjes së mospagesës mund të mos ulet automatikisht me kalimin e kohës. Në një rast të tillë, banka duhet të marrë parasysh edhe faktorë të tjerë cilësorë që do të tregonin nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Rrija e ndjeshme e rrezikut kreditor për qëllim të lejimit/provizionit të fazës 2 perceptohet në termat e:

- Një masë sasiore, kur kjo mund të llogaritet,
- Një masë cilësore në raste të tjera, dhe
- Treguesit e "Backstop"

Shkaktarët cilësor dhe sasior jostatistikorë

Një numër faktorësh janë të rëndësishëm kur vlerësohet një rritje e ndjeshme e rrezikut kreditor, siç sugjeron lista jo shteruese në SNRF 9 B.5.5.16/17. Prandaj, faktorët cilësorë merren parasysh për të plotësuar vlerësimin e rritjes së rrezikut kreditor dhe gjithashtu në rastet kur ekzistojnë vetëm faktorë cilësorë ose faktorë sasiorë jostatistikorë, vlerësimi do të drejtohet vetëm nga këta faktorë.

Në vijim të kësaj, është e rëndësishme që banka të marrë në konsideratë informacionin e vëzhgueshëm të tregut në lidhje me rrezikun kreditor të instrumentit financiar të caktuar ose instrumenteve të ngjashme financiare. Ndërtimi i alarmeve ("flags") cilësore dhe sasiorë jostatistikore bazohet në listën e mëposhtme:

B5.5.16 "analiza holistike"

B5.5.17 a "treguesit e brendshëm të çmimeve"

B5.5.17.b "normat/kushtet"

B5.5.17.c "treguesit e tregut të jashtëm"

- B5.5.17.d "vlerësimi/rejtingu i jashtëm kreditor"
- B5.5.17.e "vlerësimi i brendshëm kreditor"
- B5.5.17.f "kushtet afariste/financiare/ekonomike"
- B5.5.17.g "rezultatet operative"
- B5.5.17.h "instrumente të tjera"
- B5.5.17.i "mjedisi i biznesit"
- B5.5.17.j "vlera e kolateralit"
- B5.5.17.k "cilësia e garancisë"
- B5.5.17.l "mbështetje nga njësia mëmë"
- B5.5.17.m "ndryshimet e kontratës"
- B5.5.17.n "performanca dhe sjellja"
- B5.5.17.o "qasja e menaxhimit të kredisë"
- B5.5.17.p "informacion i mbi vonesat"

Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që rreziku kreditor për një aset financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, më së voni kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë të vonuara. Supozimi mund të kundërshtohet nëse banka ka informata të arsyeshme dhe të mbështetura që demonstrojnë se rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare (SNRF 9.5.5.11). Prandaj mund të ndodhë që supozimi të jetë i kundërshtueshëm kur pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë në vonesë nëse:

- Mospagesa ishte një mbikëqyrje administrative,
- Banka ka qasje në evidencën historike që tregon se ekziston një korrelacion midis rritjeve të ndjeshme të rrezikut kreditor dhe një shume të ditëve në vonesë e cila është më e lartë se 30 ditë në vonesë (p.sh. 40 ditë në vonesë ose 50 ditë në vonesë etj.) (SNRF 9.B5.5.20).

Në rastet kur supozimi i kundërshtueshëm hidhet poshtë, duhet të theksohet se banka nuk mund të përafrojë kohën e rritjeve të ndjeshme të rrezikut kreditor dhe njohjen e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë me atë se kur një pasuri financiare konsiderohet si e kreditit të zhvlerësuar ose kur instrumenti financiar konsiderohet se ka mospagesë (SNRF 9.B5.5.21). Në rastet kur vonesa e 30 ditëve është hedhur poshtë, do të jetë e nevojshme të vendoset një kufi për një "back-stop" të ri i cili nuk do të jetë më i lartë se 90 ditë vonesë dhe të sigurohet dëshmi për këtë.

Vlerësimi i transferimit të fazave mbi baza kolektive

Mund të mos jetë e mundur të vlerësohet nëse ka pasur rritje të rrezikut kreditor mbi një bazë individuale dhe për këtë arsye ky vlerësim mund të kryhet gjithashtu mbi një bazë kolektive. Për shembull, ky mund të jetë rasti për kreditë retail, ku ka pak ose aspak informacion të përditësuar të rrezikut kreditor që merret dhe monitorohet në mënyrë rutine mbi një instrument individual, derisa një klient të shkelë kushtet e kontratës. Në raste të tilla, humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë do të njihen mbi një bazë kolektive që merr në konsideratë informatat gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor. Këto informata gjithëpërfshirëse të rrezikut kreditor duhet të përfshijnë jo vetëm informatat e vonesave, por edhe të gjitha informatat përkatëse të kredisë, përfshirë informatat makroekonomike për të ardhmen, në mënyrë që të përafrohet rezultati i njohjes së humbjeve të pritshme kreditore të jetëgjatësisë, kur ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare..

Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:

- Lloji i instrumentit,
- Vlerësimet e rrezikut kreditor,
- Lloji i kolateralit,
- Data e njohjes fillestare,
- Afati i mbetur deri në maturim,
- Industria,
- Vendndodhja gjeografike e huamarrësit, dhe

- Vlera e kolateralit në raport me pasurinë financiare nëse ka një ndikim në probabilitetin që të ndodhë një mospagesë (për shembull, kreditë pa rekurs në disa juridiksione ose raportet e kredisë ndaj vlerës) (SNRF 9.B5.5.5).

Shkaktarët e fazës 3

Sipas modelit të përkeqësimit, një instrument financiar duhet të transferohet në fazën 3 (pra, është me kredit të zhvlerësuar) kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë ndikim të dëmshëm në flukset e vlerësuar të ardhshme të parave të gatshme. Nëse kërkesat për transferimin e fazave nuk përmbushen më (pra, instrumenti nuk është më i kreditit të zhvlerësuar), ai do të transferohet përsëri në fazën 1 ose 2 (pra, qasja është simetrike). Lista e mëposhtme është marrë nga treguesit e "Kreditit të zhvlerësuar" sipas SNRF 9 Shtojca A:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huadhënësit ose huamarrësit,
- shkelje e kontratës, të tilla si ngjarje mospagese ose vonese,
- huadhënësi/t e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësinë financiare të huamarrësit, i ka dhënë huamarrësit një koncesion të cilin huadhënësi nuk do ta merrte parasysht në rastin e kundërt,
- po bëhet e mundur që huamarrësi do të hyjë në falimentim ose riorganizim tjetër financiar,
- zhdukja e një tregu aktiv për atë aset financiar për shkak të vështirësive financiare, ose
- blerja ose origjinimi i një asemi financiar me një zbritje të madhe që pasqyron humbjet e pësuarat kreditorë.

Për shkak të fushës së ndryshuar të SNRF 9, krahasuar me SNK 39, edhe zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare do të mbulohen nga i njëjti proces (zëvendësimi i vlerësimit të SNK 37). Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që mospagesa nuk ndodh më vonë sesa kur një aset financiar është 90 ditë në vonesë, përveç nëse banka ka informata të arsyeshme dhe të mbështetura për të demonstruar se një kriter më i vonuar i mospagesës është më i përshtatshëm. Përcaktimi i mospagesës së përdorur për këto qëllime do të zbatohet vazhdimisht për të gjithë instrumentet financiare përveç nëse ka informata të disponueshme që demonstrojnë se një përkufizim tjetër i mospagesës do të ishte më i përshtatshëm për një instrument të veçantë financiar. Për shkak të fushëveprimit të ndryshuar të SNRF 9 - Zhvlerësimi krahasuar me SNK 39, do të merren parasysht aspektet e mëposhtme.

Në bankë, përkufizimi i "kreditit të zhvlerësuar" është në përputhje me përkufizimin (rregullator - Neni 178 i CRR) i mospagesës, pasi përkufizimet e mospagesës dhe kreditit të zhvlerësuar janë të ngjashme dhe kjo është në përputhje me proceset aktuale të menaxhimit të rrezikut. Kjo do të thotë që të gjitha instrumentet në fushëveprimin e SNRF 9, kur pala tjetër është në mospagesë, do të transferohen në fazën 3. Për më tepër, kreditë e kolateralizuara plotësisht me provizion me rrezik zero, ku pala tjetër është në mospagesë, do t'i caktohen fazës 3 (nëse zbatohet 'modeli i përkeqësimit të kredisë'). Për shkak të nevojës për të llogaritur një ECL me probabilitet të ponderuar, provizionet me rrezik zero në fazën 3 priten vetëm në raste të rralla. Në fund, për shkak të periudhave rregullatorë të provës, mund të ketë situata ku provizioni i rrezikut është i ulët ose zero (pasi banka nuk ka pritshmëri për mospagesë ose pagesë të vonuar), por statusi i mospagesës është ende aktiv. Në raste të tilla, ekspozimi do të mbetet në fazën 3 për sa kohë që debitori është në mospagesë (in default).

Koncepti i përgjithshëm i modelit

Humbjet e pritshme kreditorë llogariten si shuma e humbjeve marxhinale që ndodhin në çdo periudhë kohore të datës së bilancit. Humbjet marxhinale rrjedhin nga parametra individuale që vlerësojnë ekspozimet dhe humbjet në rastin e mospagesës dhe probabilitetin marxhinal të mospagesës për çdo periudhë. Llogaritjet e humbjeve të pritshme kreditorë bazohen në katër komponentë:

- Probabiliteti i mospagesës ("PD") - Ky është një vlerësim i gjasave të mospagesës gjatë një horizonti të caktuar kohor.
- Ekspozimi në mospagesë ("EAD") - Ky është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme të mospagesës, duke marrë parasysht ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë shlyerjet e kryegjësë dhe interesit, dhe tërheqjet e pritshme në instrumentet e zotuar.
- Humbja në rast mospagese ("LGD") - Ky është një vlerësim i humbjes që lind nga mospagesa. Ai bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale të detyruara dhe atyre që huadhënësi do të prishte të merrte, duke përfshirë nga çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e EAD.
- Norma e skontimit - Kjo përdoret për të skontuar një humbje të pritshme në vlerën aktuale në datën e raportimit duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) në njohjen fillestare.

Banka do të masë humbjet e pritshme kreditorë të një instrumenti financiar në një mënyrë që pasqyron:

- Një shumë të paanshme dhe me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme,
- Vlerën në kohë të parasë, dhe
- Informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike (SNRF 9.5.5.17).

Gjatë matjes së humbjeve të pritshme kreditorë, banka nuk ka nevojë domosdoshmërisht të identifikojë çdo skenar të mundshëm.

Megjithatë, duhet të marrë në konsideratë rrezikun ose probabilitetin që të ndodhë një humbje kreditore duke reflektuar mundësinë që të ndodhë një humbje kreditore dhe mundësinë që të mos ndodhë asnjë humbje kreditore, edhe nëse mundësia për të ndodhur një humbje kreditore është shumë e ulët. Kjo do të thotë se sado i ulët të jetë probabiliteti i një humbjeje kreditore, ai kurrë nuk do të jetë zero për shkak të ponderimit të probabilitetit.

Qasja ndaj zërave në bilanc

Humbjet e pritshme kreditore janë një vlerësim me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditore (d.m.th. vlera aktuale e të gjitha mungesave të parasë së gatshme) gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar. Një mungesë e parasë së gatshme është diferenca midis flukseve monetare që i detyrohen bankës në përputhje me kontratën dhe flukseve monetare që banka pret të marrë. Për shkak se humbjet e pritshme kreditore marrin në konsideratë shumën dhe kohën e pagesave, një humbje kreditore lind edhe nëse banka pret të paguhet plotësisht, por më vonë se data e caktuar kontraktualisht (SNRF 9.B5.5.28). Qëllimi i vlerësimit të humbjeve të pritshme kreditore nuk është as vlerësimi i skenarit të rastit më të keq dhe as vlerësimi i skenarit më të mirë. Në vend të kësaj, një vlerësim i humbjeve të pritshme kreditore duhet të pasqyrojë gjithmonë mundësinë që të ndodhë një humbje kreditore dhe mundësinë që të mos ndodhë asnjë humbje kreditore edhe nëse rezultati më i mundshëm është se nuk ka humbje kreditore. Prandaj, për qëllime praktike, përdorimi i vlerësimeve me probabilitet të ponderuar të humbjeve kreditore nuk ka nevojë të marrë në konsideratë një numër të madh skenarësh. Megjithatë, humbjet e pritshme kreditore duhet të reflektojnë minimumi dy rezultate (SNRF 9.B5.5.41). Duhet të theksohet se humbjet e pritshme kreditore 12-mujore janë një pjesë e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë dhe përfaqësojnë mungesat e parasë së gatshme gjatë gjithë jetëgjatësisë që do të rezultojnë nëse ndodh një mospagesë në 12 muajt pas datës së raportimit (ose një periudhë më e shkurtër nëse jetëgjatësia e pritshme e një instrumenti financiar është më pak se 12 muajt), e ponderuar me probabilitetin që ajo mospagesë të ndodhë.

Për qëllime të matjes së humbjeve të pritshme kreditore, vlerësimi i mungesës së pritshme të parasë së gatshme duhet të pasqyrojë flukset monetare të pritshme nga kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kredisë që janë pjesë e kushteve kontraktuale dhe nuk njihen veçmas nga banka. Vlerësimi i mungesës së pritshme të parasë së gatshme në një instrument financiar të kolateralizuar pasqyron shumën dhe kohën e flukseve monetare që priten nga përvetësimi i kolateralit minus kostot e marrjes dhe shijes së kolateralit, pavarësisht nëse përvetësimi është i mundshëm (d.m.th. vlerësimi i flukseve monetare të pritshme merr parasysh probabilitetin e një përvetësimi dhe flukset monetare që do të rezultojnë prej tij). Për rrjedhojë, çdo fluks monetar që pritet nga realizimi i kolateralit përtej maturimit kontraktual të kontratës duhet të përfshihet në këtë analizë. Çdo kolateral i marrë si rezultat i përvetësimit nuk njihet si një pasuri që është e ndarë nga instrumenti financiar i kolateralizuar, përveçse kur plotëson kriteret e njohjes (SNRF 9.B5.5.55). Humbjet e pritshme kreditore do të skontojnë deri në datën e raportimit duke përdorur instrumentin e normës së ndryshueshme; humbjet e pritshme kreditore do të skontojnë duke përdorur normën aktuale efektive të interesit (SNRF 9.B5.5.44).

Qasja ndaj zërave jashtë bilancit

Për zotimet e kredive dhe kontratat e garancisë financiare, data kur banka bëhet palë e zotimit të pakthyesëm do të konsiderohet të jetë data e njohjes fillestare për qëllimet e zbatimit të kërkesave për rënie në vlerë. Për zotimet e kredive, banka shqyrton ndryshimet në rrezikun e mospagesës së një kredie me të cilën lidhet një zotim i kredisë. Për kontratat e garancisë financiare, banka shqyrton ndryshimet në rrezikun që debitori i specifikuar do të ketë mospagim në kontratë. Në të dy rastet për një aset financiar, humbja kreditore është vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen bankës sipas kontratës dhe flukseve monetare që njësia pret t'i marrë.

Në rastin e zotimeve të patërhequra (papaguara) të kredisë, humbja kreditore është vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen bankës nëse mbajtësi i zotimit të kredisë tërheq kredinë dhe flukseve monetare që njësia pret t'i marrë nëse kredia tërhiqet. Vlerësimi i Bankës për humbjet e pritshme kreditore për zotimet e kredive do të jetë në përputhje me pritshmëritë e saj për tërheqje të këtij zotimi të kredisë, pra, ajo do të marrë parasysh pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet brenda 12 muajve nga data e raportimit, kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditore 12 mujore dhe pjesën e pritshme të zotimit të kredisë që do të tërhiqet gjatë jetëgjatësisë të zotimit të kredisë kur vlerësohen humbjet e pritshme kreditore të jetëgjatësisë. Për një kontratë garancie financiare, njësisë i kërkohet të bëjë pagesa vetëm në rast të një mospagimi nga debitori, në përputhje me kushtet e instrumentit që është garantuar. Në përputhje me rrethanat, mungesat e parave të gatshme janë pagesat e pritshme për ta rimbursuar mbajtësin për një humbje kreditore që ai pëson, minus shumat që banka pret të marrë nga mbajtësi, debitori ose ndonjë palë tjetër. Nëse asetit është plotësisht i garantuar, vlerësimi i mungesave të parave të gatshme për një kontratë garancie financiare do të ishte në përputhje me vlerësimet e mungesave të parave të gatshme për asetin që i nënshtrohet garancisë.

Humbjet e pritshme kreditore për një zotim të kredisë do të zbriten duke përdorur normën efektive të interesit, ose një përaftrim të saj, që do të zbatohet kur njihet asetit financiar që rezulton nga zotimi i kredisë. Humbjet e pritshme kreditore për kontratat e garancisë financiare ose për zotimet e huasë për të cilat nuk mund të përcaktohet norma efektive e interesit do të zbriten duke aplikuar një normë skontimi që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet që janë specifike për flukset e parasë por vetëm nëse, dhe në masën që, rreziqet merren parasysh duke rregulluar normën e skontimit në vend që të rregullohen mungesat e parave të zbritura.

Informacioni parashikues

Një masë e humbjeve të pritshme kreditore është një shumë e paanshme e ponderuar në probabilitet, e cila përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme dhe duke përdorur informacion të arsyeshem dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale

dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike. Kur ekziston një marrëdhënie jolineare midis skenarëve të ndryshëm parashikues dhe humbjeve të tyre të lidhura kreditore, më shumë se një skenar parashikues do të duhet të përfshihet në matjen e humbjeve të pritshme kreditore për të përmbushur objektivin e mësipërm të miratuar:

Numri i skenarëve ekonomikë: modelohen skenarë përfaqësues që kapin jolinearitetet materiale (p.sh. një skenar bazë, një skenar pozitiv dhe një skenar negativ). Numra të ndryshëm skenarësh mund të jenë të përshatshëm në varësi të fakteve dhe rrethanave - p.sh. në periudha të rritjes së luhatshmërisë së pritit.

Përcaktimi i skenarëve ekonomikë alternativë: qoftë nëse banka prodhon vlerësimet e veta ekonomike të ardhshme ose përdor vlerësime të palëve të treta, ajo merr në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, përveç rastit kur efekti marginal i përdorimit të të dhënave shtesë do të ishte i parëndësishëm. Në disa ekonomi, të dhëna gjithëpërfshirëse do të jenë në dispozicion, por në territore të tjera mund të ketë më pak informacion.

Skenarët përfaqësues: Skenarët pozitivë dhe negativ të përdorur nuk janë të njëanshëm ndaj skenarëve ekstremë, në mënyrë që gama dhe peshimi i skenarëve të përdorur të mos jetë përfaqësues. Në veçanti, siç theksohet në GCRAECL të Komitetit të Bazelit, "skenarët e stresit të zhvilluar për qëllime mbikëqyrëse në mbarë industrinë nuk synohen të përdoren drejtpërdrejt për qëllime kontabël.

Skenari bazë: Skenari bazë është në përputhje me inputet përkatëse për vlerësimet e tjera në pasqyrat financiare (p.sh. rikuperimi i tatimit të shtyrë dhe vlerësimet e rënies në vlerë të emrit të mirë), buxhetet, planet strategjike dhe kapitale dhe informacione të tjera të përdorura në menaxhimin dhe raportimin nga banka. Megjithatë, këto inpute nuk duhet të jenë të vonuara ose të njëanshme. Edhe nëse inputet e përdorura janë në kohë dhe të paanshme, nëse buxheti i bankës zhvillohet në shtator, por kushtet makroekonomike kanë ndryshuar deri në fund të dhjetorit, ose nëse buxheti përmban optimizëm ose pesimizëm të qenësishëm, atëherë bëhen rregullimet e duhura për këto inpute kur përdoren për të përcaktuar skenarin bazë për qëllimet e llogaritjes së ECL në fund të vitit.

Ndjeshmëritë dhe asimetritë: skenarët e përzgjedhur janë përfaqësues dhe marrin parasysh shtytësit kryesorë të ECL, veçanërisht ndjeshmëritë jolineare dhe asimetrike brenda portofoleve. Për shembull, nëse banka ka ekspozime të rëndësishme të pronave dhe rrjedhimisht ndjeshmëri të konsiderueshme të ECL ndaj vlerave të ardhshme të pronës, atëherë modelohen ndryshime të ndryshme në çmimet e pronave. Ndjeshmëria e ECL ndaj secilit parametër individual të parashikuar ekonomik monitorohet për të identifikuar faktorët kryesorë dhe për të vlerësuar efektet e ndryshimeve në parametra të ECL. Koheranca e parametrevë: në zhvillimin e detajeve të një skenari specifik ekonomik (p.sh. një skenar me vlerësime individuale pikësh të BPV-së së ardhshme, papunësisë, normave të interesit, etj.), çdo korrelacion i pritshëm ose ndërlidhje tjetër ndërmjet parametrevë (p.sh. një rritje e papunësisë pritet të rezultojë në një ulje të normave të interesit) merret parasysh në zhvillimin e skenarit në mënyrë që të jetë realist. Granulariteti i rregullimeve: llogaritja e një rregullimi të modeluar të veçantë për të pasqyruar ndikimin e skenarëve më pak të mundshëm dhe ndikimet jolineare që rezultojnë, kryhet në një nivel të duhur të ulët të granularitetit, i cili merr parasysh karakteristikat dhe ndjeshmëritë cilësish të ndryshme të rrezikut.

Matja e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë në Fazën 1/2

Perspektiva parashikuese

Informacioni historik është një spirancë apo bazë e rëndësishme nga e cila mund të maten humbjet e pritshme kreditore. Megjithatë, banka do të rregullojë të dhënat historike, të tilla si përvoja e humbjeve kreditore, në bazë të të dhënave aktuale të vëzhgueshme për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale dhe parashikimet e saj për kushtet e ardhshme që nuk kanë ndikuar në periudhën në të cilën bazohen të dhënat historike, dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk janë të rëndësishme për flukset monetare të ardhshme kontraktuale. Në disa raste, informacioni më i mirë i arsyeshëm dhe i mbështetur mund të jetë informacioni historik i parregulluar, në varësi të natyrës së informacionit historik dhe kur është llogaritur, krahasuar me rrethanat në datën e raportimit dhe karakteristikat e instrumentit financiar që merret në konsideratë. Vlerësimet e ndryshimeve në humbjet e pritshme kreditore duhet të pasqyrojnë dhe të jenë në përputhje nga ana drejtimore me ndryshimet në të dhënat përkatëse të vëzhgueshme nga periudha në periudhë (siç janë ndryshimet në normat e papunësisë, çmimet e pronave, çmimet e mallrave, statusi i pagesës ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve kreditore në instrumentin financiar ose në grupin e instrumenteve financiare dhe të përmasave të këtyre ndryshimeve). Banka do të rishikojë rregullisht metodologjinë dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore për të reduktuar çdo diferencë midis vlerësimeve dhe përvojës faktike të humbjeve kreditore.

Nga banka nuk kërkohet të përfshijë parashikime të kushteve të ardhshme gjatë gjithë jetëgjatësisë së pritshme të një instrumenti financiar. Shkalla e gjykimit që kërkohet për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore varet nga disponueshmëria e informacionit të detajuar. Ndërsa horizonti i parashikimit rritet, disponueshmëria e informacionit të detajuar zvogëlohet dhe shkalla e gjykimit që kërkohet për të vlerësuar humbjet e pritshme kreditore rritet. Vlerësimi i humbjeve të pritshme kreditore nuk kërkon një vlerësim të detajuar për periudhat që janë në të ardhmen e largët për periudha të tilla, banka mund të ekstrapolojë parashikimet nga informacioni i disponueshëm dhe i detajuar.

Probabiliteti i Mospagesës (PD)

PD e përdorur për SNRF 9 duhet të pasqyrojë këndvështrimin aktual të menaxhmentit për të ardhmen dhe duhet të jetë i paanshëm (d.m.th. nuk duhet të përfshijë ndonjë konservatorizëm ose optimizëm). Ekzistojnë dy lloje të PD-ve që përdoren për llogaritjen e ECL-ve:

- PD 12-mujore – Ky është probabiliteti i vlerësuar që mospagesa të ndodhë brenda 12 muajve të ardhshëm (ose gjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit financiar nëse është më pak se 12 muaj). Kjo përdoret për të llogaritur ECL-të 12-mujore.
- PD-të gjatë gjithë jetëgjatësisë – Ky është probabiliteti i vlerësuar që një mospagesë të ndodhë gjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit financiar. Ky përdoret për të llogaritur ECL-të gjatë gjithë jetëgjatësisë për ekspozimet e 'fazës 2', ndërsa PD gjatë gjithë jetëgjatësisë për Fazën 3 është 100 përqind.

Rreziku që të ndodhë mospagesa në instrumentet financiare që kanë rrezik kreditor të krahasueshëm, është më i lartë sa më e gjatë të jetë jetëgjatësia e pritshme e instrumentit, për shembull, rreziku që të ndodhë një mospagim në një obligacion të vlerësuar me AAA me jetëgjatësi të pritshme prej 10 vjetësh është më i lartë se ai në një obligacion të vlerësuar me AAA me një jetëgjatësi të pritshme prej pesë vjetësh. Efekti i një përmirësimi në rrezikun kreditor të një aseti të maturuar duhet të merret parasysh për krahasimin e rrezikut kreditor në fillim dhe rrezikut aktual të kredisë.

Për produktet me histori të pamjaftueshme të mospagesës, mungesë të të dhënave ose në rast të produkteve të reja, opsioni i fundit është përdorimi i një standardi/pike referuese për PD 12-mujore. Standardet janë llogaritur nga Rreziku Retail i RBI duke përdorur vlerat mesatare të PD të llogarive me vlerësimet ekzistuese të PD. Llogaritja bazohet në të dhënat aktuale në dispozicion, duke përjashtuar llogaritë në mospagim dhe jo të vlerësuara dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet grupohen sipas produktit dhe rajonit gjeografik dhe rumbullakohen me një hap prej 50 bps. Ato do të rivlerësohen çdo vit dhe do të përditësohen nëse është e nevojshme. Standardet e vlefshme 12-mujore të PD janë aktualisht:

Segmenti	Lloji i produktit	
Retail - Individë	Kredi hipotekare	2.0%
	Kartat e kreditit	3.5%
	Mbitërheqjet	3.5%
	Kredi për makina	2.5%
	Produkte të tjera	5.0%
Retail - Mikro	Kartat e kreditit	6.5%

Për vlerësimin e PD-së përdoren fletënotimet e aplikimit, sjelljes dhe të transaksioneve. Poentimi në përgjithësi mund të përkufizohet si një teknikë statistikore për të parashikuar, në një moment të caktuar kohe me informacionin e disponueshëm, probabilitetin e një ngjarjeje të ardhshme (p.sh. mospagesë ose mospërmbushje detyrimi).

Modelet e fletënotimit (Scorecard (SC)) përfaqësojnë mjete statistikore të vlerësimit të rrezikut, të krijuara posaçërisht për ekspozimet retail. Humbjet e pritshme kreditorë llogariten duke faktorizuar vlerësimin (i cili përfaqëson probabilitetin e mospagesës), ekspozimin në mospagesë dhe humbjen në rast të mospagesës.

Tabela më poshtë paraqet notat e vlerësimit të retail të përdorura nga banka:

Nota e vlerësimit universal (URG)	Përshkrimi i URG-së	Gama e poenave të URG	Intervali teorik i PD-së (%)	PD teorike (% mesatarja gjeometrike e intervalit teorik të PD)
1.0	Pozitë e shkëlqyer kreditorë	740 < score (poenat) ≤ 780	0.17% ≤ score < 0.35%	0.24%
1.5	Vlerësim/rejting shumë i mirë kreditor	700 < score ≤ 740	0.35% ≤ score < 0.69%	0.49%
2.0	Vlerësim i mirë kreditor	660 < score ≤ 700	0.69% ≤ score < 1.37%	0.97%
2.5	Vlerësim i kënaqshëm kreditor	620 < score ≤ 660	1.37% ≤ score < 2.7%	1.92%
3.0A	Vlerësim i pranueshëm kreditor	600 < score ≤ 620	2.7% ≤ score < 3.78%	3.20%
3.0B		580 < score ≤ 600	3.78% ≤ score < 5.26%	4.46%
3.5A	Vlerësimi marginal kreditor	560 < score ≤ 580	5.26% ≤ score < 7.28%	6.19%
3.5B		540 < score ≤ 560	7.28% ≤ score < 10.0%	8.53%
4.0	Vlerësimi i dobët kreditor	500 < score ≤ 540	10.0% ≤ score < 18.18%	13.48%
4.5A	Vlerësim shumë i dobët kreditor	460 < score ≤ 500	18.18% ≤ score < 30.77%	23.56%
4.5B		< score ≤ 790	30.77% ≤ score < 100%	38.05%
5.0	Mospagesë	Mospagues (dështim në përmbushjen e detyrimit)		

Më poshtë janë informacionet e klasifikimit/rejtingut të brendshëm kreditor jo retail të bankës siç përdoren për qëllime të brendshme dhe të dhënat krahasuese përkatëse: five data:

Nota e Vlerësimit/rejtingut të brendshëm	Përshkrimi i vlerësimit të brendshëm	Periodha 12 mujore Basel II PD		Vlerësimi i S&P	
1A	Shkëlqyeshëm	>0.0000%	≤0.0026%	AAA	
1B		>0.0026%	≤0.0088%	AA+	
1C		>0.0088%	≤0.0300%	AA, AA-	
2A	Shumë mirë	>0.0300%	≤0.0408%	A+, A, A-	
2B		>0.0408%	≤0.0553%		
2C		>0.0553%	≤0.0751%		
3A		>0.0751%	≤0.1019%		
3B		>0.1019%	≤0.1383%		
3C	Mirë	>0.1383%	≤0.1878%	BBB+, BBB	
4A		>0.1878%	≤0.2548%	BBB-	
4B		>0.2548%	≤0.3459%		
4C		>0.3459%	≤0.4694%		
5A		>0.4694%	≤0.6371%		
5B		>0.6371%	≤0.8646%		
5C	Kënaqshëm	>0.8646%	≤1.1735%		BB
6A		>1.1735%	≤1.5927%	BB-	
6B		>1.5927%	≤2.1616%		
6C		>2.1616%	≤2.9338%		
7A	>2.9338%	≤3.9817%	B+		
7B	Nënstandard	>3.9817%	≤5.4040%	B	
7C		>5.4040%	≤7.3344%		
8A		>7.3344%	≤9.9543%		B-
8B		>9.9543%	≤13.5101%		
8C		>13.5101%	≤18.3360%		
9A	>18.3360%	≤24.8857%	CCC+		
9B	>24.8857%	≤33.7751%	CCC-		
9C	Kredit i zhvlerësuar	>33.7751%	<100%	CC, C	
10		100%	100%	D	

Humbja në rast Mospagese (LGD)

Një komponent kyç i metodës së shumës së humbjeve marxhinale është Humbja në rast Mospagese (LGD). Banka përdor një kombinim të PD dhe LGD për të llogaritur flukset monetare të pritshme nga projeksiioni i flukseve monetare kontraktuale. Vlerësimet e LGD duhet të marrin në konsideratë informacionin parashikues. Qasja e modelimit për LGD (por jo domosdoshmërisht vlerësimet faktike të LGD-së) në përgjithësi nuk ndryshon në varësi të fazës në cilën është ekspozimi, d.m.th. ekziston një metodologji e zakonshme LGD që zbatohet vazhdimisht. Metodologjia e modelimit për LGD është projektuar, aty ku është e përshtatshme, në një nivel komponenti, ku llogaritja e LGD ndahet në një seri shtytësish/drejtuesish.

Për ekspozimet e siguruara, qasja merr në konsideratë të paktën komponentët e mëposhtëm:

- Parashikimet e vlerësimeve të ardhshme të kolateralit, duke përfshirë skontimet e pritshme të shitjeve,
- Koha deri në realizimin e kolateralit (dhe rikuperimet e tjera),
- Shpërndarja e kolateralit nëpër ekspozime ku ka një numër ekspozimesh ndaj së njëjtës palë (kolateralizimi i tërthortë),
- Normat e kurimit (duke përfshirë marrjen parasysh të mënyrës sesi njësia i ka parë ri-mospagesat brenda llogaritjes së jetëgjatësisë), dhe
- Shpenzimet e jashtme të realizimit të kolateralit.

Për ekspozimet e pasiguara, qasja merr në konsideratë të paktën komponentët e mëposhtëm:

- Koha e rikuperimit,
- Normat e rikuperimit, dhe
- Normat e kurimit (duke përfshirë marrjen parasysh të mënyrës sesi njësia i ka parë ri-mospagesat brenda llogaritjes së jetëgjatësisë).

Vlerësimi i komponentëve merr në konsideratë gamën e shtytësve përkatës, duke përfshirë gjeografinë (vendndodhja e palës tjetër dhe kolaterali) dhe vjetërsinë e ekspozimit kreditor. Vlerësimi i LGD pasqyron ndryshimet e pritura në ekspozim (në përputhje me supozimet e përdorura në modelimin e EAD), në mënyrë që të mos jetë i njëanshëm (për shembull, një vlerësim konservativ mund të lindë nëse shumica e pritshme e ekspozimit bie me kalimin e kohës, por kjo nuk merret parasysh në vlerësimin e LGD). Njësia merr në konsideratë nëse vlerat e komponentëve varen nga faktorët makroekonomikë dhe pasqyron çdo varësi të tillë në modelimin e saj duke marrë parasysh informacionin e duhur parashikues. Në veçanti, për ekspozimet e siguruar kundrejt pasurive të paluajtshme, njësia merr parasysh ndërvarësinë ndërmjet çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe variablove makroekonomikë. Në mënyrë të ngjashme, njësia shqyrton nëse ka ndonjë korrelacion ose ndërvarësi midis komponentëve të LGD dhe më pas pasqyron atë korrelacion në vlerësimin e LGD. Historia e të dhënave që mbështet modelimin e LGD dhe komponentëve të saj mbulon një periudhë të përshtatshme për të mbështetur rëndësinë dhe besueshmërinë e modelimit (p.sh. gjatë një cikli të plotë ekonomik). Vlerësimi i vlerave të komponentëve brenda LGD pasqyron të dhënat historike në dispozicion dhe merr në konsideratë nëse ka pasur ose pritet të ketë ndonjë ndryshim në kushtet ekonomike, ose ndryshime në politikat ose procedurat e brendshme, që do të ndikonte në llogaritjen e LGD-së, por që nuk janë pasqyruar ndryshe në modelim. Qasja e LGD pasqyron skontimin e mungesës së parasë së gatshme duke marrë parasysh kohën e tyre të pritshme duke përdorur EIR.

Nëse vlerat rregulatore të LGD-së përdoren si pikënisje, atëherë rregullohet efekti i normave të ndryshme të skontimit, të qenësishme në vlerën rregulatore të LGD-së. Për më tepër, nëse vlerat rregulatore LGD të përdorura si pikënisje përmbajnë vlera të kufirit të poshtëm që do të çonin në një rezultat të njëanshëm, këto vlera hiqen për qëllimet e SNRF 9. LGD sipas SNRF 9 pasqyron vetëm përmirësimet kreditore që janë pjesë përbërëse e kushteve të ekspozimit dhe që nuk kontabilizohen veçmas. Nëse vlerat rregulatore të LGD-së përdoren si pikënisje dhe pasqyrojnë përmirësimet e kredisë që nuk duhet të përfshihen për qëllimet e SNRF 9 (p.sh. shkëmbimet (swaps) e mospagesave kreditore), atëherë ndikimi hiqet. Për produktet me histori të pamjaftueshme të mospagesës, mungesë të të dhënave ose në rast të produkteve të reja, do të përdoren standardet LGD. Standardet janë llogaritur nga Rreziku Retail i Raiffeisen Bank International duke përdorur vlerat mesatare të LGD-së të llogarive me vlerësimet ekzistuese të LGD-së. Llogaritja bazohet në të dhënat aktuale të disponueshme, duke përjashtuar llogaritë në mospagim dhe jo të vlerësuara dhe duke përdorur mesataret e thjeshta. Standardet grupohen sipas produktit dhe rajonit gjeografik dhe rumbullakohen me një hap prej 5pp. Ato do të rivlerësohen çdo vit dhe do të përditësohen nëse është e nevojshme. Standardet aktualisht të vlefshme të LGD në përdorim nga banka janë:

Segmenti	Lloji i produktit	
Retail - Individët	Kreditë hipotekare	30%
	Kartat e kreditit	50%
	Mbitërheqjet	50%
	Kredi për makina	50%
	Produkte të tjera	50%
Retail - Mikro	Kartat e kreditit	50%

Ekspozimi në Mospagesë (EAD)

Megjithëse IFRS 9 nuk kërkon në mënyrë eksplicite nga njësitë që të modelojnë EAD, të kuptuarit se si pritet të ndryshojnë ekspozimet kreditore me kalimin e kohës është thelbësore për një matje të paanshme të ECL-ve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kreditë e 'fazës 2', ku pika e mospagesës mund të jetë pas disa vitesh në të ardhmen. Injorimi i një rënijeje të pritshme të ekspozimit (p.sh. për një kredi të ripagueshme me këste) mund të çojë në atë që matjet e ECL-ve të jenë shumë të larta. Injorimi i një rritjeje të pritshme të ekspozimit (p.sh. tërheqjet brenda një limiti të rënë dakord për një produkt revolving) mund të çojë në atë që matjet e ECL-ve të jenë shumë të ulëta. Periudha maksimale gjatë së cilës do të maten humbjet e pritshme kreditore është periudha maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjatjes) gjatë së cilës njësitë është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor. Për zotimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare, kjo është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës një njësi ka një detyrim kontraktual aktual për të dhënë kredi. Megjithatë, disa instrumente financiare përfshijnë edhe komponentë të kreditit të patërhequr nuk e kufizon ekspozimin e njësisë ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Për shembull, produktet kreditore revolving, të tilla si kartelat e kreditit dhe mbitërheqjet, mund të tërhiqen kontraktualisht nga huadhënësi me një njoftim prej vetëm një ditë. Megjithatë, në praktikë huadhënësit vazhdojnë të japin kredi për një periudhë më të gjatë dhe mund ta tërheqin produktin vetëm pasi të rritet rreziku kreditor i huamarrësit, gjë që mund të jetë tepër vonë për të parandaluar disa ose të gjitha humbjet e pritshme kreditore.

Këto instrumente financiare në përgjithësi kanë karakteristikat e mëposhtme si rezultat i natyrës së instrumentit financiar, mënyrës në të cilën instrumentet financiare menaxhohen dhe natyrës së informacionit në dispozicion në lidhje me rritjet e konsiderueshme të rrezikut kreditor:

- Instrumentet financiare nuk kanë një afat ose strukturë fikse të ripagimit dhe zakonisht kanë një periudhë të shkurtër anulimi kontraktual (për shembull, një ditë).
- Aftësia kontraktuale për të anuluar kontratën nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm të instrumentit financiar dhe kontrata mund të anulohet vetëm kur njësi vihet në dijeni për një rritje të rrezikut kreditor në nivelin e produktit kreditor.
- Instrumentet financiare menaxhohen mbi baza kolektive.
- Gjatë përcaktimit të periudhës gjatë së cilës njësi pritet të ekspozohet ndaj rrezikut kreditor, por për të cilën humbjet e pritshme kreditore nuk do të zbuteshin nga veprimet normale të menaxhimit të rrezikut kreditor të njësisë, një njësi duhet të marrë parasysh faktorë të tillë si informacioni historik dhe përvoja rreth:
 - Periudha gjatë së cilës njësi ishte e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor për instrumente të ngjashme financiare,
 - Periudha kohore që mospagesat e lidhura të shfaqen në instrumente të ngjashme financiare pas një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut kreditor, dhe
 - Veprimet e menaxhimit të rrezikut kreditor që një njësi pret të ndërmarrë pasi rreziku kreditor për instrumentin financiar të jetë rritur, të tilla si reduktimi ose heqja e limiteve të patërhequra

Një njësi nuk ka nevojë të ndërmarrë një kërkim shterues për informacion, por duhet të marrë në konsideratë të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme dhe që është i rëndësishëm për vlerësimin e humbjeve të pritshme kreditore, duke përfshirë efektin e parapagimeve të pritshme. Informacioni i përdorur duhet të përfshijë faktorë që janë specifikë për huamarrësin, kushtet e përgjithshme ekonomike dhe një vlerësim si të drejtit aktual ashtu edhe atij të parashikuar të kushteve në datën e raportimit. Një njësi mund të përdorë burime të ndryshme të dhënash që mund të jenë të brendshme (specifike për njësinë) dhe të jashtme. Burimet e mundshme të të dhënave përfshijnë përvojën e brendshme të humbjeve kreditore historike, vlerësimet e brendshme, përvojën e humbjeve kreditore të subjekteve të tjera dhe vlerësimet e jashtme, raportet dhe statistikën. Subjektet ekonomike që nuk kanë fare ose nuk kanë burime të mjaftueshme të të dhënave specifike për njësinë mund të përdorin përvojën e grupeve simotra për instrumentin financiar të krahasueshëm (ose grupe instrumentesh financiare).

Qasja e modelimit për EAD pasqyron ndryshimet e pritshme në bilancin e papaguar gjatë gjithë jetëgjatësisë së ekspozimit kreditor, të cilat lejohen nga kushtet aktuale kontraktuale, duke përfshirë:

- Plani i kërkuar i ripagimit/shlyerjes,
- Shlyerja e plotë e parakohshme (p.sh. rifinancimi i hershëm),
- Mbpagesat mujore (d.m.th. pagesat në shuma më të larta se shumata e kërkuara të ripagimit, por jo për shumën e plotë të kredisë),
- Ndryshimet në përdorimin e një zotimi të patërhequr brenda limiteve të rëna dakord të kredisë përpara mospagesës,
- Veprimet për zbutjen e kredisë të ndërmarra përpara mospagesës.

Njësi përdor një model të flukseve monetare për të llogaritur ekspozimin e vlerësuar në çdo fund muaji të ardhshëm. Ky model është në përputhje me çdo model të ngjashëm të përdorur për qëllime të EIR ose mbrojtëse makro të vlerës së drejtë. Ky model i fluksit monetar pasqyron më tej lëvizjet në EAD në muajt përpara mospagesës. Inputet në modelin EAD rishikohen për të vlerësuar përshtatshmërinë e tyre për SNRF 9 dhe rregullohen, aty ku kërkohet, për të siguruar një llogaritje të ECL të paanshme, të ponderuar me probabilitet që reflekton pritshmëritë aktuale dhe informacionin parashikues. Modelet e EAD janë të diferencuara për të pasqyruar karakteristikat e ndryshme të rrezikut të portofoleve të ndryshme. Njësi i merr parasysh këta shtytës të ndryshëm themelorë në përcaktimin e inputeve të ndryshme në modelet e EAD.

Norma e skontimit

ECL-të maten në një mënyrë që pasqyron vlerën në kohë të parasë. Kjo do të thotë se mungesat e parasë së gatshme që lidhen me mospagesën kërkohet të skontohen deri në datën e bilancit të gjendjes. Për një aset financiar, një njësi përdor normën efektive të interesit (EIR) (d.m.th., e njëjta normë e përdorur për të njohur të ardhurat nga interesi) ose një përaftrim. Efekti i skontimit mund të jetë i rëndësishëm sepse ngjarjet e mospagesës dhe/ose mungesat e lidhura të parasë mund të ndodhin në një kohë të largët në të ardhmen. Vlera në kohë e parasë duhet të merret parasysh gjatë llogaritjes së humbjeve të pritshme kreditore. Fluksat e parasë do të skontohen deri në datën e raportimit. Përveç përjashtimeve të përmendura më poshtë, fluksat monetare që priten të merren skontohen duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) të përcaktuar me njohjen fillestare të një instrumenti në bilanc ose një përaftrim të saj.

Matja e humbjeve të pritshme kreditore gjatë gjithë jetëgjatësisë në Fazën 3

Për një aset financiar që është i kreditit të zhvlerësuar në datën e raportimit, por që nuk është një aset financiar i blerë ose i origjinës i kreditit të zhvlerësuar, banka do të masë humbjet e pritshme kreditore si diferenca midis vlerës kontabël bruto të asetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare efektive të interesit të asetit financiar. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga rënia në vlerë. Për asetet e kolateralizuara, vlerësimi përfshin gjithashtu fluksat

monetare nga përveçsëmi/realizimi i kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së kolateralit, pavarësisht nëse është i mundshëm realizimi. Të gjitha kërkesat e matjes vlejné edhe për letrat me vlerë të borxhit. Gjatë përcaktimit të mospagesës për qëllime të përcaktimit të rrezikut të mospagesës, banka duhet të zbatojë një përkufizim të mospagesës që është në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime të menaxhimit të rrezikut të brendshëm të kredisë për instrumentin financiar përkatës dhe të marrë parasysh treguesit cilësorë (për shembull, marrëveshjet financiare) kur është e përshtatshme. Megjithatë, ekziston një supozim i kundërshtueshëm që mospagesa nuk ndodh më vonë se kur një aset financiar është 90 ditë me vonesë, përveç nëse një njësi ka informacion të arsyeshëm dhe të mbështetur për të demonstruar se një kriter më i vonuar i mospagesës është më i përshtatshëm. Përkufizimi i mospagesës të përdorur për këto qëllime do të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha instrumentet financiare, përveç rastit kur bëhet i disponueshëm informacioni që tregon se një përkufizim tjetër i mospagesës është më i përshtatshëm për një instrument financiar të caktuar. Vlera kontabël bruto mund të përfshijë principalin e papaguar (duke përfshirë çdo shumë të vonuar), interesin e përlogaritur, tarifrat dhe kostot e paamortizuara, fitimet ose humbjet e modifikuara të paamortizuara, ndryshimet e paamortizuara në pritjet e fluksit monetar, rregullimet e mbrojtjes së vlerës së drejtë të paamortizuara si dhe diferencat fillestare të paamortizuara ndërmjet vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit (shtyrë sipas SNRF 9.B5.1.2A (b)).

Gjatë përcaktimit të ECL-së gjatë gjithë jetëgjatësisë për ekspozimet e fazës 3, zbatohen të njëjtat kërkesa si për ekspozimet e fazës 2. Kjo do të thotë se ECL gjatë jetëgjatësisë së mbetur të një instrumenti financiar do të matet në një mënyrë që pasqyron një shumë të paanshme dhe të ponderuar me probabilitet që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, vlerën në kohë të parasë dhe informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur në lidhje me ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura të ngjarjeve të ardhshme (që janë të disponueshme në datën e raportimit pa kosto ose përpjekje të panevojshme). Supozimet dhe inputet duhet të përputhen në të gjitha fazat e modelit të rënies në vlerë (zhvlerësimi), kjo është veçanërisht e rëndësishme për informacionin parashikues siç janë variablat makro.

Ponderimi i probabilitetit

Humbjet e pritshme kreditore duhet të pasqyrojnë një shumë me probabilitet të ponderuar që përcaktohet duke ponderuar një sërë rezultatesh të mundshme. Të gjithë skenarët përkatës (në vend të vetëm skenarit më të mundshëm) do të merren parasysh. Skenarët që kanë shumë pak gjasa të ndodhin nuk do të merren parasysh kur vlerësohet ECL. Edhe nëse vetëm një strategji rishtrukturimi/riprogramimi (workout) është realiste, zakonisht do të jetë e përshtatshme dhe e nevojshme të merren parasysh të paktën dy vlerësime të ndryshme të flukseve monetare. Për pasuritë me rrezik, siç është borxhi i papaguar, flukset faktike monetare mund të jenë shumë të ndryshme nga pritshmëritë. Metoda e preferuar për llogaritjen e flukseve monetare të pritshme në raste të tilla është përdorimi i skenarëve më të mirë dhe skenarëve më të keq. Skenari më i realizueshëm më i mirë nuk do të jetë skenari i cili maksimizon të gjitha inputet, por ai që merr parasysh marrëdhënien midis inputeve në një mënyrë realiste. Skenari më i keq duhet gjithashtu të marrë parasysh marrëdhënien midis inputeve në një mënyrë reale. Duhet gjithashtu të theksohet se sa më me rrezik të jenë flukset monetare, aq i madh duhet të jetë gama e flukseve monetare. Strategjitë e rishtrukturimit duhet të pasqyrohen në vlerësimin e flukseve monetare. Skenarët e tillë të rishtrukturimit mund të jenë për shembull:

- Kurimi (rikuperim i plotë, shlyerje e plotë dhe kalimi në jo-mospagesë);
- Rishtrukturimi (ripagimi i flukseve monetare të rinegociuara);
- Likuidimi i kolateralit (skenari i mos vijmësisë);
- Transferimi i pasurisë përmes shitjes;
- Një kombinim i sa më sipër.

Shuma dhe koha e flukseve monetare për skenarë të veçantë duhet të përcaktohet dhe një probabilitet duhet t'i përshkruhet çdo vlerësimi të flukseve monetare. Shuma e flukseve monetare me probabilitet të ponderuar për secilin skenar përkatës do të skontohej më pas deri në datën e raportimit. Zgjedhja e skenarit, peshimi dhe raporti i flukseve monetare të skenarit më të keq/skenarit më të mirë duhet të bazohet në përvojën historike.

Informacioni parashikues

Nevoja për të inkuorporuar informacion parashikues do të thotë se aplikimi i standardit do të kërkojë gjykim të konsiderueshëm, në veçanti, se si ndryshimet në faktorët makroekonomikë do të ndikojnë në provizionet.

Kolaterali

Flukset e vlerësuarat monetare që merren parasysh do të përfshijnë flukset monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose për mirësim të tjera të kredisë që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale, d.m.th. që janë pjesë e kushteve kontraktuale (edhe nëse jo në mënyrë eksplicite) dhe nuk njihen veçmas (për të shmangur numërimin e dyfishtë).

Zërat jashtë bilancit

Për një kontratë garancie financiare, humbja e pritshme përcaktohet bazuar në pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin për një humbje kredie, minus çdo shumë që banka pret të marrë nga mbajtësi, debitori ose ndonjë palë tjetër. Megjithatë, të ardhurat e ardhshme të primit që duhet të paguhet nga mbajtësi nuk duhet të merren parasysh në matjen e humbjes së pritshme nga pasuria që i nënshtrohet garancisë. Kjo është për shkak se flukset monetare sipas garancisë varen nga rreziku i dështimit (mospagesës) të pasurisë financiare të garantuar, ndërsa primet që do të merren i nënshtrohen rrezikut të mospagesës nga mbajtësi i garancisë. Për zotimet e kredisë, banka do të marrë parasysh edhe tërheqjen e pritshme individuale. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë më e lartë se 1, pasi ECL nuk duhet të njihet për asnjë ekspozim ku nuk ka detyrim kontraktual.

Norma e skontimit

Vlera në kohë e parasë duhet të merret parasysht gjatë llogaritjes së humbjeve të pritshme kreditore. Flukset e parasë do të skontohehen deri në datën e raportimit. Përveç përjashtimeve të përmendura, flukset monetare që priten të merren skontohehen duke përdorur normën efektive të interesit (EIR) të përcaktuar në njohjen fillestare të instrumentit në bilanc ose një përaftrim të saj. Nëse një instrument financiar ka një normë interesi të ndryshueshme, ECL duhet të skontohet duke përdorur EIR-në aktuale (d.m.th. EIR fillestare e rregulluar për rivendosjen e vlerës së elementit të ndryshueshëm në datën e tij më të fundit të riçimitit). Nëse instrumenti është ose është përcaktuar si zë i mbrojtur në një marrëdhënie mbrojtëse me vlerën e drejtë, çdo rishikim sipas SNRF 9.6.5.10 do të konsiderohet gjithashtu. Për të arkëtueshmet e qirasë, norma e skontimit e përdorur në matjen e këtyre të arkëtueshmeve të qirasë është në përputhje me SNRF 16. Nëse një instrument financiar ishte i zhvlerësuar krediti në njohjen fillestare (POCI), ECL-të duhet të skontohen duke përdorur një normë interesi efektive të kreditit të rregulluar. Për zotimet e kredive, EIR e ardhshme e përcaktuar për t'u aplikuar për pasurinë që do të njihet fillimisht në datën e pritshme të përdorimit të parë të ardhshëm të zotimeve, pasi pasuria financiare që njihet pas një tërheqjeje në një zotim kredie trajtohet si vazhdim i atij zotimi dhe jo si një instrument i ri financiar. Për garancitë financiare, norma e skontimit duhet të pasqyrojë vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet që janë specifike për flukset monetare, por vetëm nëse, dhe në masën që, rreziqet merren parasysht duke rregulluar normën e skontimit në vend të rregullimit të mungesës së parasë së gatshme që po skontohet.

3.3.13 Kategoria e koston së amortizuar

Aseti financiar do të matet me koston e amortizuar nëse është brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e asetëve për të mbledhur/arkëtuar flukset monetare kontraktuale dhe flukset monetare kontraktuale të asetit financiar janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit në shumën e papaguar të principalit. Në njohjen fillestare, pasuritë financiare dhe detyrimet financiare maten me vlerën e drejtë plus kostot e pranueshme të transaksionit. Nëse ka një diferencë midis vlerësimit të vlerës së drejtë të njësisë ekonomike në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit, atëherë:

- nëse vlerësimi i vlerës së drejtë përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme, atëherë diferenca njihet në fitim ose humbje; ose,
- në të gjitha rastet e tjera, diferenca shtyhet si një rregullim i vlerës kontabël të instrumentit financiar, i cili amortizohet nëpërmjet PL gjatë jetëgjatësisë së instrumentit financiar.

Portofoli i kredive dhe paradhënieve të bankës mbarten me koston të amortizuar dhe të ardhurat nga interesi njihen në fitim dhe humbje duke përdorur normën efektive të interesit.

3.3.14 Kategoria “vlera e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse” (FVOCI)

Pasuria financiare klasifikohet si i matur me FVOCI nëse mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare dhe plotëson kriterin e pagesave vetëm të principalit dhe interesit (SPPI).

3.3.15 Kategoria “vlera e drejtë përmes fitimit ose humbjes” (FVTPL)

Të gjitha pasuritë e tjera financiare – d.m.th., pasuritë financiare që nuk plotësojnë kriteret për klasifikim si të matura më pas me koston e amortizuar ose FVOCI - klasifikohen si të matura më pas me vlerën e drejtë, ku ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje.

Përveç kësaj, Banka ka opsionin që në njohjen fillestare të caktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasuri financiare si me FVTPL, nëse kjo eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje matjeje ose njohjeje – pra, një ‘mospërputhje kontabël’ - që përdryshe do të lindte nga matja e pasurive ose detyrimeve, ose njohja e fitimeve dhe humbjeve mbi to, mbi bazë të ndryshme.

Në njohjen fillestare, pasuritë financiare të klasifikuara si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të maten me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare, pasuritë financiare të klasifikuara si me vlerë të drejtë do të maten me vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje.

3.3.16 Instrumentet financiare derivative

Derivatet njihen fillimisht me vlerën e drejtë në datën në të cilën është lidhur një kontratë derivative dhe më pas maten me vlerën e tyre të drejtë. Vlerat e drejta përftohen nga çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive, duke përfshirë transaksionet e fundit të tregut dhe teknikat e vlerësimit, duke përfshirë modelet e flukseve monetare të skontuara sipas rastiit. Të gjithë derivatet mbarten si asete kur vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime kur vlera e drejtë është negative. Fitimet dhe humbjet që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve përfshihen në ‘Të ardhurat neto nga instrumentet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes’ në fitimin ose humbjen për periudhën.

Banka përdor instrumente financiare derivative të tilla si këmbimet e normave të interesit jashtë bursës (OTC) për të menaxhuar rrezikun e saj që rrjedh nga luhatjet e normave të interesit të tregut. Për instrumentet derivative nuk aplikohet kontabiliteti mbrojtës.

3.3.17 Paraaja dhe ekuivalentet e parasë dhe rezervat e detyrueshme

Paraaja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë kartëmonedhat dhe monedhat në dorë (duke përfshirë rezervat e kufizuara - shih më poshtë), bilancet e pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe pasuritë financiare shumë likuide me maturime fillestare prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimit në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e zotimeve të saj afatshkurtra.

Paraaja dhe ekuivalentet e parasë mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.4 Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet e rëndësishme kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare të Bankës kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e raportuar të të ardhurave, shpenzimeve, pasurive dhe detyrimeve, dhe shpalesjet shoqëruese, si dhe shpalesjen e detyrimeve kontingjente. Pasiguria në lidhje me këto supozime dhe vlerësime mund të rezultojë në rezultate që kërkojnë një rregullim material të vlerës kontabël të pasurive ose detyrimeve të prekura në periudhat e ardhshme. Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Bankës, menaxhmenti ka bërë gjykimet dhe supozimet e mëposhtme në lidhje me të ardhmen dhe burimet e tjera kryesore të sigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar.

Rrethanat ekzistuese dhe supozimet për zhvillimet e ardhshme mund të ndryshojnë për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Bankës dhe pasqyrohen në supozimet nëse dhe kur ato ndodhin. Zërat me efektin më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare të veçanta me gjykim dhe/ose vlerësime të konsiderueshme të menaxhmentit janë renditur më poshtë në lidhje me gjykimet/vlerësimet e përfshira.

Si rezultat i pandemisë COVID-19, e cila preku ekonominë dhe tregjet financiare, menaxhmenti i Bankës kreu një vlerësim shtesë të përshtatshmërisë së politikave kontabël, vlerësimeve dhe supozimeve të përdorura gjatë vitit 2021 dhe ndikimin e tyre në rënieën e mundshme në vlerë të pasurive dhe pozicionit financiar, flukseve të mëtejshme monetare dhe rezultati të operacioneve të Bankës. Vlerësimet e kryera nuk tregojnë ekzistencën e një ndikimi materialisht të rëndësishëm në përshtatshmërinë e politikave kontabël, vlerësimet dhe supozimet, as ekzistencën e indikacioneve për rënie në vlerë të pasurive të Bankës.

Situata në Ukrainë - ndikimi

Lufta në vazhdim e sipër në Ukrainë dhe sanksionet e lidhura me të, të synuara kundër Federatës Ruse, mund të kenë ndikim në ekonominë evropiane dhe globalisht. Njësia ekonomike nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë kundrejt Ukrainës, Rusisë ose Bjellorusisë. Megjithatë, ndikimi në situatën e përgjithshme ekonomike mund të kërkojë rishikime të supozimeve dhe vlerësimeve të caktuara. Kjo mund të çojë në rregullime materiale të vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve të caktuara, duke përfshirë kreditë për klientët, kreditë për bankat, investimet në letrat me vlerë të borxhit, detyrimet ndaj klientëve dhe huamarrjet, brenda vitit të ardhshëm financiar. Në këtë fazë, menaxhmenti nuk është në gjendje të vlerësojë me besueshmëri ndikimin pasi ngjarjet janë në zhvillim e sipër dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ndikojë gjithashtu në vëllimet e tregtimit, flukset monetare dhe profitabilitetin. Megjithatë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Kompania vazhdon të përbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë bazën e vijmësisë në përgatitjen e tyre.

Gjykime të rëndësishme kontabël dhe kontabiliteti përshkruhen në shënimet e mëposhtme:

- 3.3.12 Rënia në vlerë e pasurive financiare,
- 3.3.16 Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive financiare,
- 3.3.17 Kostoja e amortizuar dhe kategoria,
- 3.3.18 Kategoria FVOCI,
- 3.3.19 Kategoria FVTPL,
- 3.8 Pasuria e riposeduar

3.5 Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përbushë kërkesat e likuiditetit mesatar minimal ditor. Kërkesa për likuiditet llogaritet në baza javore si 10 për qind e bazës së depozitave, e përcaktuar si mesatarja e detyrimeve totale të depozitave ndaj publikut jobankar në euro dhe valuta të tjera, gjatë ditëve të punës të periudhës së mbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e saj për likuiditet janë depozitat në euro në BQK dhe 50 për qind e ekuivalentit në euro të parave të gatshme të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat në BQK nuk duhet të jenë më pak se 5 për qind e bazës së aplikueshme të depozitave. Meqenëse pasuritë likuide përkatëse nuk janë të disponueshme për të financuar operacionet e përditshme të Bankës, ato janë përjashtuar nga paraaja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

3.6 Prona dhe pajisjet

3.6.1 Prona dhe pajisjet në pronësi

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurive ose njihen si pasuri e veçantë, sipas rastiit, vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme të lidhura me zërin do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen shpenzimeve të tjera operative gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Vlerat kontabël të pronës dhe pajisjeve rishikohen për rënie në vlerë kur ngjarjet ndryshojnë ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ka indikacione të tilla dhe ku vlerat kontabël tejkalojnë shumën e parashikuar të rikuperueshme, asetet ose njësitë gjeneruese të parasë (CGU) shlyhen deri në vlerën e tyre të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e pronës dhe pajisjeve është vlera e drejtë minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim, cilado që është më e lartë. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut të vlerës kohore të parasë dhe rreziqeve specifike për ato asete.

Për një aset që nuk gjeneron flukse monetare kryesisht të pavarura, shumën e rikuperueshme përcaktohet për njësitë gjeneruese të parave (CGU) të cilave i përket asetit. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje.

Zhvlërësimi i aseteve njihet si shpenzim në bazë të metodës lineare në normat e përcaktuara për të alokuar koston e pronës dhe pajisjeve mbi jetëgjatësinë e tyre të përdorimit. Normat vjetore të zhvlërësimit përcaktohen nga jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar e aseteve të caktuara sipas tabelës më poshtë:

Përmirësimet e pronës me qira zhvlërësohen përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit ose afatit të qirasë, cilado që është më e shkurtër. Puna në proces nuk zhvlërësohet derisa asetet të vihet në përdorim.

ATM, pajisje të tjera bankare dhe për zyre	5-10 vjet
Hardueri kompjuterik	4-8 vjet
Ndërtesat e përdorura për qëllime vetanake	50 vjet

Metodat e zhvlërësimit, jetëgjatësia e dobishme dhe vlerat e mbetura rivlerësohen në çdo datë raportimi.

3.6.2 Prona dhe pajisjet me qira

Banka njeh pasurinë me të drejtë përdorimi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose përpara datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen pasurisë bazë ose për të rivendosur pasurinë bazë ose lokacionin në të cilin është vendosur, minus çdo stimul të marrë të qirasë. Pasuria me të drejtën e përdorimit zhvlërësohet më pas duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fundin e jetëgjatësisë së dobishme të pasurive me të drejtë përdorimi ose në fund të afatit të qirasë, cilado që është më herët.

Jetëgjatësia e vlerësuar e dobishme e pasurive me të drejtën e përdorimit përcaktohet në bazë të kushteve të qirasë. Pasuritë e së drejtës së përdorimit zhvlërësohen gjatë periudhës së afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së dobishme të pasurive me të drejtën e përdorimit, cilado që është më e shkurtër. Nëse një qira transferon pronësinë e pasurisë bazë ose kostoja e pasurive të së drejtës së përdorimit reflekton se njësitë ekonomike pret të ushtrojë një opsion blerjeje, pasuria e lidhur me të drejtën e përdorimit zhvlërësohet gjatë jetëgjatësisë së dobishme të pasurisë bazë. Përveç kësaj, pasuria me të drejtën e përdorimit reduktohet periodikisht nga humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka, dhe rregullohet për rimatjet e caktuara të detyrimit të qirasë.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë sa vijon:

- pagesat fikse, duke përfshirë pagesat fikse në substancë,
- pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që priten të jenë të pagueshme sipas një garancie të vlerës së mbetur, dhe
- çmimi i ushtrimit sipas një opsioni blerjeje që Banka është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do ta ushtrojë, pagesat e qirasë në një periudhë rinovimi opsionale nëse Banka është në mënyrë të arsyeshme e sigurt se do të ushtrojë një opsion zgjatjeje, dhe penalitetet për ndërprerjen e parakohshme të një qiraje, përveç rasteve kur Banka është e sigurt në mënyrë të arsyeshme që nuk do ta ndërprejë parakohshëm.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhen në datën e fillimit, të skontuar duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, normën inkrementale (rritëse) të huamarrjes të Bankës. Në përgjithësi, Banka përdor normën e saj inkrementale të huamarrjes si normë skontimi. Rimatet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rrjedhin nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në

vlerësimin e Bankës për shumën që pritet të jetë e pagueshme sipas një garancie të vlerës së mbetur, ose nëse Banka ndryshon vlerësimin e saj se a do të ushtrojë një opsion blerjeje, vazhdimi ose ndërprerjeje. Kur detyrimi i qirasë rimatet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të pasurisë të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e pasurisë të së drejtës së përdorimit është reduktuar në zero.

Banka paraqet pasuritë me të drejtën e përdorimit që nuk plotësojnë përkufizimin e pronës investive në "prona, impiantet dhe pajisjet" dhe detyrimet e qirasë në "detyrime të tjera" në pasqyrën e pozicionit financiar (shënimi 17).

Në fillimin e një kontrate, Banka vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohore në këmbim të një shume. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar, Banka vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një pasurie të identifikuar – kjo mund të specifikohet në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar dhe duhet të jetë fizikisht e dallueshme ose të përfaqësojë në thelb të gjithë kapacitetin e një pasurie fizikisht të dallueshme. Nëse furnizuesi ka një të drejtë substanciale zëvendësimi, atëherë pasuria nuk identifikohet,
- Banka ka të drejtën të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i pasurive gjatë gjithë periudhës së përdorimit, dhe
- Banka ka të drejtën të drejtojë përdorimin e pasurisë. Banka e ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për ndryshimin e mënyrës se si dhe për çfarë qëllimi përdoret pasuria. Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi përdoret pasuria është i paracaktuar, Banka ka të drejtë të drejtojë përdorimin e pasurisë qoftë nëse:
- Banka ka të drejtën të operojë pasurinë, ose
- Banka e ka projektuar pasurinë në një mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura ose të ndryshuara në ose pas datës 1 janar 2019. Në fillimin ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Banka shpërndan shumën në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimeve të tyre relative të pavarura.

Megjithatë, për qiratë e tokës dhe ndërtesave në të cilat është qiramarrëse, Banka ka zgjedhur të mos ndajë komponentët jo qira dhe të llogarisë komponentët e qirasë dhe ato jo qira si një komponent i vetëm i qirasë. Banka zgjodhi të përdorte përjashtimet e njohjes në qiratë afatshkurtra, si dhe qiratë me vlerë të ulët.

- Një qira afatshkurtër përkufizohet si një qira që ka një afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak,
- Një prag prej 5,000 €, qiratë me vlerë të ulët nën prag.

Çdo kriter zbatohet individualisht, që do të thotë se nuk ka kufizime në kualifikimin e qirasë afatshkurtër bazuar në vlerën e qirasë dhe anasjelltas. Zgjedhjet do të bëhen sipas klasës. Banka vendosi të përdorë këtë përjashtim për të gjitha klasat e pasurive. Çdo modifikim i mëposhëm i qirasë afatshkurtër do të konsiderohet si qira e re dhe kriteret do të rivlerësohen.

3.6.3 Prona e rimarrë në posedim

Pasuritë e rimarra në posedim fitohen nëpërmjet ekzekutimit të garancisë mbi kreditë joperformuese dhe paradhëniet për klientët që nuk fitojnë të ardhura qiraje dhe nuk përdoren nga Banka dhe janë të destinuara për shitje (nxjerrje jashtë përdorimit) në një periudhë të arsyeshme kohore.

Pasuritë e rimarra në posedim njihen fillimisht duke përdorur vlerën e caktuar nga përmbartuesi në ankandin e fundit dhe më pas maten me vlerën e kostos ose vlerën neto të realizueshme, cilado që është më e ulët, dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje. Pasuritë e riposeduara njihen si inventarë dhe paraqiten në inventarin e mallrave dhe llogarinë pezull për shërbimet e kryera ende të pa paraqitura si shpenzim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe si shpenzime nga aktivitetet jo-bankare në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Në rastin e shitjes, të ardhurat njihen dhe vlera kontabël e pasurive njihet si shpenzim.

Vlera neto e realizueshme vlerësohet një herë në vit dhe çdo zhvlerësim/rikthim njihet si shpenzim/të ardhura në periudhën që ka ndodhur.

3.7 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme njihen nëse ka të ngjarë që përfitimet ekonomike të ardhshme që i atribuohen pasurisë do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e pasurisë mund të matet me besueshmëri. Pasuritë e paprekshme maten fillimisht me kosto. Vlerat kontabël të pasurive të paprekshme rishikohen për rënie në vlerë kur ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Pasuritë e paprekshme përbëhen tërësisht nga softuer kompjuterik i cili amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të vlerësuar prej pesë vjetësh dhe licencat të cilat amortizohen gjatë afatit të licencës.

3.8 Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura

Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura janë pjesë e burimeve të financimit të borxhit të Bankës. Depozitat, huazimet dhe detyrimet e varura njihen fillimisht me vlerën e drejtë, minus kostot e transaksionit të shkaktuara. Më pas paraqiten me kosto të amortizuar; çdo diferencë ndërmjet të ardhurave minus kostot e transaksionit dhe vlerës së kthimit njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.9 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të mëparshme, Banka ka një detyrim të tanishëm ligjor ose të krijuar që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të duhen të harxhohen mjete monetare për të mbuluar detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të pritshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parasë dhe risqet specifike ndaj detyrimit. Korrigjimi i skontimit njihet si kosto financiare.

Detyrimet kontingjente mund të zhvillohen në një mënyrë që nuk është pritur fillimisht. Prandaj ato vlerësohen vazhdimisht për të përcaktuar nëse dalja e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është bërë e mundshme. Në rast se detyrimi kontingjent rezulton në një detyrim aktual që mund të matet me besueshmëri, duhet të regjistrohet në bilanc provizioni për shumën. Vetëm zotimet e pakthyeshme shkaktojnë risk kreditor, pra vetëm kontingjentat dhe zotimet e pakthyeshme mund të jenë objekt i provizionimit. Për ekspozimet e mëdha, vlerësimi bëhet në mënyrë individuale. Në rast të vlerësimit të bazuar në portfolio, ndërtimi i portfolios dhe llogaritja e provizioneve të bazuara në portfolio llogariten siç tregohet në rënie në vlerë të kredive dhe paradhënieve.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet për planin pensional të administruar publikisht në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihet si shpenzim i përfitimeve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

3.11 Kapitali aksionar

Dividendët në aksionet e zakonshme

Dividendët në aksionet e zakonshme njihen në ekuitet në periudhën në të cilën janë aprovuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit shpalesen si ngjarje pas fundit të periudhës së raportimit.

3.12 Rezervat e ekuitetit

Rezervat e ekuitetit përbëhen nga rezervat e vlerës së drejtë dhe fitimet e pashpërndara. Rezervat e regjistruara në OCI brenda ekuitetit në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës përfshijnë:

- Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të pasurive financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
- Fitimet e mbajtura përfshijnë fitimet kumulative jo të shpërndara dhe shpërndahen me miratimin e Aksionarit të Përgjithshëm të Bankës dhe miratimin rregullator të Bankës Qendrore.

3.13 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare me interes njihen përmes fitimit ose humbjes për periudhën brenda 'të ardhurave nga interesi' dhe 'shpenzimeve nga interesi' duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma efektive e interesit është norma që skonton saktësisht pagesat ose arkëtimet e ardhshme të parave të gatshme gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtër në vlerën kontabël neto të pasurive ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por nuk merr parasysh humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit dhe tarifat dhe pikët e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një pasurie ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në fitim ose humbje përfshijnë:

- interesin në pasuritë financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar të llogaritur në bazë të interesit efektiv, dhe
- interesin në letrat me vlerë të investimeve të matura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes (FVPL) të llogaritur në bazë të interesit efektiv.

Kur një pasuri financiare bëhet e kreditit të zhvlerësuar (e rënë në vlerë) dhe për këtë arsye konsiderohet si 'Faza 3', Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar neto të pasurisë financiare. Nëse pasuritë financiare trajtohen dhe nuk janë më të kreditit të zhvlerësuar, Banka kthehet në llogaritjen e të ardhurave nga interesi në baza bruto. Për pasuritë financiare të blera ose të origjinuara të kreditit të zhvlerësuar (POCI) Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur normën efektive të interesit të kreditit të rregulluar dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e kreditit të rregulluar është norma e interesit që, në njohjen fillestare, zvogëlon rrjedhën monetare të ardhshme të vlerësuar (duke përfshirë humbjet kreditore) në koston e amortizuar të pasurive të POCI. Banka mban gjithashtu investime në pasuritë e emetuara në vende me norma interesi negative. Banka shpallës interesin e paguar për këto pasuri si një shpenzim interesi, me shpallje shtesë në Shënimin 21.

Të ardhurat nga interesi në të gjitha pasuritë tregtuese dhe pasuritë financiare të detyrueshme për t'u matur me FVPL, njihen duke përdorur normën e interesit kontraktual në të ardhurat neto të tregtueshme dhe fitimet / (humbjet) neto të pasurive financiare me vlerë të drejtë në fitim ose humbje.

3.14 Tarifa dhe komisioni

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri financiare ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Nëse një zotim kredie nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, atëherë tarifa përkatëse e zotimit të kredisë njihet në bazë lineare gjatë periudhës së zotimit. Të ardhurat e tjera nga tarifat dhe komisionet – duke përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, komisionin e shitjeve, tarifat e kartave dhe ATM-ve, tarifat e mbledhjes së pagesave, njihen kur shërbimet përkatëse kryhen, përkatësisht me kalimin e kohës kur shërbimet ofrohen dhe/ose në një moment kohor kur ndodh transaksioni (tarifat e bazuara në transaksion). Më shumë informacion rreth detyrimeve të performancës së Bankës jepet në shënimin 23. Një kontratë me një klient që rezulton në një instrument financiar të njohur në pasqyrat financiare të Bankës mund të jetë pjesërisht në objektin e SNRF 9 dhe pjesërisht në objektin e SNRF 15. Nëse kjo është kështu, atëherë Banka së pari zbaton SNRF 9 për të ndarë dhe matur pjesën e kontratës që është në objektin e SNRF 9 dhe zbaton SNRF 15 për komponentin e mbetur. Shpenzimet të tjera për komisionet dhe tarifat lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat paraqiten si shpenzim në momentin që pranohen shërbimet.

3.15 Të ardhurat neto nga instrumentet e tjera financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes

Të ardhurat neto nga instrumentet tjera financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes ndërliken me instrumentet derivative jo të tregtueshëm të mbajtur për qëllime të menaxhimit të risikut që nuk përbëjnë pjesë të raporteve kualifikuese mbrojtëse të pasurive dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në vlerë të drejtë përmes fitimit apo humbjes. Përfshinë të gjitha ndryshimet e realizuara dhe përealizuara të vlerës së drejtë, interesin, dividendat dhe ndryshimet në këmbimin valutor.

3.16 Tatimi në të ardhura

Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat përfshijnë tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Njihet në fitim ose humbje, përveç në masën që lidhet me zërat e njohur drejtpërdrejt në kapitalin neto ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin e pritshëm të pagueshëm ose të arkëtueshëm mbi të ardhurat ose humbjet e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Ato maten duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë është tatimi që pritet të paguhet ose rikuperohet mbi diferencat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës tatimore përkatëse të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve.

Detyrimet tatimore të shtyra përgjithësisht njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në masën që ka të ngjarë që fitimet e tatueshme të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Këto aktive dhe detyrime nuk njihen nëse diferenca e përkohshme lind nga njohja fillestare (përveç një kombinimi biznesi) të pasurive dhe detyrimeve të tjera në një transaksion që nuk ndikon as në fitimin e tatueshëm dhe as në fitimin kontabël. Vlera kontabël e pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në masën që nuk është më e mundshme që fitime të mjaftueshme të tatueshme do të jenë të disponueshme për të lejuar rikuperimin e të gjithë ose një pjese të pasurive. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet, ose pasuria është realizuar në bazë të ligjeve tatimore dhe normave që janë miratuar ose në thelb të miratuara në datën e raportimit.

4. Menaxhimi i riskut financiar

4.1 Përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga shfrytëzimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operativ

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit nga risqet më lartë, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Korniza e menaxhimit të riskut

Kontrollet e brendshme dhe mjete tjera të kontrollit të riskut të vendosura nga menaxhimi i riskut i Raiffeisen International mundësojnë menaxhimin e kontrolluar të riskut të Bankës. Mjetet kryesore të menaxhimit të riskut janë miratuar nga Raiffeisen International dhe zbatohen për përdorim nga Banka.

Banka ka qenë në përputhje dhe ka raportuar bazuar në kërkesat e Basel II në nivel të Grupit duke mbuluar rreziqet e kreditit dhe të tregut. Zbatimi i kërkesave të Basel II duhet të sigurojë një menaxhim më të mirë të kapitalit.

Bazuar në politikat e Bankës, totali i pasurive të Bankës klasifikohet dhe analizohet si më poshtë:

- Analiza e pasurive bazuar në klasën e pasurisë/produktit (pasuritë klasifikohen në bazë të Katalogut të Produkteve të Grupit),
- Analiza e pasurive bazuar në cilësinë e kredisë (pasuritë klasifikohen në bazë të Direktivave të Grupit),
- Analiza e pasurive në përputhje me bazën e matjes.
- Analiza e pasurive në bazë të moshës, që nënkupton analiza të kryera për pasuritë që janë në vonesë, por jo të zhvlerësuar (rëna në vlerë),
- Analiza individuale e pasurive të përcaktuara si të zhvlerësuar nga faktorët e zhvlerësimit,
- Analiza e pasurive bazuar në llojin e kolateralit dhe duke marrë parasysh shumën e vlerësuar të rikuperueshme.

Analiza e pasurive bazuar në përqendrimin e rreziqeve për industrinë / sektorin / segmentin / shumën e caktuar të ekspozimit.

4.2 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare për Bankën nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe shfaqet kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e bankës për klientët dhe bankat e tjera dhe investimet në letrat me vlerë. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka i merr në konsiderim të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (si risku i mospagesës i obliguesit individual, risku i vendit dhe sektorit).

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut kreditor që është risku që pala tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë shumat e plota në kohën e duhur. Banka i strukturon nivelet e riskut kreditor që i merr përsipër duke vendosur limite në sasinë e riskut të pranuar në lidhje me një huamarrës dhe segment gjeografik apo industrial. Risqet e tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen rishikimit mujor ose më të shpeshtë. Limitet në nivelin e riskut kreditor nga huamarrësi aprovohen nga Menaxhment.

Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e pagesës së interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet, pjesërisht, me marrjen e kolateralit dhe garancive të korporatave dhe atyre personale.

Ekspozimi maksimal i Bankës ndaj riskut kreditor pasqyrohet kryesisht në vlerat kontabël të pasurive financiare në pasqyrën e pozicionit financiar. Ndikimi i kompensimit reciprok (netimit) të mundshëm të pasurive dhe detyrimeve për të zvogëluar ekspozimin e mundshëm kreditor nuk është i rëndësishëm.

Risku kreditor për instrumentet financiare jashtë bilancore përcaktohet si mundësia e mbajtjes së humbjes si rezultat i asaj që një palë tjetër në një instrument financiar nuk arrin të veprojë në përputhje me kushtet e kontratës. Banka përdor politikat e njëjta kreditore kur bën detyrimet e kushtëzuara ashtu siç bën për instrumentet financiare të bilancit nëpërmjet aprovimit të kredive të përcaktuara, limiteve të kontrollit të riskut dhe procedurave të monitorimit.

Banka mban lloje të ndryshme të kolateralit si siguri për riskun kreditor. Përveç kësaj, zbatohen metoda të tjera për përmirësimin kreditor. Llojet kryesore të kolateralit janë të cekura më poshtë:

- Prona (tokë, ndërtesa)
- Apartamentet
- Automjetet
- Pajisjet
- Garancione personale

Vlera e kolateralit llogaritet sipas metodave të specifikuar të cilat përfshijnë formula të standardizuara të llogaritjes bazuar në vlerat e tregut, zbritjet e paracaktuara dhe vlerësimet e ekspertëve.

Vlerësimi dhe rivlerësimi i kolateralit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e specialisteve të bankës, për të gjitha llojet e kolateralit. Vlerësimi i pasurive të patundshme përditësohet një herë në vit. Ky rivlerësim vjetor realizohet nga specialistët e brendshëm të kolateralit. Nëse përditësimi i rivlerësimit nuk bëhet çdo 18 muaj, atëherë vlera e peshuar e kolateralit (WCV) e hipotekës zbritet 10 për qind për secilin vit që nuk përmban rivlerësim kolateral. Monitorim më i shpeshtë është i nevojshëm, kur tregu i pasurive të patundshme është subjekt i ndryshimeve të rëndësishme në rrethana.

Kreditë e rëna në vlerë dhe letrat me vlerë

Kreditë e rëna në vlerë dhe letrat me vlerë janë kredi dhe letra me vlerë për të cilat Banka konstaton se ka:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose huamarrësit,
- një shkelje e kontratës, të tilla si një mospagesë ose një ngjarje e vonuar,
- huadhënësi(ët) e huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që lidhen me vështirësitë financiare të huamarrësit, duke i dhënë huamarrësit një koncesion(a) që huadhënësi(t) nuk do ta konsideronin ndryshe,
- po bëhet e mundur që huamarrësi të hyjë në falimentim ose në një riorganizim tjetër financiar,
- zhdukja e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare, ose

ECL-të maten në një mënyrë që pasqyron vlerën në kohë të parasë. Kjo do të thotë se mungesat e parave të gatshme që lidhen me mospagimin kërkohet të skontohe deri në datën e bilancit. Për pasuritë e Fazës 3, ECL-të skontohe duke përdorur EIR origjinale, ndërsa për pasuritë POCl, ECL-të zbriten duke përdorur CAEIR.

Kreditë me kushte të rinegociuara

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kreditë që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime që në të kundërt nuk do t'i merre në konsideratë. Pasi kredia të ristrukturohet, ajo mbetet në këtë kategori derisa të vërehet performanca e qëndrueshme. Performanca e qëndrueshme përkufizohet si tre pagesa kontraktuale të njëpasnjëshme të principalit dhe/ose interesit.

Humbjet e pritshme kreditore-ECL

Banka vendos lejime dhe provizione për humbjet e pritshme kreditore që përfaqëson vlerësimin e saj të humbjeve të pritshme në portofolin e saj të kredive/letrave me vlerë dhe atë jashtë bilancit.

Politika e shlyerjes/fshirjes

Pasuritë financiare fshihen pjesërisht ose në tërësi vetëm kur Banka ka ndaluar së ndjekuri rikuperimin.

Kriteret e mëposhtme janë të zbatueshme për ekspozimet retail:

- kur pasuria klasifikohet si joperformuese dhe pasuria nuk është e siguruar me kolateral, pasuria shlyhet brenda 18 muajve,
- kur pasuria klasifikohet si joperformuese dhe pasuria është e siguruar me kolateral të lënë peng, pasuria shlyhet brenda 36 muajve,
- kur pasuria klasifikohet si joperformuese dhe pasuria është e siguruar me hipotekë, pasuria shlyhet brenda 60 muajve.

Kriteret e mëposhtme janë të zbatueshme për ekspozimet joretail:

- kur llogaritja e LLP-së bëhet me qasjen e mosvijmësisë dhe pasuria provizionohet 100 për qind,
- kur ka mungesë të flukseve monetare të ardhshme të pritshme nga operacionet,
- kur vlera e drejtë minus kostot e shitjes së një kolateralit ende ekzistues të përdorur në llogaritjen e rënies në vlerë është zero ose nuk ka më kolateral.

Nëse shumat për t'u shlyer është më e madhe se lejimi për humbje të akumuluar, diferenca trajtohet fillimisht si një korigjim i drejtpërdrejtë në pasqyrën e fitimit dhe humbjes. Çdo rikuperim i mëvonshëm kreditohet në shpenzimet e humbjeve nga kreditë.

Përmbledhje e kredive të riprogramuara/modifikuara

Tabelat në vijim paraqesin një përmbledhje të pasurive të modifikuara të Bankës më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

31 dhjetor 2021	Vlera bartëse bruto	Faza 2			Faza 3				Raporti i kredive të modifikuara
		Modifikime të përkohshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Modifikime të përkohshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Permanent modifications Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e modifikuara	
Detyrim nga bankat	23,860	-	-	-	-	-	-	-	0%
Kredi dhe paradhënie për klientët									
Klientët korporata (joretail)	339,864	51,925	3,944	2,785	1,390	5,149	5,980	8,765	2.58%
Klientët individual (retail)	464,842	94,845	6,138	5,899	7,396	2,168	2,296	8,195	1.76%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	804,706	146,770	10,082	8,684	8,786	7,317	8,276	16,960	4.34%

31 dhjetor 2020	Vlera bartëse bruto	Faza 2			Faza 3				Raporti i kredive të modifikuara
		Modifikime të përkohshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Modifikime të përkohshme për T&Cs për shkak të COVID 19	Permanent modifications Modifikime të përhershme për T & Cs	Gjithsej kreditë joperformuese të riprogramuara	Gjithsej kreditë e modifikuara	
Detyrime nga bankat	14,337	-	-	-	-	-	-	-	0%
Kredi dhe paradhënie për klientët									
Klientët korporata	324,994	103,714	3,354	-	3,320	2,195	4,542	4,542	1.40%
Klientët individual	408,487	172,086	4,603	3,548	5,537	2,044	2,147	5,695	1.39%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	733,481	275,800	7,957	3,548	8,857	4,239	6,689	10,237	1.39%

31 dhjetor 2021	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Faza 2	Faza 3	Gjithsej	Faza 2 Kolektive	Faza 3 Kolektive	Gjithsej
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kredi dhe paradhënie për klientët						
Klientët korporata	2,785	-	2,785	206	-	206
Klientët individual	5,756	2,936	8,692	784	1,292	2,076
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	8,541	2,936	11,477	990	1,292	2,282

31 dhjetor 2020	Shuma bruto e kredive të modifikuara			Humbjet e pritshme të kredive të modifikuara		
	Stage 2	Stage 3	Total	Stage 2 Collective	Stage 3 Collective	Total
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kredi dhe paradhënie për klientët						
Klientët korporata	3,214	3,068	6,282	205	-	205
Klientët individual	3,548	2,147	5,695	357	1,944	2,301
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	6,762	5,215	11,977	562	1,944	2,506

Kredi dhe paradhëniet për klientët

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor para përmirësimeve të kolateralit dhe përmirësimeve tjera kreditore më 31 dhjetor 2021 të aseteve financiare sipas sektorit të palës tjetër.

	Ekspozimi ndaj riskut kreditor	
	2021	2020
Banka Qendrore e Kosovës	81,320	81,228
Bankat e tjera	42,429	42,154
Investimet në filiale	2,234	2,234
Sovranët	160,000	134,121
Korporatat ndërkombëtare	14,099	42,789
Korporatat lokale	339,864	324,994
Klientët lokalë individual (retail)	464,842	408,487
Gjithsej ekspozimi ndaj rrezikut të pasurive financiare	1,104,788	1,036,007

Tabelat e mëposhtme paraqesin informacion në lidhje me cilësinë kreditore të kredive dhe paradhënieve për klientët dhe lejjimin për rënien në vlerë/humbjet të mbajtura nga Banka kundrejt këtyre pasurive.

	Kreditë dhe paradhëniet për klientët	
	2021	2020
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor		
Shuma bruto	804,706	733,481
Lejimi për rënie në vlerë	(26,457)	(23,966)
Vlera kontabël neto	778,249	709,515
Kredi me kushte të rinegociuara		
Vlera kontabël bruto	172,956	289,679
Lejimi për rënie në vlerë	(14,966)	(14,163)
Vlera kontabël neto	157,990	(275,516)

Më poshtë është një analizë e kolateralit dhe përmirësimeve të kredisë të marra gjatë viteve:

31 dhjetor 2021	Kreditë dhe paradhëniet për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Corporate	Total	Retail	Corporate	Total
Pasuri të patundshme komerciale	607	6,448	7,055	513	6,448	6,961
Pasuri të patundshme rezidenciale	52,624	-	52,624	49,668	-	49,668
Pasuri të patundshme rezidenciale	330,930	319,306	650,236	190,237	299,947	490,184
Të pasiguruara	80,681	14,110	94,791	-	-	0
Gjithsej	464,842	339,864	804,706	240,418	306,395	546,813

31 dhjetor 2020	Kredi dhe paradhënie për klientët			Vlera e drejtë e kolateralit		
	Retail	Corporate	Total	Retail	Corporate	Total
Pasuri të patundshme komerciale	604	10,375	10,979	447	5,822	6,269
Pasuri të patundshme rezidenciale	47,385	-	47,385	40,693	-	40,693
Pasuri të patundshme rezidenciale	359,719	314,619	674,338	175,873	294,732	470,605
Të pasiguruara	779	-	779	-	-	-
Gjithsej	408,487	324,994	733,481	217,013	300,554	517,567

Më poshtë është një analizë e pasurive financiare të matura me koston e amortizuar. Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike, për pasuritë financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerën kontabël bruto:

31 dhjetor 2021					
	Gjithsej vlera kontabël bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët korporata (Joretail)	339,864	255,809	74,010	10,045	240,418
Klientët individualë (retail)	464,842	427,757	21,872	15,213	306,395
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	804,706	683,566	95,882	25,258	546,813
31 dhjetor 2020					
	Gjithsej vlera kontabël bruto	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Vlera e drejtë e kolateralit
Klientët korporata (Joretail)	324,994	249,807	65,714	9,473	300,554
Klientët individualë (retail)	408,487	333,249	61,688	13,550	217,013
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët	733,481	583,056	127,402	23,023	517,567

Një analizë e përqendrimeve të rrezikut kreditor më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 për kreditë dhe paradhëniet për klientët në vonesë dhe të rëna në vlerë - Faza 3 dhe POCL janë paraqitur më poshtë:

31 dhjetor 2021					
	Demand and less than 1 month	From 1 to 3 months	From 3 to 12 months	More than 12 month	Total
Klientët joretail	2,864	80	653	4,700	8,297
Klientët retail	1,633	318	1,681	14,528	18,160
Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët, të rëna në vlerë	4,497	398	2,334	19,228	26,457
31 dhjetor 2020					
	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Klientët joretail	3,856	250	875	4,492	9,473
Klientët retail	940	140	1,021	11,449	13,550
Gjithsej kredi dhe paradhënie për klientët, të rëna në vlerë	4,796	390	1,896	15,941	23,023

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut kreditor sipas sektorëve. Përqendrimet e rrezikut të sektorit ekonomik brenda portofolit të kredive konsumatorë janë si më poshtë:

	2021	%	2020	%
Tregtia	151,227	19%	153,083	21%
Individët	557,094	69%	485,641	66%
Prodhimi, kimike dhe përpunuese	68,256	8%	62,867	9%
Shërbimet	12,845	2%	13,479	2%
Ndërtim dhe shërbime ndërtimi	5,187	1%	5,774	1%
Industria ushqimore dhe bujqësia	9,543	1%	12,054	2%
Të tjera	554	0%	583	0%
Gjithsej kreditë dhe paradhëniet për klientët para lejimeve për rënie në vlerë të kredive	804,706	100%	733,481	100%

Detyrime nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga menaxhimi i rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat dhe transaksionet e tjera bankare në bankat solide vendore ose ndërkombëtare. Para se të fillohet një marrëdhënie biznesi me një bankë të caktuar, menaxhmenti dhe Departamenti i Riskut kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve kontraktuese monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korresponduese si dhe emetuesit e bonove në të cilat Banka ka ekspozime investimi monitorohen vazhdimisht për vlerësimet e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Moody's, Standard & Poor's (S&P) dhe Fitch përveç ekspozimeve me bonot e thesarit të Kosovës të cilat nuk janë vlerësuar. Për të përfaqësuar vlerësimet e agjencive të ndryshme ndërkombëtare të vlerësimit, tabelat më poshtë janë përgatitur në përputhje me shkallët e vlerësimit të Bankës Qendrore të Kosovës të paraqitura si më poshtë:

Moody' ose ekuivalent		
Përkufizimet e vlerësimeve	Shkalla e vlerësimit afatgjatë	Shkalla e vlerësimit afatshkurtër
Cilësi e lartë e kredisë	Aaa Aa1 Aa2 Aa3	P-1
Kapacitet i fortë pagese	A1 A2 A3	P-2
Kapacitet adekuat pagese	Baa1 Baa2 Baa3	P-3

Një funksion i pavarur nga departamenti i thesarit, zakonisht menaxhimi i rrezikut, duhet të monitorojë që ekspozimi ndaj të gjitha bankave nuk i kalon limitet rregullatore ose kufijtë e brendshëm të përcaktuar nga menaxhmenti i Bankës. Në pajtim me rregulloren e re për ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ndonjë ekspozim të përgjithshëm të riskut kreditor ndaj palëve të ndërlidhura që tejkalon 15 për qind të kapitalit rregullator të nivelit të parë. Detyrimet nga bankat janë dhënë pa kolateral. Tabela e mëposhtme paraqet llogaritë rrjedhëse të Bankës dhe depozitat me afat me bankat korresponduese sipas vlerësimit (klasifikimit) kreditor, të cilat janë klasifikuar si Faza 1.

Më 31 dhjetor	2021	2020
P-1	32,476	19,528
P-2	9,953	18,351
P-3	-	4,275
	42,429	42,154

Investimet në letra me vlerë

Investimet në letrat me vlerë kryesisht janë në bono qeveritare me vendet e OECD, bonot e thesarit të Republikës së Kosovës dhe bono të korporatave. Investimet janë kryesisht për menaxhimin e likuiditetit të bankës dhe sigurojnë diversifikim të mjaftueshëm të riskut në drejtim të ekspozimit kreditor me një sovran duke marrë në konsideratë edhe mjedisin rregullator lokal dhe kufizimin e ekspozimeve të mëdha. Tabela e mëposhtme paraqet ekspozimin ndaj letrave me vlerë bazuar në vlerësimin e Moody's:

	2021	2020
P-1	115,755	115,217
P-2	9,576	36,759
P-3	-	-
E pavlerësuar	48,703	24,783
	174,034	176,759

Ekspozimi i raportuar si i pavlerësuar pasqyron ekspozimin e bankës ndaj Republikës së Kosovës. Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj riskut bazuar në riskun e palës së kundërt të ekspozimit.

	2021	2020
Obligacionet dhe Bonot e Thesarit të Qeverisë së Kosovës	48,703	24,783
Bono të tjera të thesarit dhe obligacione qeveritare të OECD-së	111,233	123,781
Bono të korporatave	14,098	28,195
Gjithsej investimi në letra me vlerë	174,034	176,759

4.3 Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet e saj financiare. Banka është e ekspozuar ndaj thirrjeve ditore për burimet e saj të parave të disponueshme nga llogaritë rrjedhëse, depozitat e maturuara, tërheqjet e kredive dhe garancitë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës.

Banka zotëron aktive afatmesme deri në afatgjata dhe për shkak të kushteve të tregut, financon pjesën më të madhe të portofolit të saj me borxh afatshkurtër. Në këtë proces Banka merr rrezikun e likuiditetit që lidhet me mospërputhjet e maturitetit. Banka lëshon aktive afatgjata, si kredi PI dhe kredi hipotekare, dhe këto portofole financonen kryesisht nga depozita pa afat dhe depozita me afat deri në 1 vit. Menaxhmenti merr në baza ditore informacionin e raportit të likuiditetit të Bankës, dhe gjithashtu në baza javore merr një raport të likuiditetit të renditur sipas segmentit të biznesit. Duke qenë se Banka emeton aktive afatmesme deri në afatgjata dhe e financon atë me borxh afatshkurtër dhe afatmesëm, ajo është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Rezerva e likuiditetit rregullativ llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare të detyrimeve brenda një viti, e cila rezervë mbahet nga depozitat në bankën qendrore dhe 50 për qind e parasë fizike. Më 31 dhjetor 2021, teprica e rezervës së likuiditetit është 16,160 mijë € (2020: 24,588 mijë €).

Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 sipas maturimit të mbetur kontraktual të tyre.

Sidoqoftë, banka pret që shumë klientë nuk do të kërkojnë ripagesën e depozitave në datën më të hershme që mund të kërkohej të paguhen dhe tabela nuk pasqyron flukset e parave të gatshme të pritura të treguara nga historia e vet e mbajtjes së depozitave. Për më tepër, Banka po përdor aktin e deleguar të BE-së LCR për menaxhimin e likuiditetit dhe kërkohej të mbajë likuiditet nga 10 përqind në 10.9 përqind për depozitat e pasiguruara retail dhe përqindje për depozitat e siguruara. Për joretail planifikohet një dalje prej 33 për qind deri në 85 për qind, bazuar në atë nëse llogaria është operacionale apo jo. LCR i BE-së duhet të jetë mbi 100 përqind. Më 31 dhjetor 2021, banka ishte shumë mbi këtë limit në mbi 500 për qind.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Asetet					
Paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	175,289	-	-	-	175,289
Detyrime nga bankat	19,391	-	-	-	19,391
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	19,548	27,297	139,092	592,312	778,249
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	174,034	174,034
Pasuritë e tjera	-	-	6,850	-	6,850
Gjithsej asetet financiare	214,228	27,297	145,942	766,346	1,153,813
Detyrimet					
Depozita nga klientët	999,622	20,511	2,276	366	1,022,775
Detyrime ndaj bankave	5,504	-	831	-	6,335
Detyrime të tjera financiare jo derivative	298	-	-	19,000	19,298
Detyrime të tjera financiare derivative	-	-	8,375	-	8,375
Gjithsej detyrimet financiare	1,005,424	20,511	11,603	19,703	1,057,241
Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2021	(791,196)	6,786	134,339	746,643	96,572

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	68,852	-	-	87,326	156,178
Detyrime nga bankat	28,575	-	-	-	28,575
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7,681	17,365	135,845	548,624	709,515
Investimet në letra me vlerë	1,493	4,971	111,194	59,101	176,759
Pasuritë e tjera	-	-	3,034	-	3,034
Gjithsej asetet financiare	106,601	22,336	250,073	695,051	1,074,061
Detyrimet					
Depozita nga klientët	912,080	941	2,197	408	915,626
Detyrime ndaj bankave	5,879	-	21,003	-	26,882
Borxhi i varur	298	-	-	19,000	19,298
Detyrime të tjera financiare jo derivative	-	-	8,011	-	8,011
Detyrime të tjera financiare derivative	-	-	236	364	600
Gjithsej detyrimet financiare	918,257	941	31,447	19,772	970,417
Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2020	(811,656)	21,395	218,626	675,279	103,644

Analiza e maturimit të kredive për klientë bazohet në datat e mbetura të maturimit të marrëveshjeve të kredisë, që do të thotë duke marrë parasysh këstet që duhet të paguhen në baza mujore.

Raportimi i likuiditetit në baza javore në nivel të segmentit të biznesit, monitorimi i raportit të pandryshueshmërisë ndaras për të gjitha segmentet e biznesit, limitet në librin bankar dhe raportet të cilat matin riskun e interesit dhe diferencat, janë aktualisht mjetet e zbatuara për të menaxhuar dhe kufizuar riskun themelor për zhvillimin e biznesit.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit përfshihen brenda produkteve të paafatizuara dhe atyre më pak se një muaj pasi në këtë kategori përfshihen edhe pjesa më e madhe e detyrimeve me të cilat lidhet ky bilanc.

Analiza e maturimit për detyrimet financiare analizohet si më poshtë:

- Në bazë të datës më të hershme kontraktuale të maturitetit– skenari i rastit më të keq,
- Bazuar në flukset monetare të paskontuara kontraktuale,
- Përcaktimi i brezave kohorë,
- Flukset e pritura monetare përdoren si informata plotësuese.

Përputhja dhe/ose mospërputhja e kontrolluar e afateve të maturimit dhe normave të interesit të pasurive dhe detyrimeve është e rëndësishë thelbësore për menaxhimin e Bankës. Është e pazakontë për bankat që të përputhen plotësisht pasi biznesi i kryer është shpesh me afat të pasigurt dhe i llojeve të ndryshme. Një pozicion i papërputhur potencialisht rrit profitabilitetin, por gjithashtu mund të rrisë riskun e humbjeve. Afati i maturimit të pasurive dhe detyrimeve dhe aftësia për të zëvendësuar detyrimet që bartin interes ndërsa ato maturojnë me një kosto të pranueshme janë faktorë të rëndësishëm në vlerësimin e likuiditetit të Bankës dhe ekspozimin ndaj ndryshimeve në interes dhe kursin e këmbimit.

Banka ka një mospërputhje të konsiderueshme të afatit të maturitetit të pasurive dhe detyrimeve që maturojnë brenda një viti. Kjo mospërputhje e likuiditetit lind për shkak të faktit se burimi kryesor i financimit të Bankës sipas datës 31 dhjetor 2021 dhe 2020 ishin llogaritë e klientëve të paafatizuara dhe që maturoheshin në më pak se një muaj. Menaxhmenti beson se, përkundër asaj se një pjesë të madhe e llogarive të klientëve janë "pa afat", diversifikimi i këtyre depozitave sipas numrit dhe llojit të depozituesve do të tregonte se llogaritë e këtyre klientëve japin një burim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të financimit për Bankën.

Banka ka përmirësuar pozicionin neto përmes burimeve të tjera të financimit, të cilat ofrojnë financim afatmesëm dhe ka për qëllim të vazhdojë përputhjen e maturitetit të pasurive me detyrimet në periudhat që do të vijjnë. Gjithashtu, Banka ka një marrëveshje të papërdorur instrumenti kreditor, e cila do të ofrojë përkrahje në rast se ka nevojë për likuiditet.

Shuma totale kontraktuese e mbetur e zotimeve për të dhënë kredi nuk paraqet domosdo kërkesa të ardhshme për para, pasi shumë prej këtyre zotimeve do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

4.4 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e një investimi do të bjerë për shkak të lëvizjeve në faktorët e tregut. Katër faktorët standardë të riskut të tregut janë:

- Risku i kapitalit ose rreziku që çmimet e aksioneve të ndryshojnë.
- Risku i normës së interesit ose risku që normat e interesit do të ndryshojnë.
- Risku valutor ose risku që normat e valutës së huaj do të ndryshojnë.
- Risku i mallrave ose risku që çmimet e mallrave (si drithërat, metalet etj.) do të ndryshojnë.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj riskut të tregut. Risku i tregut shfaqet nga pozicionet e hapura në normën e interesit dhe produktet valutore, të cilat të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Menaxhmenti vendos limitet në vlerën e riskut që mund të pranohet, që monitorohet në baza ditore. Megjithatë, përdorimi i kësaj qasjeje nuk i ndalon humbjet jashtë këtyre limiteve në rast të lëvizjeve më të mëdha të tregut.

Risku gjeografik

Përqendrimi gjeografik i pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës më datën 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është paraqitur më poshtë:

	Kosova	BE	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	153,217	22,072	-	175,289
Detyrime nga bankat	-	19,391	-	19,391
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	778,249	-	-	778,249
Investimet në letra me vlerë	48,703	92,327	33,004	174,034
Pasuritë e tjera	6,850	-	-	6,850
Gjithsej asetet financiare	987,019	133,790	33,004	1,153,813
Detyrimet				
Depozita nga klientët	963,342	33,890	25,543	1,022,775
Depozita nga bankat	5,504	831	-	6,335
Borxhi i varur	-	19,298	-	19,298
Detyrime të tjera	8,375	-	458	8,833
Gjithsej detyrimet financiare	977,221	54,019	26,001	1,057,241
Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2021	9,798	79,771	7,003	96,572
	Kosova	BE	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	142,599	13,579	-	156,178
Detyrime nga bankat	-	28,575	-	28,575
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	709,515	-	-	709,515
Investimet në letra me vlerë	24,768	91,680	60,311	176,759
Pasuritë e tjera	3,034	-	-	3,034
Gjithsej asetet financiare	879,916	133,834	60,311	1,074,061
Detyrimet				
Depozita nga klientët	870,938	14,410	30,278	915,626
Depozita nga bankat	5,879	21,003	-	26,882
Borxhi i varur	-	19,298	-	19,298
Detyrime të tjera	8,011	-	600	8,611
Gjithsej detyrimet financiare	884,828	54,711	30,878	970,417
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2020	(4,912)	79,123	29,433	103,644

Risku valutor

Kjo është një formë e riskut që vjen nga ndryshimi në çmimin e një valute kundër një tjetre. Risku valutor menaxhohet nëpërmjet monitorimit dhe menaxhimit të pozicioneve të hapura valutore. Këto pozicione vendosen për pozicionet ditore dhe veçmas, për pozicionet gjatë natës. Analiza e ndjeshmërisë i ofrohet menaxhmentit në baza javore.

Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në kurset mbizotëruese të këmbimit në valutë të huaj në pozicionin e saj financiar dhe në rrjedhat e parasë. Menaxhmenti vendos limitet mbi nivelin e ekspozimit sipas monedhës dhe në total, si dhe kufijtë e ndalimit të humbjeve, të cilat monitorohen çdo ditë dhe mbulojnë në përputhje me rrethanat duke futur pozicione kompensuese. Përdorimi i euros në Kosovë i mundëson bankës të hyjë në derivativë me likuiditet të lartë, siç janë swap-et ndër-valutore, që do të përdoren si mjete mbrojtëse ndaj variancave afatshkurtra të likuiditetit.

Raporti i riskut të tregut që përfshin Raportin e riskut të normës së interesit dhe raportin e monedhës së hapur FX i dërgohet menaxhmentit në baza javore. Raporti përkatës prodhohet nga menaxhmenti i rrezikut të RBI bazuar në inputet që sigurohen nga burimet e raportimit lokal. Tabela në vijim përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Në tabelë janë përfshirë pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në vlerat kontabël, të kategorizuara sipas monedhave dhe të përkthyer në '000 euro.

	Euro	USD	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	175,289	-	-	175,289
Detyrime nga bankat	19,391	-	-	19,391
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	778,249	-	-	778,249
Investimet në letra me vlerë	139,602	34,432	-	174,034
Pasuritë e tjera	6,850	-	-	6,850
Gjithsej asetet financiare	1,119,381	34,432	-	1,153,813
Detyrimet				
Depozita nga klientët	919,107	67,548	36,120	1,022,775
Depozita nga bankat	6,335	-	-	6,335
Borxhi i varur	19,298	-	-	19,298
Detyrime të tjera	8,833	-	-	8,833
Gjithsej detyrimet financiare	953,573	67,548	36,120	1,057,241
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2021	165,808	(33,116)	(36,120)	96,572

	Euro	USD	Të tjera	Gjithsej
Pasuritë				
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	146,122	6,141	3,915	156,178
Detyrime nga bankat	7,258	15,483	5,834	28,575
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	709,515	-	-	709,515
Investimet në letra me vlerë	145,091	31,668	-	176,759
Pasuritë e tjera	3,034	-	-	3,034
Gjithsej asetet financiare	1,011,020	53,292	9,749	1,074,061
Detyrimet				
Depozita nga klientët	845,383	57,111	13,132	915,626
Depozita nga bankat	26,882	-	-	26,882
Borxhi i varur	19,298	-	-	19,298
Detyrime të tjera	8,611	-	-	8,611
Gjithsej detyrimet financiare	900,174	57,111	13,132	970,417
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2020	110,846	(3,819)	(3,383)	103,644

Rreziku i valutës së huaj

Valutat e huaja ndaj të cilave Banka është e ekspozuar kryesisht janë Dollari amerikan (USD), Frangu zviceran (CHF) dhe Funta britanike (GBP). Kufiri për pozicionin agregat të hapur të valutës së huaj mbahet brenda kërkesave rregullative. Kjo zvogëlon ekspozimin e rrezikut ndaj çdo luhatje në treg dhe minimizon ndikimin e mundshëm të rrvlerësimit të pozicionit të valutës së huaj në fitimin dhe humbjen e bankës.

Normat për valutat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave në datën e raportimit, të denominuara në valuta të huaja, ishin si në vijim (në euro):

Krahasuar me EUR	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
1 USD	1.1310	1.2274
1 CHF	1.0325	1.0804
1 GBP	0.839	0.899

Risku i normës së interesit

Ky është rreziku që vlera relative e një pasurie që sjell interes do të humbasë në vlerë. Asetet e Bankës janë kryesisht në kredi fikse afatmesme dhe afatgjata dhe detyrimet kryesisht janë depozita afatshkurtra, gjë që e ekspozon Bankën në një mospërputhje në normat e interesit dhe për pasojë hendeqet përkatëse e ekspozuan Bankën ndaj lëvizjeve të normave të interesit në treg. Banka merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në bilancin e saj financiar dhe rrjedhat e parasë. Marzhat e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlohen ose të krijojnë humbje në rast se linden lëvizje të papritura.

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit, kryesisht si rezultat i kredidhënies me norma fikse të interesit, me shuma dhe për periudha të cilat ndryshojnë nga ato të depozitave me afat me norma fikse të interesit. Në praktikë normat e interesit në përgjithësi janë fikse për kredi afatshkurtra. Menaxhmenti vendos limitet e nivelit të mospërputhjes së normës së interesit për ndryshim të çmimit që mund të ndërmerret. Sipas kontratave të kundër këmbimit të normave të interesit, Banka pajtohet të këmbëjë dallimin ndërmjet shumës fikse dhe asaj variable të interesit të llogaritur mbi shumat nacionale të kryegjësë. Paraja në dorë dhe bilanci në BQK në të cilën nuk paguhet interes janë të përfshira në kolonën "pa interes" në tabelën e mëposhtme, si dhe depozitat pa interes të klientëve.

Për t'u mbrojtur për diferencat ndërmjet kredive fikse afatmesme dhe afatgjata në krahasim me ato variable afatshkurtra dhe afatmesme, përdoret instrumenti derivativ financiar i quajtur kundër këmbim (SWAP) i normës së interesit, ku Banka Raiffeisen në Kosovë është kryesisht paguese e anës së interesit fiks, kurse pala tjetër është paguese e normës variable, dhe ana variable është indeksuar në EURIBOR 6 muaj, për të siguruar ndjeshmërisë optimale.

Banka Raiffeisen në Kosovë zbaton menaxhimin aktiv të riskut për t'u mbrojtur kundër pozicioneve të riskut të tregut. Risku i normës së interesit është i mbrojtur pjesërisht nëpërmjet instrumenteve derivative financiare. Për të siguruar stabilitet afatgjatë në rrjedhën e parasë nga portfoliot ekzistuese të kredive, që matojnë ndërmjet vitit 2022 deri në vitin 2029, këto pozicione janë të mbrojtura përmes Swapeve të Normave të Interesit. Shkëmbimet e normës së interesit kontabilizohen si derivativë në librin bankar pa zbatuar kontabilitetin mbrojtës. Shkëmbimet e normës së interesit maten me vlerën e tregut në çdo datë raportimi dhe çdo ndryshim që rezulton nga kjo njihet në fitim dhe humbje të vitit. Pozicionet maten duke përdorur metodën e vlerës së pikëve bazë.

Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj rreziqeve të normës së interesit. Të përfshira në tabelë janë asetet dhe detyrimet financiare të Bankës në vlerat kontabël, të kategorizuara sipas datave të ri-çmimit kontraktual ose datave të maturimit, cilado që është më herët.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	175,289	-	-	-	-	175,289
Detyrime nga bankat	19,391	-	-	-	-	19,391
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	19,548	27,297	139,092	592,312	-	778,249
Investimet në letra me vlerë	22	-	-	174,012	-	174,034
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	6,850	6,850
Gjithsej asetet financiare	214,250	27,297	139,092	766,324	6,850	1,153,813
Detyrimet						
Depozita nga klientët	112,077	20,511	2,276	366	887,545	1,022,775
Depozita nga bankat	4,673	-	831	-	831	6,335
Borxhi i varur	298	-	-	-	19,000	19,298
Detyrime të tjera	-	-	-	-	8,833	8,833
Gjithsej detyrimet financiare	117,048	20,511	3,107	366	916,209	1,057,241
Pozicioni neto i hendekut më 31 dhjetor 2021	97,202	6,786	135,985	765,958	(909,359)	96,572

Depozitat pa interes në vlerë prej 888,376 mijë € janë kryesisht llogari rrjedhëse të bizneseve dhe individëve. Ato nuk kanë ndonjë datë kontraktuale të ri-çmimit ose maturimit, megjithatë normat e interesit do të përgjigjeshin në një kohë të shkurtër në përgjigje të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	68,852	-	-	-	87,326	156,178
Detyrime nga bankat	28,575	-	-	-	-	28,575
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7,681	17,365	135,845	548,624	-	709,515
Investimet në letra me vlerë	1,493	4,971	111,194	59,101	-	176,759
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	3,034	3,034
Gjithsej asetet financiare	106,601	22,336	247,039	607,725	90,360	1,074,061
Detyrimet						
Depozita nga klientët	130,967	941	2,197	408	781,113	915,626
Depozita nga bankat	4,877	-	21,003	-	1,002	26,882
Borxhi i varur	298	-	-	19,000	-	19,298
Detyrime të tjera	-	-	-	-	8,611	8,611
Gjithsej detyrimet financiare	136,142	941	23,200	19,408	790,726	970,417
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2020	(29,541)	21,395	223,839	588,317	(700,366)	103,644

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Bankës ndaj normave të ndryshueshme të interesit (EURIBOR). Të përfshira në tabelë janë pasuritë dhe detyrimet financiare të Bankës në vlera kontabël, të kategorizuara sipas datës së riçmimit kontraktual ose datës së maturimit, cilado që është më herët.

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	-	-	-	-	-	-
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	3,795	2,477	11,504	207,432	225,408	
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	-	-
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej asetet financiare	3,795	2,477	11,504	207,432	225,408	
Detyrimet						
Depozita nga klientët	-	-	-	-	-	-
Depozita nga bankat	-	-	-	-	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet financiare	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2021	3,795	2,477	11,504	207,432	225,408	

	Të paafatizuara dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Nga 3 deri në 12 muaj	Më shumë se 12 muaj	Pa interes	Totali
Pasuritë						
Paraja dhe ekuivalentet e saj dhe rezerva e detyrueshme e likuiditetit	-	-	-	-	-	-
Detyrime nga bankat	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	7,921	7,068	17,867	153,569	186,425	
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	-	-
Pasuritë e tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej asetet financiare	7,921	7,068	17,867	153,569	186,425	
Detyrimet						
Depozita nga klientët	-	-	-	-	-	-
Depozita nga bankat	-	-	-	-	-	-
Borxhi i varur	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej detyrimet financiare	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i hendekut neto më 31 dhjetor 2020	7,921	7,068	17,867	153,569	186,425	

Tabela më poshtë përmbledh normat efektive të interesit sipas monedhave kryesore për instrumentet kryesore financiare monetare. Analiza është përgatitur duke përdorur normat vjetore efektive.

Në përqindje	2021				2020			
	EUR	USD	CHF	GBP	EUR	USD	CHF	GBP
Pasuritë								
Bilanci me Bankën Qendrore	(0.1)	-	-	-	(0.1)	-	-	-
Detyrime nga bankat	(0.7)	0.0	(0.8)	(0.0)	(0.6)	0.3	(0.8)	0.2
Kthimi AC në Bonot qeveritare	1.1	-	-	-	N/A	N/A	N/A	N/A
Bonot qeveritare jo-tregtuese përmes FV	2.8	-	-	-	1.7	-	-	-
Kthimi OCI në bonot qeveritare	0.1	0.4	-	-	0.2	1.4	-	-
Kthimi në bonot e mbajtura për tregtim	2.2	-	-	-	-	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6.5	3.9	-	-	6.7	-	-	-
Detyrimet								
Llogaritë e klientëve	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Depozitat me afat	(0.0)	(0.0)	(0.0)	(0.0)	(0.4)	0.0	0.0	0.0
Llogaritë e kursimit	(0.0)	(0.0)	(0.0)	(0.0)	0.0	0.0	0.0	(0.1)
Kredi e varur	(6.2)	-	-	-	(6.2)	-	-	-
IRS	(3.7)	-	-	-	(13.1)	-	-	-

Nga perspektiva e menaxhimit dhe kontrollit të rrezikut, ekzistojnë dy aspekte të rrezikut:

- Vlerësimi i rrezikut
- Kontrolli i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut të normës së interesit

Ndjeshmëria e rrezikut të normës së interesit matet për të përcaktuar sasinë e varësisë së vlerës aktuale të një pozicioni nga një faktor rreziku. Ndjeshmëritë e normës së interesit, shpesh të referuara si vlera të pikës bazë (BPV), japin ndryshimin e vlerës aktuale në njësi të monedhës referuese, nën supozimin se normat e interesit ndryshojnë me 200 bps. Rreziku i Normës së Interesit matet duke përdorur qasjen VaR (Vlera në rrezik). Kjo qasje nënkupton një skenar matjeje që përdor 10 ditë kohëzgjatje dhe 99 për qind interval të besimit. VaR matet në stresin e zhvendosjes 1bps në kurbën e kthimit. Ky skenar supozon implikimet në pasqyrën e Fitimit dhe Humbjes të Bankës, në rast se kurba e kthimit lëviz në njërin apo tjetrin drejtim me 200 pikë bazë. Më poshtë janë paraqitur të

Kategoritë kryesore të ndjeshmërisë të vitit 2021	+ 200 bps		- 200 bps		Research	
	Y1	Y2	Y1	Y2	Y1	Y2
Ndjeshmëria NII	1,39M	3,50M	-4,60M	-7,90M	-0,23M	-0,63M
Ndjeshmëria e vlerësimit	-1,12M	0,65M	1,23M	-0,69M	-0,07M	-0,39M
Ndjeshmëri totale	0,27M	4,15M	-3,36M	-8,59M	-0,30M	-1,02M
Kategoritë kryesore të ndjeshmërisë të vitit 2020	Y1	Y2	Y1	Y2	Y1	Y2
Ndjeshmëria NII	1,13M	3,84M	-5,41M	-9,34M	-0,02M	-0,08M
Ndjeshmëria e vlerësimit	-0,78M	0,57M	0,77M	-0,58M	-0,04M	-0,04M
Ndjeshmëri totale	0,35M	4,41M	-4,64M	-9,92M	-0,07M	-0,12M

Vlera në rrezik më 31 dhjetor 2021 është vlera Euro në rrezik (99 për qind, 1d) në Librin Bankar, është 711 mijë Euro. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë i paraqiten menaxhimit në baza javore dhe rishikohen në mënyrë të pavarur nga Menaxhimi i Rrezikut i RBI-së në Vjenë.

Kontrolli i rrezikut të normës së interesit

Mekanizmi i kontrollit të rrezikut të normës së interesit shfrytëzohet përmes raporteve ditore të vlerës së pikëve bazë (BPV). Banka aktualisht ka një kufi total BPV prej 23 mijë Euro. Për qëllimin e matjes së BPV, produktet me normë të administruar modelohen duke përdorur portofolin e replikimit. Vlera e Pikëve Bazë matet për valutë dhe për brez/interval kohor. Kufijtë vendosen gjithashtu për secilën valutë dhe për intervale të ndryshme kohore.

4.5 Rreziku operacional

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe zbatimin e kontroleve për të adresuar rrezikun operacional i është caktuar menaxhimit të lartë brenda secilës njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e duhur të detyrave, përfshirë autorizimin e pavarur të transaksioneve,
- kërkesat për barazimin dhe monitorimin e transaksioneve,
- pajtueshmëria me kërkesat rregullatore dhe kërkesat e tjera ligjore,
- dokumentimi i kontroleve dhe procedurave,
- kërkesat për vlerësimin periodik të rreziqeve operacionale të cilat duhet përballur, dhe përshtatshmëria e kontroleve dhe procedurave për adresimin e rreziqeve të identifikuara,

- kërkesat për raportimin e humbjeve operacionale dhe veprimet përmirësuese të propozuara,
- zhvillimi i planeve kontingjente,
- trajnimi dhe zhvillimi profesional,
- standardet etike dhe të biznesit,
- zbutja e rrezikut, përfshirë sigurimin kur kjo është efektive.

Pajftueshmëria me standardet e Bankës mbështetet nga një program i rishikimeve periodike të ndërmarra nga Auditimi i Brendshëm. Rezultatet e rishikimeve të Auditimit të Brendshëm diskutohen me menaxhmentin e njësisë së biznesit me të cilën ato lidhen, ku përmbledhjet paraqiten te Komiteti i Auditimit dhe menaxhmenti i lartë i Bankës.

4.6 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Kapitali rregullator

Banka menaxhon kapitalin e saj për të siguruar që do të jetë në gjendje të vazhdojë veprimtarinë (parimi i vijimësisë) ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të bilancit të borxhit dhe ekuitetit. Strategjia e përgjithshme e Bankës mbetet e pandryshuar nga viti i kaluar. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga borxhi, i cili përfshin huazime, dhe kapitalin që i atribuohet mbajtësve të kapitalit, duke përfshirë kapitalin e emetuar dhe fitimet e pashpërdara.

Kërkesat për kapital për rrezikun operacional

Kërkesat e kapitalit për rrezikun operacional llogariten bazuar në rregulloren e BQK-së "për menaxhimin e rrezikut operacional", duke përdorur qasjen e treguesve bazë. Sipas përjasjes së Treguesit Bazë, kërkesa për kapital për rrezikun operacional është e barabartë me 15 për qind (pesëmbëdhjetë për qind) të treguesit përkatës. Treguesi përkatës është mesatarja përgjatë tre vjetëve e shumës së të ardhurave neto nga interesi dhe të ardhurave neto jo nga interesi.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është përqindja e kapitalit rregullator ndaj aseteve të ponderuara me risk, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjera, shprehur si përqindje. Kërkesat minimale janë përditësuar duke filluar nga 1 janari 2020 dhe kërkesa për kapitalin e zakonshëm të nivelit 1 ("CET 1") është 4.9 për qind e aseteve të ponderuara me rrezik, kapitali i nivelit 1 mbi 9 për qind të pasurive të ponderuara me rrezik dhe 12 për qind të aseteve të ponderuara me rrezik për fondet vetanake totale, d.m.th. kapitali i nivelit 1 plus kapitali i nivelit 2 (2021: raporti minimal i kërkuar i mjaftueshmërisë së kapitalit është 8 për qind për kapitalin e nivelit 1 dhe 12 për qind për fondet vetanake totale). Banka ka përmbushur këto kërkesa rregullatore gjatë vitit dhe në fundvit të 2021 dhe 2020.

Pasuritë e ponderuara me rrezik (RWA)

Pasuritë ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të rrezikut kombëtar, që u caktohet një ponderim i rrezikut sipas shumës së kapitalit që konsiderohet i nevojshëm për t'i mbështetur ato. Aseteve të bankës u caktohet njëra prej ponderimeve bazuar në Rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit. Për të llogaritur shumat e ekspozimeve të ponderuara me rrezik, ponderimet e rrezikut zbatohen për të gjitha ekspozimet, përveç nëse zbriten nga fondet vetanake, në përputhje me nenet 44 deri 58 të Rregullores për Mjaftueshmërinë e Kapitalit. Zbatimi i ponderimit të rrezikut bazohet në klasën e ekspozimit në të cilën është caktuar ekspozimi dhe, në masën e specifikuar në cilësinë e tij të kredisë. Cilësia e kredisë mund të përcaktohet duke iu referuar vlerësimeve të kreditit të Institucioneve të Jashtme të Vlerësimit të Kredisë (ECAI) ose vlerësimeve të kreditit të Agjencive të Kreditit të Eksportit (ECA) në përputhje me Rregulloren për përdorimin e vlerësimeve të jashtme të kredisë për qëllimin e llogaritjes së kapitalit rregullator.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Pasuritë totale të ponderuara me rrezik	787,166	750,436
Ekspozimet totale jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	33,390	29,406
Pasuritë totale të ponderuara me rrezik për rrezikun operacional	59,296	55,259
Gjithsej	879,852	835,101
Kapitali rregullator (Kapitali total)	134,486	145,866
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (Kapitali përgjithshëm)	15.28%	17.47%

Politika e Bankës është të ruajë një bazë të fortë kapitali për të ruajtur besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut dhe për të mbështetur zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Ndikimi i nivelit të kapitalit në kthimin e aksionerëve njihet gjithashtu dhe Banka njeq nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve sa më të larta që mund të jetë e mundur me raport më të mirë borxh/ekuitet dhe avantazhe dhe siguri të ofruara nga një pozicion i shëndoshë i kapitalit.

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim material në menaxhimin e kapitalit të Bankës gjatë kësaj periudhe.

Raporti borxh/ekuitet

Komiteti i menaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në mënyrë të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikon që lidhet me secilën klasë të kapitalit. Raporti i borxhit/ekuitetit në fund të vitit ishte si më poshtë:

	2021	2020
Borxhi	19,298	19,298
Kapitali	137,529	144,133
Raporti i borxhit neto ndaj kapitalit	14%	13%

5. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Banka mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila pasqyron rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

Niveli 1: të dhënat që janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.

Niveli 2: të dhënat tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme ose direkt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të përfshira nga çmimet). Kjo kategori përfshinë instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Niveli 3: të dhënat që nuk janë të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat teknika e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë efekt të konsiderueshëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshinë instrumentet të cilat vlerësohen në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të pasqyruar dallimet ndërmjet instrumenteve.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e flukseve monetare të skontuara, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vëzhgueshme, dhe metoda të tjera vlerësimi. Supozimet dhe të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit përfshijnë normat e interesit pa risk dhe normat referencë, diferencat e kreditit (credit spread) dhe premiumet tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, çmimet e bonove dhe kapitalit, normat e këmbimit në valutë të huaj, çmimet e aksioneve dhe çmimet e indeksit të kapitalit dhe luhatjet e pritshme të çmimeve dhe korrelacionet. Qëllimi i teknikave të vlerësimit është të arrijë matjen e vlerës së drejtë e cila pasqyron çmimin që do të merrej për të shitur asetin ose që do të paguhej për transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

5.1 Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Para e gatshme dhe ekuivalentet e saj dhe rezervat e detyrueshme

Para e gatshme dhe ekuivalentët e saj përfshijnë plasmanet ndërbankare dhe zërat gjatë mbledhjes. Meqenëse këto balance janë afatshkurtra dhe me norma luhatëse, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të barazohet me vlerën e tyre kontabël.

Detyrime nga bankat

Detyrimet nga bankat përbëhen nga depozitat me afat dhe garancitë nga bankat e tjera. Meqenëse këto balance janë afatshkurtra dhe me norma luhatëse vlera e tyre e drejtë konsiderohet të barazohet me vlerën e tyre kontabël.

Kreditë e varura

Kredia e varur afatgjatë që i detyrohet Raiffeisen Bank International ka një vlerë të drejtë të vlerësuar për afërsisht të barabartë me vlerën e saj kontabël për shkak të normës bazë luhatëse të saj të interesit. Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet secila matje e vlerës së drejtë.

	Vlera	Vlera e drejtë bartëse 2021	Vlera Niveli 3 2021	Vlera e drejtë bartëse 2020	Vlera e drejtë Niveli 3 2020
Pasuritë					
Kreditë dhe paradhëniet për klientët		778,249	769,501	709,515	701,327
Detyrimet					
Depozita nga klientët		1,022,775	1,022,775	915,626	915,626
Depozita nga bankat		6,335	6,335	26,882	26,882

5.2 Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën është kategorizuar matja e vlerës së drejtë. Shumat bazohen në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

31 dhjetor 2021				
Instrumentet joderivative	Vlera bartëse	Vlera e Drejtë Niveli 1	Vlera e Drejtë Niveli 2	Vlera e Drejtë Niveli 3
Investimet në letra me vlerë	174,034	158,405	15,629	-
Investimet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes	1,223	-	1,223	-
Investimet financiare- të mbajtura për tregtim	1,119		1,119	
Investimet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI	152,166	148,882	3,284	-
Investimet financiare me kosto të amortizuar	19,526	9,523	10,003	
Instrumentet derivative	458	458	-	-
Derivatët e mbajtur për menaxhimin e rrezikut	458	458	-	-

31 dhjetor 2020				
Instrumentet joderivative	Vlera bartëse	Vlera e Drejtë Niveli 1	Vlera e Drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3
Letrat me vlerë të investimeve	176,759	151,834	24,926	-
Investimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	3,306	-	3,306	-
Investimet financiare me vlerë të drejtë përmes OCI	173,453	151,834	21,620	-
Instrumentet derivative	600	600	-	-
Derivatet e mbajtura për menaxhimin e rrezikut	600	600	-	-

6 Humbjet nga rënia në vlerë e pasurive financiare

Tabela më poshtë tregon shpenzimet e ECL për instrumentet financiare për vitin 2021 të regjistruara në pasqyrën e të ardhurave:

Shpenzimet e humbjeve të kredive 2021	Faza 1 Individuale	Faza 1	Faza 2 Individuale	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	(1,165)	-	941	(3,805)	(979)	(5,008)
Instrumentet e borxhit të matura me FVOCI	85		-	-	-	-	85
Jashtë bilancit (Garancitë financiare dhe kreditë)	0	-	-	-	-	-	0
angazhimet)	-	(80)	-	109	(1)	-	28
Humbjet totale nga rënia në vlerë	85	(1,245)	-	1,050	(3,806)	(979)	(4,895)

Shpenzimet e humbjeve të kredive 2020	Faza 1 Individuale	Faza 1	Faza 2 Individuale	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	-	(46)	-	(2,580)	(3,287)	(2,113)	(8,026)
Instrumentet e borxhit të matura me FVOCI	(4)	-	-	-	-	-	(4)
Jashtë bilancit (Garancitë financiare dhe zotimet e huasë)	-	(25)	-	(30)	-	-	(55)
Humbjet totale nga rënia në vlerë	(4)	(71)	-	(2,610)	(3,287)	(2,113)	(8,085)

7 Ndryshimet në detyrime që rrjedhin nga pasuritë financiare

	1 janar 2021	Rrjedha e parasë	Deklarimi i dividendëve	31 dhjetor 2021
Huamarrjet me interes Shënimi 16	5,879	(375)	-	5,504
Dividendët e pagueshëm	-	(32,400)	32,400	-
Pagesat e qirasë	-	(1,104)	-	(1,104)
Detyrimet totale nga aktivitetet e financimit	5,879	(33,879)	32,400	4,400

	1 janar 2020	Rrjedha e parasë	Deklarata e dividendëve	31 dhjetor 2020
Huamarrjet me interes Shënimi 16	5,170	709	-	5,879
Dividentët e pagueshëm	-	-	-	-
Pagesat e qirasë	-	(1,154)	-	(1,154)
Detyrimet totale nga aktivitetet e financimit	5,170	(445)	-	4,725

8 Paraja dhe ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme

	2021	2020
Para në dorë	70,931	61,371
Balancat me BQK-në	81,320	81,228
Llogari korrespondente me banka të tjera	23,038	13,579
Lejimet për llogaritë me banka të tjera	-	-
Gjithsej	175,289	156,178

Paraja, ekuivalentët e parasë dhe rezerva e detyrueshme përfshijnë një bilanc të rezervës së detyrueshme të likuiditetit me BQK-në prej 99,504 mijë euro (31 dhjetor 2020: 87,326 mijë euro). Kërkesa e bilancit të rezervës së likuiditetit llogaritet si mesatarja e bilancit ditor për çdo ditë të muajit paraprak kalendarik dhe duhet të mbahet si 10 për qind e depozitave bankare të pagueshme brenda një viti. Përbëhet nga bilancet me BQK-në dhe nga 50 për qind e parasë në dorë. Si i fillë, bilanci mund të ndryshojë nga dita në ditë. Ky bilanc përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë. Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, paraja dhe ekuivalentët e parasë të Bankës për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë ishin si më poshtë:

	2021	2020
Depozitat me afat (shënimi 9)	18,568	27,817
Paraja dhe ekuivalentët e saj dhe rezerva e detyrueshme	175,289	156,178
Minus: Rezerva e detyrueshme e likuiditetit	(99,504)	(87,326)
Paraja dhe ekuivalentet e saj për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë	94,353	96,669

Interes negativ është aplikuar në bilance (mbi kërkesën e rezervës së likuiditetit) me BQK-në për vitin aktual raportues (0.1 për qind) dhe vitin paraprak raportues (0.1 për qind).

9 Detyrime nga bankat

Depozitat me afat plasohen pranë bankave që veprojnë në shtetet e OECD. Bilanci i detyrimeve nga bankat përfshin interesin e përlogaritur prej 5 mijë € (31 dhjetor 2020: mijë €). Depozitat e garancisë përfshijnë një shumë prej 823 mijë € më 31 dhjetor 2021 (31 dhjetor 2020: 758 mijë €) të cilat përfaqësojnë depozita të kufizuara në Bankën UOB si kolateral para e gatshme të kartës.

	2021	2020
Depozitat me afat	18,568	27,817
Depozitat e garantuara	823	758
Lejimet për rënie në vlerë	-	-
Totali i detyrimeve nga bankat	19,391	28,575

Banka nuk ka të drejtë t'i përdorë këto fonde për qëllime të financimit të aktiviteteve të veta.

10 Letrat me vlerë të investimeve

	2021	2020
Letrat me vlerë të investimeve të përcaktuara si me FVTPL	1,223	3,306
Letrat me vlerë të investimeve të matura me FVOCI	152,217	173,604
Letrat me vlerë të investimeve të matura me kosto të amortizuar	19,541	-
Letrat me vlerë të investimeve të mbajtura për tregtim	1,119	-
Lejimet për rënie në vlerë	(66)	(150)
Totali i letrave me vlerë të investimit	174,034	176,760

Letrat me vlerë të investimit mbahen në modele të ndryshme biznesi të ndara midis letrave me vlerë të investimit me FVOCI, FVTPL, me kosto të amortizuar dhe të mbajtura për tregtim. Letrat me vlerë të investimit të përcaktuara me FVTPL dhe letrat me vlerë të borxhit me FVOCI më 31 dhjetor 2021 përfaqësojnë bono dhe bono thesari një-mujore deri pesë-vjeçare të shprehura në euro dhe dollarë amerikanë të emetuara nga Gjermania, Franca, Austria, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Polonia dhe Republika e Kosovës (Bonot e Thesarit të Qeverisë). Tabela e mëposhtme tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal ndaj rrezikut kreditor bazuar në sistemin e brendshëm të vlerësimit të kredisë së Bankës dhe klasifikimin e fazës në fund të vitit. Shumat e paraqitura janë me provizionet për rënie në vlerë.

Shkalla/nota e vlerësimit të brendshëm	2021			
	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total
Performuese	-	-	-	-
Shkëlqyeshëm	59,436	-	-	59,436
Shumë mirë	56,379	-	-	56,379
Mirë	-	-	-	-
Kënaqshëm	-	-	-	-
Nënstandarde	-	-	-	-
Të kreditit të zhvlerësuar	-	-	-	-
Të pavlerësuar	36,402	-	-	36,402
Gjithsej	152,217	-	-	152,217

Nota e vlerësimit të brendshëm	2020			
	Stage 1	Stage 2	Stage 3	Total
Performuese	-	-	-	-
Shkëlqyeshëm	151,983	-	-	151,983
Shumë mirë	-	-	-	-
Mirë	-	-	-	-
Kënaqshëm	-	-	-	-
Nënstandarde	-	-	-	-
Të kreditit të zhvlerësuar	-	-	-	-
Të pavlerësuar	21,620	-	-	21,620
Gjithsej	173,603	-	-	173,603

Lëvizjet në vlerat kontabël bruto dhe ECL-të përkatëse për letrat me vlerë të borxhit me FVOCI, si më poshtë:

	2021			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera e drejtë më 1 janar 2020	173,603	-	-	173,603
Asetet e reja të origjinuara ose të blera	94,508	-	-	94,508
Asetet e çregjistruara ose të maturuara	(115,371)	-	-	(115,371)
Ndryshimi në vlerën e drejtë	(523)	-	-	(523)
Transferimet në fazën 1	-	-	-	-
Transferimet në fazën 2	-	-	-	-
Transferimet në fazën 3	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve jo të njohura	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	-	-
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	152,217	-	-	152,217

	2020			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera e drejtë më 1 janar 2020	144,125	-	-	144,125
Asetet e reja të origjinuara ose të blera	69,895	-	-	69,895
Asetet e çregjistruara ose të maturuara	(39,942)	-	-	(39,942)
Ndryshimi në vlerën e drejtë	(475)	-	-	(475)
Transferimet në fazën 1	-	-	-	-
Transferimet në fazën 2	-	-	-	-
Transferimet në fazën 3	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve jo të njohura	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	-	-
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	173,603	-	-	173,603

	2021			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
ECL më 1 janar 2020	150	-	-	150
Asetet e reja me origjinë ose të blera	33	-	-	33
Asetet e çregjistruara ose të maturuara	(21)	-	-	(21)
Ndryshimi në vlerën e drejtë (duke përfshirë shlyerjet)	(111)	-	-	(111)
Transferimet në fazën 1	-	-	-	-
Transferimet në fazën 2	-	-	-	-
Transferimet në fazën 3	-	-	-	-
Ndikimi në ECL në fund të vitit të ekspozimeve të transferuara ndërmjet fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e ECL	-	-	-	-
Rikuperimet	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	-	-
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-
Lejimi për humbjet më 31 dhjetor 2021	51	-	-	51

	2020			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
ECL më 1 janar 2020	146	-	-	146
Asetet e reja me origjinë ose të blera	76	-	-	76
Asetet e çregjistruara ose të maturuara	(72)	-	-	(72)
Ndryshimi në vlerën e drejtë (duke përfshirë shlyerjet)	-	-	-	-
Transferimet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferimet në fazën 2	-	-	-	-
Transferimet në fazën 3	-	-	-	-
Ndikimi në ECL në fund të vitit të ekspozimeve të transferuara ndërmjet fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet e ECL	-	-	-	-
Rikuperimet	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	-	-
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-
Lejimi për humbjet më 31 dhjetor 2020	150	-	-	150

11 Kreditë dhe paradhëniet për klientët

	2021	2020
Klientët jo retail		
Kreditë aktuale dhe ato të ristrukturuara	296,418	284,716
Mbitërheqjet	43,446	40,278
	339,864	324,994
Klientët retail		
Kreditë aktuale dhe ato të ristrukturuara	444,891	389,030
Mbitërheqjet	19,951	19,457
	464,842	408,487
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	804,706	733,481
Minus: Lejimet për rënie në vlerë	(26,457)	(23,966)
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	778,249	709,515

Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë të ardhurat nga interesi i përlogaritur për 2,214 mijë € (31 dhjetor 2020: 2,336 mijë €).

Tabela e mëposhtme tregon cilësinë kreditore dhe ekspozimin maksimal ndaj rrezikut kreditor bazuar në sistemin e brendshëm të vlerësimit kreditor të Bankës dhe klasifikimin e fazës në fundvit.

Vlera kontabël bruto dhe provizionet korresponduese të humbjeve për totalin e kredive janë si më poshtë:

	2021				2020	
Shkalla/nota e vlerësimit të brendshëm	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali	Totali
Performuese	-	-	-	-	-	-
Shkëlqyeshëm	179,854	3,907	-	8	183,769	-
Shumë mirë	176,503	6,358	-	133	182,994	4,283
Mirë	133,368	48,611	-	1,135	183,114	224,882
Kënaqshëm	113,400	22,559	-	-	135,959	192,898
Nënstandarde	8,655	12,717	-	-	21,372	20,572
Të kreditit të zhvlerësuar	-	-	18,000	5,868	23,868	22,155
Të pavlerësuar	71,786	1,730	-	114	73,630	268,691
Totali	683,566	95,882	18,000	7,258	804,706	733,481

Një analizë e ndryshimeve në vlerën kontabël bruto dhe lejimet përkatëse të humbjeve për gjithsej kreditë janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2021	583,056	127,402	17,398	5,625	733,481
Asetet e reja me origjinë ose të blera	384,615	44,954	906	4,142	434,617
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(188,465)	(41,611)	(1,451)	(1,762)	(233,289)
Transferimet në Fazën 1	34,375	(33,917)	(458)	-	-
Transferimet në fazën 2	(27,254)	27,566	(312)	-	-
Transferimet në fazën 3	(3,083)	(3,413)	6,496	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(99,631)	(25,020)	(2,269)	(672)	(127,592)
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	(47)	(79)	(2,310)	(75)	(2,511)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2021	683,566	95,882	18,000	7,258	804,706

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Lejimi për humbje më 1 janar 2021	2,858	4,326	13,502	3,280	23,966
Asetet e reja me origjinë ose të blera	2,169	1,396	572	1,732	5,869
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(738)	(936)	(776)	(375)	(2,825)
Transferimet në Fazën 1	327	(319)	(8)	-	-
Transferimet në fazën 2	(867)	912	(45)	-	-
Transferimet në fazën 3	(2,265)	(2,651)	4,916	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	2,562	723	(948)	(379)	1,958
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	(47)	(79)	(2,310)	(75)	(2,511)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Lejimi për humbjet më 31 dhjetor 2021	3,999	3,372	14,903	4,183	26,457

Një analizë e ndryshimeve në vlerën kontabël bruto dhe provizionet/lejimet korresponduese të humbjeve për totalin e kredive janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2020	643,374	25,221	16,580	2,243	687,418
Asetet e reja me origjinë ose të blera	351,506	50,116	2,589	3,748	407,959
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(266,097)	(15,067)	(2,886)	(250)	(284,300)
Transferimet në Fazën 1	2,987	(2,858)	(129)	-	-
Transferimet në fazën 2	(72,657)	72,780	(123)	-	-
Transferimet në fazën 3	(3,149)	(1,538)	4,687	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(72,888)	(1,241)	(1,389)	(98)	(75,616)
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	(20)	(11)	(1,931)	(18)	(1,980)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2020	583,056	127,402	17,398	5,625	733,481

Shuma kontraktuale e papaguar për kreditë që janë shlyer/fshirë, por që ishin ende objekt i veprimeve përbarimore ishte zero më 31 dhjetor 2021 (2020: zero).

	Stage 1	Stage 2	Stage 3	POCI	Total
Lejimi për humbjet më 01 janar 2020	2,832	1,757	12,146	1,185	17,920
Asetet e reja me origjinë ose të blera	1,554	1,568	1,851	2,126	7,099
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(713)	(617)	(2,246)	(142)	(3,718)
Transferimet në Fazën 1	23	(21)	(2)	-	-
Transferimet në fazën 2	(2,352)	2,363	(11)	-	-
Transferimet në fazën 3	(2,101)	(1,259)	3,360	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	3,635	546	335	129	4,645
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	(20)	(11)	(1,931)	(18)	(1,980)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Kompensimi për humbje më 31 dhjetor 2020	2,858	4,326	13,502	3,280	23,966

Kreditë jo-retail

Tabela më poshtë tregon cilësinë kreditore dhe ekspozimin maksimal ndaj rrezikut kreditor bazuar në sistemin e brendshëm të klasifikimit të kredisë dhe klasifikimin në faza në fund të vitit. Shumat e paraqitura janë me lejimet/provizionet për rënie në vlerë.

					2021	2020
Shkalla e vlerësimit të brendshëm	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali	Totali
Performuese	-	-	-	-	-	-
Shkëlqyeshëm	157	-	-	-	157	-
Shumë mirë	3,918	15	-	-	3,933	-
Mirë	129,568	38,635	-	-	168,203	84,194
Kënaqshëm	113,400	22,559	-	-	135,959	39,864
Nënstandarde	8,655	12,717	-	-	21,372	3,173
Të kreditit të zhvlerësuar	-	-	4,177	5,868	10,045	12,681
Të pavlerësuar	111	84	-	-	195	268,575
Gjithsej	255,809	74,010	4,177	5,868	339,864	408,487

Një analizë e ndryshimeve në vlerën kontabël bruto dhe lejimet përkatëse për humbjet për kreditë jo-retail janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2021	249,807	65,714	4,717	4,756	324,994
Asetet e reja me origjinë ose të blera	165,623	37,430	63	3,353	206,469
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(101,603)	(27,916)	(748)	(1,741)	(132,008)
Transferimet në Fazën 1	10,085	(10,085)	-	-	-
Transferimet në fazën 2	(21,779)	21,779	-	-	-
Transferimet në fazën 3	(134)	(154)	288	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(46,190)	(12,758)	(89)	(500)	(59,537)
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(54)	-	(54)
Rregullimet në valutë të huaj					
Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2021	255,809	74,010	4,177	5,868	339,864

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Lejimi/provizioni për humbje më 1 janar 2021	666	832	2,825	2,563	6,886
Asetet e reja me originë ose të blera	700	355	61	1,101	2,217
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(208)	(257)	(433)	(368)	(1,266)
Transferimet në Fazën 1	36	(36)	-	-	-
Transferimet në fazën 2	(99)	99	-	-	-
Transferimet në fazën 3	(121)	(135)	256	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(6)	(11)	710	(179)	514
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(54)	-	(54)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Lejimi për humbjet deri më 31 dhjetor 2021	968	847	3,365	3,117	8,297

Një analizë e ndryshimeve në vlerën kontabël bruto dhe lejimet/provizionet përkatëse për humbjet për kreditë jo-retail janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2020	285,446	15,695	5,593	1,538	308,272
Asetet e reja me originë ose të blera	202,242	35,428	288	3,271	241,229
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(186,780)	(12,562)	(1,322)	15	(200,649)
Transferimet në Fazën 1	1,299	(1,299)	-	-	0
Transferimet në fazën 2	(28,638)	28,638	-	-	0
Transferimet në fazën 3	(552)	(7)	559	-	0
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(23,210)	(179)	(176)	(53)	(23,618)
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(225)	(15)	(240)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Vlera kontabël bruto më 31 dhjetor 2020	249,807	65,714	4,717	4,756	324,994

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Lejimi për humbje më 1 janar 2020	391	385	3,636	754	5,166
Asetet e reja me origjinë ose të blera	518	513	12	1,730	2,773
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(215)	(250)	(1,246)	15	(1,696)
Transferimet në Fazën 1	2	(2)	-	-	0
Transferimet në fazën 2	(286)	286	-	-	0
Transferimet në fazën 3	(420)	-	420	-	0
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	676	(100)	228	79	883
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(225)	(15)	(240)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
Lejimi për humbje më 31 dhjetor 2020	666	832	2,825	2,563	6,886

Shuma kontraktuale e papaguar për kreditë që janë shlyer, por që ishin ende objekt i aktivitetit përbarimor ishte zero më 31 dhjetor 2021 (2020: zero).

Kreditë retail

Tabela e mëposhtme tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal ndaj rrezikut kreditor bazuar në sistemin e brendshëm të vlerësimit të kredisë të Bankës dhe klasifikimin e fazës në fund të vitit. Shumat e paraqitura janë bruto të provizioneve për zhvlerësim.

Vlera kontabël bruto për kreditë retail është si më poshtë:

					2020	2019
Shkalla/nota e vlerësimit të brendshëm	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali	Totali
Performuese	-	-	-	-	-	-
Shkëlqyeshëm	179,697	3,907	-	8	183,612	-
Shumë mirë	172,585	6,343	-	133	179,061	4,283
Mirë	3,800	9,976	-	1,135	14,911	140,688
Kënaqshëm	-	-	-	-	-	153,034
Nënstandarde	-	-	-	-	-	17,400
Të kreditit të zhvlerësuar	-	-	13,823	-	13,823	9,474
Të pavlerësuar	71,675	1,646	-	114	73,435	115
Gjithsej	427,757	21,872	13,823	1,390	464,842	324,994

Një analizë e ndryshimeve në vlerën kontabël bruto dhe lejimet përkatëse për humbjet për kreditë retail janë si më poshtë:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Totali
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2021	333,248	61,689	12,681	869	408,487
Asetet e reja me origjinë ose të blera	218,992	7,524	843	789	228,148
Asetet e çregjistruara ose të ripaguara	(86,862)	(13,695)	(703)	(21)	(101,281)
Transferimet në Fazën 1	24,290	(23,832)	(458)	-	-
Transferimet në fazën 2	(5,475)	5,787	(312)	-	-
Transferimet në fazën 3	(2,949)	(3,259)	6,208	-	-
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut kreditor (neto)	(53,440)	(12,263)	(2,180)	(172)	(68,055)
Ndryshimet në flukset monetare kontraktuale për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në çregjistrim	-	-	-	-	-
Shumat e shlyera	(47)	(79)	(2,256)	(75)	(2,457)
Rregullimet në valutë të huaj	-	-	-	-	-
